



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS-FABREFACTA-OPTIME

MANIFESTI AKADEMIK 2019-2020

*15 vjet "Albanian University",
një emër i madh shqiptar*

*Duke falenderuar për bashkëpunimin stafin
administrativ dhe akademik të “Albanian University”, që ndihmuan në
realizimin e “Manifestit akademik
2019-2020”, urojmë studentët të gjejnë të
projektuara në këtë manifest të gjitha objektivat e tyre.*



Albanian University Press
Tiranë, maj 2019.

PËRMBAJTJA

Kalendari akademik	9
Misioni dhe vlerat e “Albanian University”	10
Fjala përshendetëse e Rektorit	11
Historiku	13
Përbërja e Senatit Akademik të “Albanian University”	16
Organizimi Institucional “Albanian University”	17
Strategji për Zhvillimin Institucional, “Albanian University”	20
Strategjia e Kërkimit Shkencor dhe Projektet Institucionale	21
Albanian University Press	23
Praktikat Mësimore	25
Laboratorët dhe Kërkimi Shkencor	29
Klinika Stomatologjike Universitare “Çerçiz Mingomataj”	36
Lista e Programeve të Studimit të ofruara për Vitin Akademik 2019-2020	38

Fakulteti i Shkencave Mjekësore	44
Departamenti i Stomatologjisë/ Specializimet në Stomatologji	44
Departamenti i Farmacisë	54
Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë	58
Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike	76
Departamenti i Arkitekturës/ Programi Bachelor në “Dizajn”	76
Departamenti i Inxhinierive	82
Departamenti i Shkencave Ekonomike	111
Fakulteti i Shkencave Shoqërore	130
Departamenti i Shkencave Juridike	130
Departamenti i Shkencave Politiko - Administrative	145
Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme	153

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes	163
Programet e Studimit të Doktoraturës	184
Regjistrime dhe Transferime	185
Programi i Ekselencës dhe Bursat	186
Studentët dhe mbështetja e tyre	189
Këshilli Studentor	189
Shërbime	190
Kontakte (google maps)	194





Kalendari Akademik 2019-2020

SEMESTRI I I-RË

14 Tetor
 28 Nëntor
 29 Nëntor
 8 Dhjetor
 23 Dhjetor 2019– 5 Janar 2020
 13-26 Janar
 9 Shkurt
 10 - 23 Shkurt

Çelet Viti i Ri Akademik 2019-2020
 Pushim, Dita e Pavarësisë
 Pushim, Festa e Çlirimit
 Pushim, Dita Kombëtare e Rinisë
 Pushimet e Dimrit
 Sesioni i Mbartjes
 Mbyllet Semestri i I-rë
 Sesioni i Provimeve të Dimrit

SEMESTRI I II-TË

24 Shkurt
 14 Mars
 22 Mars
 12 Prill
 19 Prill
 1 Maj
 11-17 Maj
 24 Maj
 7 Qershor
 8 Qershor -28 Qershor
 31 Korrik
 5 Shtator
 7 Shtator – 20 Shtator

Fillon Semestri i II-të
 Pushim, Dita e Verës
 Pushim, Festa e Sulltan Nevruzit
 Pushim, Pashkët Katolike
 Pushim, Pashkët Ortodokse
 Pushim, Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve
 Sesioni i Mbartjes
 Pushim, Fiter Bajrami
 Mbyllet Semestri i II-të
 Sesioni i Provimeve të Verës
 Pushim, Kurban Bajrami
 Pushim, Shenjtërimi i Nënë Terezës
 Sesioni i Provimeve të Vjeshtës

Shënim: Në rastet kur festa zyrtare bie në ditët e pushimit javor, dita e hënë është ditë pushimi.
 Data e fillimit të Vitit Akademik, mund të ndryshojë sipas udhëzimeve të MASR.



MISIONI DHE VLERAT E “ALBANIAN UNIVERSITY”

Misioni i “**Albanian University**” është zhvillimi dhe zgjerimi i kufijve të njohjes përmes arsimit cilësor, rritjes intelektuale, sociale e kulturore të studentëve, duke kontribuar në dobi të komunitetit me aspiratën e një mjedisi intelektual që nxit mendimin kritik, krijues, me vlera, parime dhe etikë akademike institucionale. Si një universitet privat por me një mision të rëndësishëm publik, “**Albanian University**” stimulon studentët në zhvillimin e hulumtimeve dhe reflektimeve për çështjet e rëndësishme të komunitetit kombëtar dhe ndërkombëtar, nëpërmjet një arsimit cilësor dhe programeve bashkëkohore të studimit.

Në vazhdim të misionit tonë qëndron ridimensionimi i arsimit universitar, rritja e programeve kërkimore, nxitja e klimës së respektit të ndërsjelltë tek studentët, mbështetje në zhvillimin e ideve të tyre në shërbim të kombit dhe të shtetit, me qëllimin primar përsosmërinë e universitetit dhe bërjen e tij konkures në tregun e punës. Misioni është nxjerrja e një produkti sa më të përshtatshëm me tregun, në arritjen e targetit themelor: “Produktit që përparon në tregun e punës, profesionistit”! Në hierarkinë e vlerave të “**Albanian University**”, qëndron dimensionin human dhe vullnetarizmi, që përket në përparësinë e vullnetit mbi intelektin dhe veprimin në mendimin

intelektual, nëpërmjet një aktiviteti të përbashkët dhe punë të frytshme vullnetare që nxit të mirën e përgjithshme. “**Albanian University**” si vlerë, por edhe materialisht, u përket studentëve, pedagogëve, punonjësve dhe të gjithë atyre që kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj nisme. Objektivat tona janë ambicioze e afatgjata, bazuar në akreditimin e programeve dhe Statutin e “**Albanian University**”, synojmë të sigurojmë rritje cilësore në përgatitjen e brezave për t’ju përgjigjur ekonomisë së tregut, duke synuar të jemi gjithmonë një qendër e fuqishme e arsimit jopublik në vend.

Vlerat tek të cilat besojmë:

- Cilësia në çdo iniciativë akademike;
- Integriteti dhe korrektësia organizative;
- Kolegjialiteti dhe pjesëmarrja në vendimmarrje;
- Vullnetarizmi dhe përgjegjshmëria në arritjen e standardeve arsimore;
- Përgjegjshmëri dhe liri akademike;
- Ruajtja e etikës dhe krijimi i besueshmërisë.



FJALA PËRSHËNDETËSE E REKTORIT



Të nderuar studentë!

Është nder dhe privilegj për mua që në emër të stafit akademik të “Albanian University” t’ju uroj mirëseardhjen dhe suksese për vitin akademik **2019-2020**.

Universiteti “Albanian University”, si Institucion i Arsimit të Lartë, në Republikën e Shqipërisë prej shumë vitesh është kontribues i rëndësishëm në formimin akademik të brezit të ri, mundësuar nga numri i madh i programeve të studimit, kurrikulave bashkëkohore, stafit akademik të kualifikuar,

investimeve në laboratorë dhe klinika.

Klima pozitive në fushën e arsimit të lartë në vendin tonë ka mundësuar që “Albanian University” të ecë përpara e të zhvillohet më tej, në garantim të standardeve të cilësisë duke i shërbyer përherë e më mirë misionit që ka institucioni ynë.

Dëshmi e një suksesi të qëndrueshëm janë mijëra të diplomuar në auditorët e të tre fakulteteve të universitetit tonë, në të tre nivelet e studimit. Jeni ju, që zgjodhët të ishit pjesë e familjes sonë të madhe duke filluar studimet për herë të parë ose dhe në vazhdim.

Siguria e suksesit tuaj është e garantuar, falë gjithë vlerave të mëdha që ka “Albanian University” si formues dhe promotor i elitave universitare e profesionale.

Ju përgëzoj për zgjedhjen tuaj universitare.

Vit i mbarë akademik!

Prof. Dr. Vera Ostreni



ALBANIAN UNIVERSITY

A
L
B
A
N
I
A
N
U
N
I
V
E
R
S
I
T
Y

A
L
B
A
N
I
A
N
U
N
I
V
E
R
S
I
T
Y

A
L
B
A
N
I
A
N
U
N
I
V
E
R
S
I
T
Y

A
L
B
A
N
I
A
N



HISTORIKU I “ALBANIAN UNIVERSITY”

“Albanian University” (AU) është pjesë e shoqërisë “UFO SHPK” themeluar në datë 25.05.1994, dhe regjistruar sipas legjislacionit në fuqi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me Numër Unik të Identifikimit J82025002B - Numri i Niptit.

AU është themeluar në përputhje me legjislacionin në fuqi me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 10.04.2004 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “UFO dental”. Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 597, datë 28.5.2009 emërtimi i shkollës së lartë universitare, private “UFO dental” ndryshon në “UFO University”.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 603, datë 24.8.2011 u vendos ndryshimi i emrit të universitetit privat nga “UFO University” në “Albanian University”.

“Albanian University” është një Institucion Privat i Arsimit të Lartë. Licencuar në prill të vitit 2004, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, ai i hapi dyert në vitin akademik 2004-2005, me kursin e parë të studimeve të Stomatologjisë, me rreth njëqind studentë. Që në vitin e parë të krijimit të tij, ky institucion vuri në qendër të jetës akademike

promovimin e produktit intelektual dhe shkrimin e mësimit me kërkimin shkencor, e finalizuar me Konferencën e Parë Stomatologjike UFO Dental, e cila hapi siparin e një tradite tashmë të konsoliduar. Në vitin akademik 2005 - 2006 institucioni ofroi diploma universitare dhe në degët; Farmaci, Arkitekturë, Shkenca Juridike, Shkenca Politike. Programe bashkëkohore studimi, staf me një formim shumë të gjatë si akademik dhe profesional, kushte infrastrukturore moderne dhe cilësore janë disa nga elementët mbi të cilët u zhvillua universiteti. Në vitin akademik 2006 -2007, universiteti u plotësua me të tetë degët e tij të studimit; Stomatologji, Farmaci, Arkitekturë, Financë - Bankë, Shkenca Juridike, Shkenca Politike, Psikologji, Shkenca Komunikimi dhe pranë tij ndoqën studimet rreth 2000 studentë. Në këtë vit akademik, përveç plotësimit të detyrave akademike, universiteti vuri theksin në përfshirjen e akademikëve në debatet dhe çështjet publike. Takimet dhe debatet mbi çështjet e legalizimit të lobimit dhe evidentimit të grupeve të interesit, ishin hapi i parë drejt të qenit faktor në jetën publike të vendit. Forumet, ëorkshop-et, seminarët, konferencat, debatet kanë përfshirë jo vetëm akademikët, por edhe studentët, si dhe grupet e interesit, porë si pjesë e formimit intelektual drejt realizimit të misionit



të universitetit. Në prill të vitit 2007, përveç UFO Press-it, universiteti zgjeron hapësirën e tij publike nëpërmjet televizionit “UFO Education” (tashmë UTV News). Ai u ideua si një televizion edukativ në çdo dhënie informacioni. Synimi i tij ishte dhe është formimi kulturor në aspektet politike, artistike, letrare, duke u përpjekur të transmetojë vlerat më pozitive të shoqërisë globale. Viti akademik 2008-2009, erdhi me prova të reja për universitetin. Në këtë vit akademik, universiteti u përball me sfida të reja duke ofruar programe të reja të nivelit të dytë dhe të tretë, të cilët ndihmojnë edhe në profilizimin dhe specializimin e studentëve të tij, për t’i afruar sa më shumë me tregun e punës. Viti akademik 2009-2010 ishte viti i konsolidimit cilësor të universitetit; në këtë vit të gjitha programet Bachelor dhe programet e integruara Farmaci, Stomatologji dhe Arkitekturë, kaluan procesin e akreditimit dhe në vitin 2010 u vlerësuan pozitivisht nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë. Viti akademik 2011-2012 shënon një vit tjetër të rëndësishëm në jetën akademike të universitetit sepse në këtë vit akademik hapet cikli i tretë i studimeve: ai i specializimeve afatgjata në fushën e stomatologjisë me 3 drejtimet e saj, ku lëndët e praktikës organizohen me profesorë të huaj. Ky vit shënon edhe një numër të madh aktiviteteve shkencore dhe kulturore në të gjithë departamentet e Fakultetit të Mjekësisë, të pasqyruara

edhe në revistën “Optime”, si dhe një numër i madh botimesh të reja dhe ribotimesh të shtëpisë botuese “UFO - Press”. Viti akademik 2012-2013 përbën një vit të rëndësishëm sepse shënon 10 vjetorin e hapjes së aktivitetit të shërbimit privat në fushën e arsimit. Ky vit ofroi edhe një gamë më të gjerë programesh të ciklit të dytë, master profesional në fushën e infermierisë dhe të psikologjisë, sikurse edhe hapjen e programeve të ciklit të tretë të doktoraturave në fushën e shkencave juridike, ekonomike, psikologji, shkenca politike, shkenca farmaceutike dhe arkitekturë.

Në vitet e fundit AU i ka dhënë prioritet konsolidimit të cilësisë së zhvillimit të veprimtarisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe hapjes së programeve të reja në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Të gjitha programet e studimit janë në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe përvojat më të mira brenda dhe jashtë vendit.

“Albanian University” është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 90, datë 20.10.2017 nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në bashkëpunim me QAA (Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë). Gjatë viteve të fundit, të gjitha programet aktive të studimit kanë kaluar procesin e vlerësimit të jashtëm nga ASCAL dhe janë vlerësuar pozitivisht. Mbarëvajtja e këtij procesi periodik dhe realizimi i tij në përputhje me legjislacionin në fuqi është në qendër të veprimtarisë së Institucionit.





PËRBËRJA E SENATIT AKADEMIK, AU

Rektor

Zv.Rektor për Kërkimin Shkencor

Zv.Rektor për Procesin Mësimor

Dekan i Fakultetit të Shkencave Mjekësore

Përgjegjës i Departamentit të Stomatologjisë

Përgjegjës i Departamentit të Farmacisë

Përgjegjës i Departamentit të Infermierisë dhe

Fizioterapisë

Dekan i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara

dhe Ekonomike

Përgjegjës i Departamentit të Arkitekturës

Përgjegjës i Departamentit të Inxhinierive

Përgjegjës i Departamentit të Shkencave

Ekonomike

Dekan i Fakultetit të Shkencave Shoqërore

Përgjegjës i Departamentit të Shkencave Juridike

Përgjegjës i Departamentit të Shkencave Politiko

- Administrative

Përgjegjës i Departamentit të Psikologjisë

së Përgjithshme

Përgjegjës i Departamentit të Edukimit dhe

Anglishtes

Pedagog

Student

Prof. Dr. Vera Ostreni

Akad. Prof. Dr. Anesti Kondili

Prof. Asoc. Dr. Aida Dama

Dr. Shk. Med. Erda Qorri

Dr. Shk. Med. Nilena Eriksen

Dr. Kleva Shpati

Dr. Xhejni Borshi

Prof. Asoc. Dr. Remzi Sulo

Prof. Asoc. Dr. Fisnik Kadiu

Dr. Genta Rexha

Prof. Asoc. Dr. Manuela Meçe

Prof.Dr. Kaliopi Naska

Dr. Ismail Tafani

Dr. Dorjana Pano

Dr. Elisabeta Kafia

Dr. Gilberta Hadaj

Dr. Alketa Marku

Florian Cengu



ORGANIZIMI INSTITUCIONAL, AU

“Albanian University” si Institucion i Arsimit të Lartë, e bazon veprimtarinë akademike dhe organizative në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Institucionit si dhe në Rregulloret që miratohen në zbatim të tij.

Pranë AU funksionojnë këto njësi përbërëse:

- a. Njësi kryesore është Fakulteti;
- b. Njësi bazë është Departamenti;
- c. Njësi ndihmëse dhe shërbimi në funksion të njëjësive kryesore dhe bazë, si: laboratorët, klinika stomatologjike universitare, biblioteka, etj.;
- d. Njësitë administrative.

• Statuti përshkruan strukturën akademike dhe administrative të universitetit dhe vendos marrëdhëniet mes tyre. Ai përmban normat bazë, që rregullojnë veprimtarinë e institucionit si organizimin, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteteve dhe organeve drejtuese, zgjedhjen apo

emërimin e tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të studentëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.

- Senati akademik është organi drejtues kolegjal akademik më i lartë, i cili ushtron të gjitha kompetencat që lidhen me programimin dhe koordinimin e aktiviteteve mësimore dhe të kërkimit shkencor. Senati Akademik formulon politikat e zhvillimit të universitetit, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimin dhe të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre.
- Rektorati është organ kolegjal ekzekutiv i cili drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga:
 - a. Rektori;
 - b. Zëvendësrektori/ët – (1) Zv.Rektor për procesin mësimor; (2) Zv.Rektor për kërkimin shkencor;
 - c. Administratori i përgjithshëm i institucionit;
 - d. Drejtuesit e njëjësive kryesore;



Rektorati bashkëpunon me Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit për kryerjen e detyrave të tij si:

- a. Harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit;
 - b. Harton programin vjetor të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore;
 - c. Harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore;
 - d. Paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - e. Monitoron veprimtarinë e AU dhe publikon rezultatet e vlerësimit të tij.
- Bordi i Administrimit është organi drejtues kolegjal administrativ më i lartë, i cili ka kompetenca vendimmarrëse dhe mbikëqyrëse mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare dhe administrative të universitetit, sipas Statutit të AU.
 - Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë në nivel njësie kryesore. Kompetencat e saj konsistojnë në propozimin përpara Senatit, të anëtarëve të personelit akademik që do të jenë pjesë në

komisionet e përhershme të universitetit (neni 25 i Statutit të AU) si edhe kompetenca të tjera, në përputhje me nevojat e institucionit.

- Këshilli i Etikës është organ kolegjal, i cili ngrihet në nivel universiteti dhe shqyrton çështje të etikës në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor-shkencor, si dhe veprimtari të tjera institucionale. Kodi i Etikës së AU dhe Rregullorja e funksionimit të tij hartohet nga Këshilli i Etikës.
- Komisionet e Përhershme në zbatim të nenit 46 të Ligjit Nr. 80/2015 janë organe kolegjiiale, të cilat kryejnë funksione që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikatat e institucionit.

-Komisione të përhershme në AU janë:

- a. Komisioni për dhënien e gradës “Doktor”;
- b. Komisioni për Promovimin e personelit akademik për titujt shkencor “Prof. Asoc”, dhe “Prof.”, kur institucioni përmbush kushtet për ofrimin e tyre;
- c. Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin;



- d. Komisioni për Vlerësimin Institucional;
- e. Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin.
 - Dekanati është organ kolegjal që drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga:
 - a. Dekani;
 - b. Zëvendësdekali;
 - c. Administratori i njësisë kryesore;
 - d. Drejtuesit e njësive bazë – përgjegjësit e Departamenteve.

Dekanati harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore, mbështetur në propozimet e njësive bazë të tij, si dhe ato të Administratorit të njësisë kryesore. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë.

- Rektori është autoriteti drejtues akademik më i lartë. Ai përfaqëson ligjërisht institucionin e arsimit të lartë, për çështje akademike dhe protokollare si dhe në marrëdhënie me të tretët. Rektori drejton dhe koordinon të gjitha aspektet e veprimtarisë akademike dhe kërkimore - shkencore të universitetit. Në bashkëpunim me Senatin e Universitetit dhe Bordin Administrativ, ai orienton dhe ndërton politikën e zhvillimit të institucionit si dhe drejton aktivitetin e administratës së AU.
- Në “Albanian University”, sipas strukturës

akademike ka dy Zv.Rektorë: Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor; Zv. Rektori për Procesin Mësimor; Zv. Rektori kryen detyrat sipas fushës që mbulon në institucion të cilat përcaktohen nga Rektori, dhe në mungesë me porosi të tij, nënshkruan aktet përkatëse.

- Dekani është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësues i saj. Kompetencat e tij përfshijnë koordinimin, mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së njësive kryesore dhe atyre bazë.
- Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti akademik drejtues i njësive bazë, i cili drejton, organizon, koordinon dhe përgjigjet për punën mësimore dhe kërkimore shkencore në njësinë bazë dhe i raporton Dekanit.

Në punën e përditshme të universitetit ka edhe shumë hallka të tjera akademike dhe administrative, të cilat mundësojnë realizimin e plotë të gjithë veprimtarisë akademike, shkencore dhe intelektuale.



ALBANIAN UNIVERSITY

ALBANIAN
UNIVERSITY
ALBANIAN
UNIVERSITY
ALBANIAN
UNIVERSITY

STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL, AU

“Albanian University” ka hartuar Strategjinë për zhvillimin institucional për vitet 2017-2022. Kjo strategji është hartuar me qëllim për të qenë e pajtueshme me prirjet kryesore të zhvillimit të IAL në Evropë dhe në botë, dhe në veçanti, me procesin e Bolonjës. Qëllimi është të përmirësojë Albanian University, në drejtime të ndryshme, në mënyrë që ky Institucion të renditet mes Institucioneve më cilësore të Arsimit të Lartë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Strategjia është në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, Statutin dhe Rregulloret e Institucionit. Ajo është fryt i një bashkëpunimi serioz midis Bordit të Administrimit dhe niveleve më të larta akademike.

Objektivat strategjike për realizimin e misionit të universitetit në pesë vitet e ardhshme do të përqendrohen në drejtimet e mëposhtme:

- Objektivat e Organizimit Institucional;
- Mësimdhënia, Kurrikulat dhe Mësimnxënia me në qendër formimin e studentëve;
- Kërkimi Shkencor dhe Inovacioni;
- Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë;
- Veprimtaritë Shërbyese;
- Marrëdhëniet me Jashtë.



STRATEGJIA E KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTET INSITUCIONALE

“Albanian University”, në fushat e studimit, kërkimit shkencor dhe të zhvillimit ka hartuar dhe ndjek një strategji e cila është në funksion të politikave të universitetit.

Aktiviteti kërkimor shkencor i “Albanian University” bazohet, organizohet e zhvillohet në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Senati i Universitetit harton dhe miraton strategjinë bazë të kërkimit shkencor. Kjo strategji përçohet në të gjitha njësitë kryesore dhe njësitë bazë dhe konkretizohet hollësisht në planifikime e zbatime specifike gjatë çdo viti akademik.

Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimet Akademike është organ kolegjal, vendimmarrës dhe këshillimor që ngrihet pranë universitetit nga Senati Akademik për organizimin dhe drejtimin e Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, sipas Statutit të AU.

Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike formulon dhe orienton politikat e zhvillimit të veprimtarisë kërkimore-

shkencore në vijimësi; bashkërendon dhe koordinon punën kërkimore të fakulteteve dhe të departamenteve, duke respektuar liritë akademike të stafit akademik dhe drejtues; promovon veprimtarinë kërkimore-shkencore të universitetit brenda e jashtë vendit; nxit pedagogë e përgjegjës të departamenteve dhe të fakulteteve për punë kërkimore shkencore dhe pjesëmarrjen e tyre, si individë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në shkallë departamenti, fakulteti, universiteti; ndjek zbatimin e orientimeve, të planeve, të projekteve dhe tematikës e problematikës së miratuar në departamente; raporton sistematikisht në Senatin e universitetit dhe merr detyra prej tij.

Zv/Rektori për Kërkimin Shkencor është përgjegjës për mbarëvajtjen e Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike. Ai mbikëqyr veprimtarinë e kësaj Zyre, dhe është përgjegjës përpara Rektoratit për kërkimin shkencor si dhe veprimtarinë botuese të universitetit: revistën shkencore, tekstet universitare dhe publikimet tjera.

Revista “Optime” publikon studimet e kërkimeve shkencore të stafit akademik dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm, hap rubrika për diskutime e debate shkencore për probleme dhe aspekte të ndryshme akademike, kërkimore e shkencore, por edhe të fushave të ndryshme: politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, etj.



Pranë universitetit janë ngritur laboratorët paraklinikë të anatomisë normale, kimisë inorganike dhe organike, histologjisë, fizikës, botanikës, stomatologjisë, kimisë farmaceutike, biologjisë, informatikës, grafikës dhe pikturës monumentale, elektronikës, simulimeve, projektimit arkitektonik, urbanistikës, topografisë, C.A.D., etj të cilat janë pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme laboratorike dhe audio-vizive, si për zhvillimin normal të praktikave laboratorike, ashtu dhe për kërkime shkencore.

Qendra AU është një OJF e themeluar nga “Albanian University” në vitin 2013 për të nxjerrë në pah dhe pasuruar ekspertizën dhe menaxhimin e projekteve kërkimore - shkencore.

Qendra e Sipërmarrjes Inxhinierike dhe Teknologjike (Engineering and Tech Entrepreneurship Center (ETEC)), është një divizion i Qendrës AU, e themeluar në vitin 2017, që synon të inkurajojë studentët dhe profesionistët e rinj që studiojnë në AU, por jo vetëm, për identifikimin dhe zbatimin e ideve të reja në inxhinieri dhe teknologjinë e informacionit. Kjo qendër ofron shërbime inkubimi dhe akselerimi për bizneset start - up në inxhinieri dhe disiplina të ICT.

“Albanian University” ka në fokus zhvillimin dhe aplikimin e projekteve për programet INTERREG,

IADs, IPA - CBC, COSME, Erasmus Plus, H2020, Creative Europe dhe programe të tjera të financimit kombëtar.

Aktualisht, në vitin 2019, projektet e fituara dhe të zbatuara janë: (1) Sistemi Nano – I kufizuar HypoSens -mbyllur për zbulimin e kancerit të gjirit të përhapur në nyjet limfatike; H2020 (2) Avancimi i të diplomuarve dhe zhvillimi i kapaciteteve universitare në Shqipëri GRADUA - Erasmus + KA2.

AU ka disa projekte në fazën e vlerësimit të tilla si: “BLOW-UP” Djegia e tumorit me dritë nëpërmjet formësimit optik të valëve dhe reagimeve foto-akustike (Horizon 2020, Shkencë Ekselente, ERC), ALB- ERN (Horizont 2020, Veprimet e Marie Skłodowska-Curie, Nats Evropiane e Kërkuesve); Projektet Erasmus KA2 dhe KA1.

“Albanian University” ka krijuar partneritete strategjike me institucionet kërkimore të vendeve, si: Italia, Austria, Spanja, Polonia, Bullgaria, Rusia, Kina, etj., me partnerët rajonalë, si Kosova; dhe partnerët kombëtarë, si: Dhomat Kombëtare të Tregtisë, Shoqata e Bankave dhe OJF të tjera dhe SME-të në të gjithë vendin etj.



ALBANIANUNIVERSITY PRESS

“Albanian University Press” është Shtëpia Botuese e orientuar në botimin e teksteve në nivel universitar dhe për një lexues të përgatitur profesionalisht apo me ambicien për të thelluar apo përditësuar dijet e marra.

E regjistruar në gjykatë më 17.11.2006 dhe certifikuar pranë Zyrës Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit më 28.01.2008, botimet e “Albanian University Press” certifikohen dhe janë të pajisura të gjitha me ISBN.

Synim është prodhimi dhe shpërndarja e informacionit a literaturës në një kohë sa më të shpejtë, të përditësuar me të dhënat më të fundit, për të qenë në kontakt me tendencat dhe transformimet në politikë a shkencë, një motor zhvillimi jo vetëm për universitetin, por për mbarë shoqërinë.

“Albanian University Press” ka në katalogun e saj mbi 265 tituj, autorë shqiptarë dhe të huaj, falë iniciativave individuale dhe institucionale, mbështetur financiarisht kryesisht nga Albanian University. Lista jonë gjithmonë në rritje me libra të zgjedhur pasqyron angazhimin në ofrimin dhe zgjerimin e literaturës për dashamirësin e librit dhe pasurimin e vlerave të kulturës e shkencës shqip.

“Albanian University Press”, brenda vendit, bashkëpunon me Departamentet e “Albanian University” për botimin e libërthave të konferencave apo simpoziumeve shkencore; me pedagogët e Albanian University, me ente të ndryshme private e shtetërore apo individë, të interesuar për të materializuar idetë, teknika e projekte në libra dinjitozë dhe konkurrues në tregun e botimeve shqip, bashkëpunon me Shtëpi Botuese të Huaja, lider në fushën e botimeve, për shqipërimin e titujve më të mirë të tyre:

- Shtëpinë Botuese Elsevier për tituj nga Dentistria dhe Farmacia;
- Me Shtëpitë Botuese McGraw-Hill Companies;
- Cengage Publishing Services ltd;
- Island Press
- Harvard University Press për tituj nga shkencat humane apo ato aplikative.

Botimet e “Albanian University Press” mund t’i gjeni në librarinë e universitetit në rrugën e Durrësit (pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore), në Tiranë.



PRAKTIKAT MËSIMORE

Departamenti i Farmacisë

Për zhvillimin e praktikave laboratorike janë në shërbim të studentëve laboratorët përkatës, të pajisur me aparatura nga më bashkëkohoret. Nga ana tjetër për semestrin e 10^{-të} (semestri i 2^{-të} i vitit të 5^{-të}) është parashikuar praktikë profesionale, e cila zhvillohet në farmacitë e rrjetit të hapur për publikun dhe jo vetëm në farmacitë e vendit tonë, por edhe në Kosovë e Maqedoni (sipas vendbanimit të studentëve).

Departamenti i Infermierisë dhe i Fizioterapisë

Praktika mësimore e Infermierisë është e shtrirë në dy vite akademike, në vitin e dytë dhe vitin e tretë. Në vitin e dytë studenti e realizon praktikën në klasë, e cila është e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme manipuluese si manekin, monitor, EKG, aspirator, perfuzione, injeksione intramuskulare, intradermale, ekzaminime endoskopike, etj. Në vitin e tretë studenti e realizon praktikën pranë shtrimit të sëmurit në kushte spitalore. Universiteti për realizimin e praktikës së vitit të tretë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe private si: Spitali Universitar i Traumës, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë, Spitali SUOGJ

“Mbretëresha Geraldinë”, Spitali “Koço Glozheni”, “Spitali Rajonal Fier”, “Spitali Rajonal Berat”, Klinika Mjekësore “Halili”, “Autoriteti Shëndetësor” Tiranë (ASHR).

Praktikat mësimore të parashikuara në Kurrikulën e Fizioterapisë zhvillohen në vitin e dytë dhe të tretë ku një pjesë e praktikës zhvillohet në klinika shtetërore dhe private si: klinikat e specializuara fizioterapie private dhe klinikat shtetërore si: Qendra e Rehabilitimit të Fizioterapisë “Kiropraktikë”, Qendra e Rehabilitimit të Fizioterapisë “Primavera”, Qendra e Rehabilitimit të Fizioterapisë “Balance”, Qendra e Rehabilitimit të Fizioterapisë “Orthomed Sport”, Shoqata e Rehabilitimit Fizik si dhe “Agjencia e Shërbimit të Sporteve”, Tiranë.

Departamenti i Arkitekturës

Programi i Dizajn-it

Praktika mësimore e programit të studimit Bsc. Dizajn zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të fundit akademik (viti i tretë).

Në sajë të bashkëpunimeve me institucione/studio të ndryshme private apo shtetërore, programi i praktikës përgatit gjeneratën e ardhshme të profesionistëve për t’iu përgjigjur kërkesave të reja të tregut në botën komplekse të komunikimit vizual. Programi praktik i



përgjigjet nevojës në rritje për profesionistë të aftë për të menduar rreth projektimit dhe përkthimit të tij në gjuhë të ndryshme të komunikimit bashkëkohor duke përdorur një sërë teknikash të ndryshme: nga teknikat tradicionale grafike tek programet kompjuterike të dizajn-it; nga web dizajni e deri në menaxhimin e programeve multimediale.

Aftësitë e zhvilluara dhe të mësuarat gjatë kursit praktik do t'i pajisë studentët me mjetet e nevojshme për të shkuar drejt diplomimit e më tej, të aftë për menaxhimin me profesionalizëm të inovacionit të vazhdueshëm teknologjik dixhital në teknikat e komunikimit vizual, sikurse e kërkon gjithnjë tregu bashkëkohor.

Departamenti i Inxhinierive

Në kuadër të praktikave mësimore të parashikuara në vitin e fundit të programeve të studimit Bachelor dhe Master i Shkencave, Departamenti i Inxhinierive bashkëpunon me institucione publike dhe private, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushat e interesit të programit.

Departamenti i Shkencave Ekonomike

Kurrikulat e Departamentit të Shkencave Ekonomike

i kushtojnë vëmendje të posaçme aftësimin praktik të studentëve për t'ju përshtatur kërkesave të tregut të punës. Shumica e lëndëve kanë karakter aplikativ, rrjedhimisht për qartësimin më mirë të trajtimit teorik, shoqërohen me ushtrime të cilat paraqesin situata hipotetike apo reale. Në këtë mënyrë studentët fitojnë aftësitë praktike për t'u ambientuar shpejt në pozicionin e punës ku ata punësohen. Është kjo një nga arsyet pse studentët e këtij departamenti janë nga më të pranuarit në tregun aktual të punës. Shumica e studentëve janë të punësuar me sistemin financiar e bankar, në biznese të prodhimit apo të shërbimit si: banka, institute sigurimesh, sistemin e tatimitaksa apo doganor, sipërmarrje prodhimi, ndërtimi, shërbimesh si dhe institucione të administratës së lartë shtetërore. Nga ndjekja në dinamikë e punësimit të studentëve të diplomuar rezulton se 75-80% e studentëve punësohen që në vitin e parë të mbarimit të fakultetit.

Departamenti i Shkencave Juridike

Departamenti i Shkencave Juridike në bashkëpunim me institucionet publike dhe private si: “Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda” Tiranë, “Gjykata e Rrethit Gjyqësor” Tiranë, “Ministria e Drejtësisë”, “Gjykata Kushtetuese”, “Arkiva e Shtetit”, “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”, “Dhoma Kombëtare e



Ndërmjetësimit”, zhvillojnë praktikën mësimore të ndarë në drejtimin civil dhe penal. Praktika gjyqësore zhvillohet në vitin e tretë të ciklit të studimit duke i dhënë kështu mundësi reale në konstatimin praktik e të ndërthurur të njohurive teorike që studenti ka fituar në vite. Ndjekja dhe monitorimi i praktikave të studentëve bëhet nga pedagogë të brendshëm, të caktuar nga departamentet përkatës. Vlerësimi i punës së studentëve gjatë zhvillimit të praktikës, i shkallës së përfitimit personal të tyre në praktikat mësimore, bëhet me notë nga pedagogu që ka ndjekur praktikën. Në përfundim të kësaj lënde studenti do të realizojë programin që synon drejt dhënies së shprehive praktike lidhur me njohjen e procedurës së pranimit të kërkesës së padive në gjykatë dhe provave që i bashkëngjiten asaj, procedurën e hedhjes së shortit, regjistrimin e padisë, njohjen me elementet praktike të procedurës së gjykimit, njohja me funksionin praktik të procedurës së gjykimit, njohja me sektorët ndihmës së Gjykatës (sekretaria), njohja me “aktorët” e një procedure gjyqësore, etj.

Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative

Praktikat mësimore janë parashikuar si pjesë përbërëse e programit mësimor-formues për studentët e vitit të III-të të Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative. Qëllimi i praktikës në institucione

është njohja dhe familjarizimi i studentëve me procesin praktik politik. Gjatë praktikës, studentët vihen në rolin e të punësuarit në këto institucione me të gjitha përgjegjësitë e parashikuara. Si pjesëmarrës në praktikën politike, synohet që të zhvillohen shkathtësitë e studentëve për të vendosur lidhjen nëpërmjet instrumenteve njohëse që marrin gjatë procesit mësimor dhe politikës në veprim. Studenti do të ndjekë të gjithë atë që quhet cikël politik duke përfshirë hyrjet (“inputs”), kthimin e kërkesave dhe vendimeve, daljet (“outputs”), reagimin ndaj daljeve e deri tek reagimi i institucionit ndaj aktorëve të tjerë politikë ose shoqërore.

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme

Programet mësimore të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme janë mbështetur në modele kurrikulare të shkollave amerikane dhe evropiane të psikologjisë dhe është hartuar duke njohur këto zhvillime të psikologjisë si shkencë dhe kërkesat e tregut shqiptar të punës së psikologëve. Programi Bachelor në Psikologji të Përgjithshme përfshin zhvillimin e praktikës mësimore me qëllim informimin dhe njohjen e studentëve me rolin e psikologut në institucionet që ofrojnë shërbime psikologjike në fusha: të shëndetit, edukimit, ligjit, administratës dhe shërbimeve sociale. Në tërësinë e



vet praktika mësimore synon që studentët të mund të integrojnë njohuritë dhe informacionet teorike me përvojën vëzhguese dhe njohëse në terrenin praktik, të kultivojnë marrëdhënie ndërpersonale.

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes

Praktikat mësimore zhvillohen në bashkëpunim me “Drejtorinë Arsimore Tiranë” dhe “Drejtorinë Arsimore Durrës”. Studentët gjatë zhvillimit të

praktikave ndiqen nga pedagogë mentorë. Praktikat në Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes zhvillohen në institucionet publike ashtu dhe private. Ato mbikëqyren nga pedagogë përgjegjës me përvojë akademike në fushën e mësimdhënies. Gjatë dy viteve të para të studimit universitar janë parashikuar kryesisht lëndët e formimit të përgjithshëm. Teoria në disiplinat mësimore të formimit profesional është kombinuar me praktikat mësimore në institucionet arsimore.



LABORATORËT DHE KËRKIMI SHKENCOR

Për të menaxhuar një proces të rregullt mësimor dhe kërkimin shkencor në nivel departamenti dhe fakulteti, “Albanian University” siguron ambientet e duhura laboratorike të cilat janë paraqitur sipas Fakulteteve:

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

- **Laboratori i Edukimit figurativ** është në funksion të realizimit të procesit mësimor në programet e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” dhe “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”. Lënda e Edukimit figurativ është ajo e cila u vjen në ndihmë dhe u mundëson studentëve të këtyre programeve të studimit përgatitjen e një platforme të gjerë dhe të qartë të kuptimit të fushave që mund të shpjegohen me stile, objekte, materiale te riciklueshme, vizime, dekore etj. Të gjitha punimet me përmbajtje të tillë realizohen në laboratorin e ngritur për këtë qëllim. Laboratori i edukimit figurativ është i pajisur me materialet e nevojshme për realizimin e punimeve nga ana e studentëve.

- **Laboratori i Edukimit muzikor** është i pajisur me disa vegla muzikore ku studentët realizojnë orët e praktikave në lëndën e Edukimit muzikor dhe Didaktikës së edukimit muzikor. Ky laborator është i pajisur me vegla muzikore si violina, kitare dhe bateri.

- **Laboratori i Informatikës** ka mundësi që t’ju shërbejë disa programeve të studimit të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, si dhe Departamentit të Shkencave Ekonomike, sipas një skedulimi normal të orarit të punës. Ky laborator konsiston në një sallë të pajisur me 25 kompjutera e cila shfrytëzohet për zhvillimin e lëndëve “Informatikë”, “Manaxhimi i Sistemeve të Informacionit” etj.. Laboratori i Informatikës nëpërmjet programeve të instaluar “Paketa Office” dhe “SPSS” ndihmon studentët për punët dhe detyrat që kanë në programin e secilës lëndë apo edhe në temat e diplomave.. Në këtë laborator janë të instaluar edhe programe të cilat iu vijnë në ndihmë studentëve të programit të studimeve Bsc. “Anglisht”. Laboratori shfrytëzohet për një pjesë të mirë të zhvillimit të lëndëve të këtij programi studimi.



FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA DHE EKONOMIKE

- **Laboratorët e Informatikës 1-2 (Simulimeve)** janë në funksion të Departamentit të Inxhinierive dhe Departamentit të Arkitekturës. Këto laboratore konsistojnë në dy salla kompjuterash, në të cilët janë instaluar softëare të ndryshëm, të përdorur në ambjentet akademike inxhinierike ndërkombëtare për programimin dhe simulimin e sistemeve të ndryshme inxhinierike. Këto ambiente mundësojnë realizimin e simulimeve virtuale, në rastet e pajisjeve apo sistemeve të ndryshme, që aktualisht nuk janë në dispozicion të studentëve në laboratorët e përshkruar më poshtë, me të cilët gjithsesi pritet që ata të pasurohen në të ardhmen. Në këto laboratorë janë të instaluar edhe programet më të sofistikuar në manipulimin e krijimin e grafikës 2D, 3D e të animuar si: AutoCAD, Photoshop, Illustrator, Corel DraëInDesign, InDesign, 3ds Max etj.

- **Laboratori i Infrastrukturës së Rrjetave** Në njërin prej laboratorëve të informatikës, janë instaluar pajisje, përmes të cilave mundësohet realizimi i një numri të madh punësh laboratorike, në drejtim të rrjetave të telekomunikacionit, kryesisht në kuadër të programeve Master i Shkencave.

- **Laboratori i Fizikës** është i pajisur me instrumenta bashkëkohore, përmes të cilëve mundësohet realizimi i një numri të madh punësh laboratorike, në përputhje me programet e lëndëve të formimit bazë Fizikë 1 dhe Fizikë 2.

- **Laboratori i Elektroteknikës**, i pajisur me instrumenta e aparatura të ndryshme në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës, e afron studentin gjithmonë e më shumë me një vëzhgim praktik të njohurive të marra në auditor, në këtë rast në lëndët Elektroteknikë 1 dhe Elektroteknikë 2.

- **Laboratori i elektronikës analoge\laboratori i elektronikës dixhitale** përmban module me gjysëmpërçues dhe qarqe të integruara, duke ju dhënë mundësinë studentëve që të realizojnë matje të ndryshme dhe të nxjerrin karakteristikat e elementëve bazë të qarqeve elektronike. Laboratori përmban edhe module zhvillimi, në të cilat studentët mund të ndërtojnë dhe testojnë skema të ndryshme të hartuara nga vetë ata. Matja në laborator mund të realizohet me simulimin e aparateve digjitale dhe analoge ose nëpërmjet një softëare-i kompjuterik, i cili mundëson përpunime të mëtejshme të matjeve.

- **Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike** është i pajisur me aparatura bashkëkohore, të cilat bëjnë të mundur realizimin e punëve laboratorike





të lëndëve Matje elektrike dhe elektronike 1 dhe 2, dhe pjesërisht të lëndëve Sensorët dhe instrumentim procesesh 1 dhe 2. Gjatë këtyre punëve laboratorike, studenti njihet me strukturat e aparateve dhe metodat e matjes së madhësive të ndryshme elektrike.

- **Laboratori i automatikës dhe kontrollit (dhe Mekatronikës)** përmban një impiant i cili mundëson disa procese, kontrolli i parametrave të të cilëve realizohet drejtëpërdrejtë nga studentët nëpërmjet modulit të kontrollit. Kontrolli mund të realizohet, gjithashtu, edhe nëpërmjet PLC-së (Programmable Logic Controller). Programet e kontrollit për PLC-në, ndërtohen nga vetë studentët. Matjet e realizuara përpunohen më tej nga softëare-i përkatës.
- **Laboratori i makinave elektrike** është i pasuruar me pajisje të teknologjisë së fundit, që mundësojnë studimin eksperimental dhe simulimin e pajisjeve dhe sistemeve të trajtuara dhe studiuara teorikisht në lëndët Makina elektrike 1 dhe 2, Transmisione elektrike dhe disiplina të tjera të përafërta.

- **Sallat e praktikës 1,2,3** shërbejnë për zhvillimin e orëve praktike mësimore në lëndët e vizatimit, pikturës monumentale dhe grafikës. Sallat janë të pajisura me mjete bashkëkohore, përmes të cilave mundësohet realizimi i një numri të madh punësh praktike, në përputhje me programin e lëndëve.

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

- **Laboratori i morfologjisë dentare dhe protetikës** është i pajisur me 60 vende individuale pune, dhe u mundëson studentëve njohjen me format e dhëmbëve, karakteristikat e protezave parciale të thjeshta dhe të skeletuara, mënyrën e marrjen së masave, ndërtimin e modelit të protezës, përpunimin dhe përshtatjen e saj, etj.

- **Laboratori paraklinik i terapisë stomatologjike** u shërben studentëve për të njohur instrumentat e punës dhe për të mësuar përdorimin e tyre, para se të fillojnë aplikimin praktik me pacientë, pranë Klinikës Universitare. Përdorimi i tubinave, angleve, frezave, pasqyrave, sondave, përgatitja e kavitetit, hapja, përgatitja dhe mbushja e rrënjëve të dhëmbit fillimisht në modelet e allçisë, dhe më pas në modelet e rezinës të fiksuara në kokat fantomë janë disa nga procedurat praktike. Studentët plotësojnë kështu përgatitjen në lëndët e dentistrisë operative, dentistrisë pediatrike dhe endodontisë.

- **Laboratori i Biologjisë** është i kompletuar me aparatet e nevojshme si mikroskopë, tabela, preparate mikroskopike, reagentë, etj., në dispozicion të studentëve me qëllim realizimin e orëve laboratorike në lëndën e Biologjisë.



• **Laboratori i Fizikës** u vë në dispozicion studentëve aparaturat, pajisjet dhe mjetet më të domosdoshme. Studentët kanë mundësi të përdorin thjerrat optikë në ndërtimin dhe përdorimin e mikroskopit optik, dhe aplikimit të njohurive në praktikën e përditshme profesionale. Rëndësia e koncepteve fizike bëhet më e qartë, gjatë punës praktike për përcaktimin e dendësisë së trupave të ngurtë dhe të lëngët, rrymave elektrike të vazhdueshme e alternative dhe krijimit të tyre, tensionit sipërfaqësor dhe ndryshimit të tij, lëvizjes së tretësirave në tubat kapilarë, termostatit dhe ruajtjes së pandryshueshme të temperaturës.

• **Laboratori i Kimisë Analitike** është i pajisur me të gjitha aparaturat dhe pajisjet e nevojshme për një proces mësimor normal, si: bureta, pipeta, furra mufël, termostate, centrifugë, mjete për tharjen e enëve kimike, etj. Në këtë laborator studentët mësojnë analizën cilësore dhe sasiore të lëndëve të ndryshme kimike.

• **Laboratori i metodave fiziko – kimike të analizës** është pajisur me një sërë aparaturash bashkëkohore të Analizës fiziko-kimike. Nga këto aparate mund të përmenden ndër të tjera: spetkrofotometra (2) në zonën VIS –UV, gaz kromatograf, kromatograf në fazë të lëngët me trysni të lartë, etj.

• **Laboratori i Kimisë fizike e koloidale** u shërben lëndëve të formimit profesional të studentëve të farmacisë dhe është i pajisur me një bazë laboratorike të kompletuar. Praktikrat laboratorike të kimisë fizike e koloidale luajnë një rol të rëndësishëm për përgatitjen e specialistëve të shërbimit farmaceutik, dhe zhvillohen në të gjitha Universitetet farmaceutike të botës.

• **Laboratori i Kimisë farmaceutike** është i pajisur me mjetet, pajisjet dhe aparaturat me moderne që përdoren sot edhe në vendet më të zhvilluara të botës, si: polarimetra, refraktometra pH-metra, spektrofotometra VIS –UV, gaz kromatograf, kromatograf në fazë të lëngët me trysni të lartë, furra mufël, termostate, etj.

• **Laboratori i Teknologjisë Farmaceutike** është i pajisur me të gjitha lëndët e para, reagentët, pajisjet dhe aparaturat e domosdoshme për të realizuar praktika normale (havane, banjo uji, autoklava, përzierës elektrike e magnetike, termostate, etj). Gjatë orëve laboratorike studentët punojnë në mënyrë të pavarur, nën mbikqyrjen e pedagogut, për përgatitjen e barnave të ndryshme, për përdorim të brendshëm e të jashtëm, si: tretësira, shurupe, emulsione, pezulli, pomade, injeksione supozitorë, tableta, si dhe për përgatitjet kozmetike si locione, kremra, etj..





• **Laboratori i Farmakognozisë** është i pajisur me mikroskopët dhe aparatet analitike të analizës fiziko-kimike (spektrogotometra VIS –UV, fazkromatograf, HPLC etj). Gjatë orëve laboratorike studentët njihen me mikroskopinë e bimëve mjekësore dhe me analizën kimike të lëndëve vepruese, që këto bimë përmbajnë.

• **Laboratori i Kimisë së Përgjithshme e Inorganike** i shërben pjesës teorike të njërës prej disiplinave më të rëndësishme që zhvillohen në Departamentin e Farmacisë, Stomatologjisë, si dhe Inxhinierive, ku studentët marrin njohuritë bazë në lëndën e kimisë së përgjithshme e inorganike. Ky laborator është i pajisur me të gjitha aparaturat dhe mjetet e domosdoshme, si edhe në reagentët dhe lëndët e para të nevojshme për të zhvilluar një proces mësimor në kushte optimale.

• **Laboratori i anatomisë normale (njeriut) dhe histologjisë së përgjithshme** u shërben studentëve të Departamentit të Farmacisë dhe Stomatologjisë për realizimin e praktikave mësimore. Skematizmi teorik, që shoqëron imazhin audioviziv deskriptiv, pasohet nga studimi i detajuar i mulazheve të çdo sistemi të organizimit, duke mundësuar kështu jo vetëm një formim në anatonominë deskriptive, por edhe në atë topografike. Kjo praktikë pasohet nga studimi makro dhe mikroskopik i secilës pjesë anatomike të organizimit, në laboratorin e histologjisë

së përgjithshme. Me anë të punës individuale në mikroskop, përdorimit të seksioneve të parapërgatitura dhe eksperimentimit të fiksimit të ngjyrosjes indore. Kjo krahasuar me imazhin dhe përshkrimin e realizuar paraprakisht me anë të fotografive mikroskopike, qartëson diversitetin qelizor dhe lidhjen strukturë-funksion, që mundëson konceptimin e organizimit si njësi e pandashme anatomike funksionale.

• **Laboratori i Kimisë Organike** është i pajisur me të gjitha mjetet dhe reagentët e nevojshëm, çka mundëson zhvillimin e një praktike më se normale. Lëndët që sintetizohen nga ana e studentëve i nënshtrohen një analize kimike të hollësishme me qëllim që të verifikohet cilësia e tyre. Kimia Organike mund të konsiderohet si një nga disiplinat mësimore më të rëndësishme të formimit të përgjithshëm të specialitetit të lartë farmaceutik, pa përvetësimin e bazave të së cilës nuk është e mundur të kuptohen një varg disiplinash mësimore, që zhvillohen në vitet pasardhëse, si: Biokimia, Kimia Farmaceutike, Kimia toksikologjike, Kimia dhe Teknologjia e ushqimeve. Gjithashtu për Departamentin e Stomatologjisë, është një modul që ndikon në formimin e mëtejshëm të njohurive të përfuara nga shkolla e mesme, me synimin që studenti të bëjë ndërlidhjen me modulet e tjera pasuese të kurrikulës së Stomatologjisë, psh: Biokimi.



KLINIKA UNIVERSITARE STOMATOLOGJIKE “ÇERÇIZ MINGOMATAJ”

Është e pajisur me licencë nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Që në vitin 2006, Klinika mbështet funksionimin e ALB Departamentit të Stomatologjisë, me sallat e mirë-profilizuara të pajisura me 74 poltronat dentare (me facilitetet përkatëse: ndriçim, ajër, ujë, lëvizshmëri sipas situatës klinike, aspirator kirurgjikal, kavatron, llamba polimerizuese etj) të sterilizueshme pas çdo pacienti. Secila sallë ka specifikat e veta për lëndën që mbulon, si rrjedhojë, edhe materialet mbështetëse për realizimin e punimeve klinike janë specifike, sipas karakteristikave të çdo salle, konkretisht:

- Salla e terapisë (dentisteri e endodonti),
- Salla pedodontisë për trajtimin e moshave 3-16 vjeçare;
- Salla e ortodontisë;
- Salla e protetikës fikse e të lëvizëshme së bashku me laboratorin e studentëve;
- Salla e kirurgjisë ambulatorë;
- Salla e periodontologjisë dhe e sëmundjeve të mukozave,

- Sallat e Kirurgjisë Orale dhe Implantologjisë struktura të “Day Hospital” në shërbim të studentëve dhe specializantëve.

- Salla e ekzaminimit radiografik dixhital.

•KLINIKA E FIZIOTERAPISË

Po në këtë Fakultet në kuadër të programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi” dhe Masterit Profesional në “Terapi Manuale”, që prej vitit 2016, është ngritur Klinika e Fizioterapisë.

Në klinikë studentët zhvillojnë praktikat profesionale mësimore në auditor, nën udhëheqjen e pedagogëve të Departamentit të Infemierisë dhe Fizioterapisë. Kushtet dhe mjetet bashkëkohore të klinikës mundësojnë formimin optimal për fizioterapistët e ardhshëm që diplomohen në këto programe studimi.

Klinika e Fizioterapisë Albanian University është një vlerë e shtuar për Universitetin jo vetëm në kompletimin me orë praktike të lëndëve si: Principet e lëvizjeve, Rehabilitimi ortopedik, Rehabilitimi prostetik, Rehabilitimi pediatrik, Rehabilitimi kardio-pulmonar, Geriartri dhe rehabilitim geriartrik, Rehabilitim fizik, Fizioterapi instrumentale, Rehabilitim në sport, Rehabilitimi në Terapinë manuale, Metodologjia e Terapisë manuale, të Programeve të Studimit që ofrojmë por edhe tashmë edhe si një shërbim cilësor për të tretë.





LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

A. Programet: Bachelor

- | | |
|-----------------------|--------|
| 1. INFERMIERI | 3 vite |
| 2. FIZIOTERAPI | 3 vite |
| 3. HIGJENIST DENTAR * | 3 vite |

B. Programet: Master profesional

- | | |
|--|-------|
| 1. INFERMIERI KIRURGIKALE | 1 vit |
| 2. TERAPI MANUALE | 1 vit |
| 3. INFERMIERISTIKA E SËMUNDJEVE KRONIKE
DHE GERODONTOLOGJIA * | 1 vit |

C. Programet Master i Shkencave (Program i integruar i ciklit të dytë)

- | | |
|-----------------|--------|
| 1. STOMATOLOGJI | 5 vite |
| 2. FARMACI | 5 vite |

D. Programet: Specializime Afatgjata në Stomatologji (SPA)

- | | |
|-------------------|--------|
| 1. ORTOGNATODONCI | 3 vite |
| 2. KIRURGJI ORALE | 4 vite |

F. Programet me karakter profesional

- | | |
|------------------------------|--------|
| 1. LABORANT I LARTË DENTAR * | 2 vite |
|------------------------------|--------|



FAKULTETI I SHKENCAVE TE APLIKUARA DHE EKONOMIKE

A. Programet: Bachelor

1. TEKNOLOGJI INFORMACIONI	3 vite
2. INXHINIERI KOMPJUTERIKE	3 vite
3. INXHINIERI ELEKTRONIKE	3 vite
4. INXHINIERI MEKATRONIKE	3 vite
5. INXHINIERI ELEKTRIKE	3 vite
6. DIZAJN	3 vite
7. FINANCË - BANKË	3 vite
8. MENAXHIM BIZNESI	3 vite

B. Programet: Master i Shkencave

1. TEKNOLOGJI INFORMACIONI	2 vite
2. INXHINIERI ELEKTRONIKE	2 vite
3. MENAXHIM BANKAR	2 vite
4. ADMINISTRIM BIZNESI	2 vite

C. Programet: Master Profesional

1. ADMINISTRIM BIZNESI	1 vit
2. MENAXHIM FINANCIAR DHE BANKAR	1 vit
3. NDËRMJETËS FINANCIAR (me 3 profile) *	1 vit
• <i>LETRA ME VLERË;</i>	
• <i>SIGURIME;</i>	
• <i>PASURI TË PALUAJTSHME</i>	
4. SISTEME TË ENERGJISË	1 vit
5. INXHINIERIA E INTELIGJENCËS SË BIZNESIT *	1 vit
6. INTERIER DIZAJN	1 vit

**FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE****A. Programet: Bachelor**

1. SHKENCA JURIDIKE	3 vite
2. SHKENCA POLITIKO - ADMINISTRATIVE	3 vite
3. PSIKOLOGJI E PËRGJITHSHME	3 vite
4. MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR	3 vite
5. MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR	3 vite
6. ANGLISHT	3 vite

B. Programet: Master i Shkencave

1. SHKENCA JURIDIKE (me profile)	2 vite
• E DREJTË PUBLIKE DHE ADMINISTRATIVE	
• E DREJTË PRIVATE	
• E DREJTË PENALE	
2. ADMINISTRIM PUBLIK (me profile)	2 vite
• POLITIKA PUBLIKE DHE QEVERISJE	
• POLITIKAT PUBLIKE DHE BASHKIMI EUROPIAN	
3. PSIKOLOGJI KLINIKE	2 vite
4. MËSUESI NË GJUHËN ANGLEZE *	2 vite



C. Programet: Master Profesional

1. SHKENCA PENALE	1 vit
2. E DREJTË PRIVATE	1 vit
3. QEVERISJE DHE ADMINISTRIM PUBLIK	1 vit
4. PSIKOLOGJI KLINIKE	1 vit
5. PSIKOLOGJI SHKOLLORE	1 vit
4. PEDAGOGJI (me profile)	1 vit
• DIDAKTIKË	
• MENAXHIM ARSIMI	
5. GJUHË ANGLEZE (ME PROFILE) *	1 vit
• ANGLISTIKË – AMERIKANISTIKË	
• PËRKTHIM	

D. Programet me karakter profesional

1. KUJDES PROFESIONAL NDAJ FËMIJËVE *	2 vite
---------------------------------------	--------

*Programet e studimit ofrohen për herë të parë në Albanian University dhe janë në pritje të licensimit nga MASR.



ALBANIAN UNIVERSITY ORGANIZOHET NË 3 FAKULTETE:

- Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;
- Fakulteti i Shkencave Shoqërore.

Në zbatim të nenit 23 të Ligjit Nr. 80/2015, Fakultetet janë njësi kryesore që bashkërendojnë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura, përkatësisht në shkencat mjekësore; në shkencat e aplikuara dhe ekonomike dhe në shkencat shoqërore.

Fakultetet në AU ofrojnë programe të cikleve të

ndryshme të studimit, në përfundim të të cilave lëshohen diploma përkatëse, në përputhje me ciklet e studimit.

Fakultetet në AU, janë të organizuara në njësi bazë, sipas përcaktimeve të dhëna në nenin 14 të këtij Statuti. Këto njësi bazë janë të organizuara si Departamente, në secilin Fakultet. Fakulteti drejtohet nga Dekani, i cili emërohet nga Senati Akademik, sipas përcaktimeve të dhëna në nenin 29, pika 3 të këtij Statuti.

Autoritete të tjera drejtuese janë Përgjegjësitet e Departamenteve. Organ drejtues është Asambleja e Personelit Akademik. Struktura Administrative e Fakultetit përbëhet nga Sekretaria Mësimore dhe nga Personeli Ndihmës.

Qëllimi i njësive kryesore është organizimi i procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në departamentet që përfshijnë. Njësia kryesore synon të nxisë sa më shumë respektimin e lirisë dhe të dinjitetit, pluralizmit të ideve, transparencës së procedurave si dhe mendimin e lirë të pedagogëve dhe të studentëve. Njësia kryesore kujdeset për përmirësimin e cilësisë së procesit akademik në të gjitha ciklet dhe nivelet, promovon bashkëpunimin me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, administratën shtetërore si dhe bashkëpunimin mes studentëve dhe stafit akademik për arritjen e qëllimeve institucionale.





FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

Ky fakultet është njësi kryesore akademike e Albanian University që zhvillon procesin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor në fushat e lidhura me profilet mjekësore të njohura dhe licencuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Fakulteti përbëhet nga Departamenti i Stomatologjisë, Departamenti i Farmacisë dhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë.

DEPARTAMENTI I STOMATOLOGJISË

Departamenti i Stomatologjisë është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, ka nisur funksionin e tij në Shtator 2004. Ky departament ofron programet e studimit:

Master i Shkencave (Program i Integruar i Ciklit të dytë)

-Stomatologji

Bachelor

-Higjienist Dentar *

Programe me karakter profesional

-Laborant i Lartë Dentar *

**Programi i studimit Master i Shkencave në
“Stomatologji”** (Programi i integruar i ciklit të dytë)

Programi i integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Stomatologji” ka një kohëzgjatje 5 vjeçare, me një numër total prej 300 kreditesh dhe kohë të plotë studimi. Ky program është miratuar me vendim të



Këshillit të Ministrave, Nr. 197, datë 10.04.2004. Ai është akredituar për herë të parë nga MASH, me urdhër Nr. 388, datë 23.07.2010 dhe riakredituar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, me Vendim Nr. 88, datë 21.09.2017.

Objektivat dhe kompetencat që fitohen

Fokusi primar i këtij programi është formimi teoriko-praktik modern i studentëve, bazuar në modelin e Universitetit TUFT-s Boston, të mbështetur kryesisht në literaturën amerikane të këtij universiteti.

Ky program mundëson përgatitjen e studentit sipas standardeve të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare dhe synon të realizojë një individ të aftë që të krijojë, meditojë, kërkojë dhe të zhvillohet me bagazhin teoriko-praktik që i ofrohet, për të krijuar bindje moderne dhe të qëndrueshme mjekësore. Një tjetër vecori e programit është përfshirja e vazhdueshme e studentëve në aktivitete kërkimore shkencore dhe veprimtari akademike.

Formimi 5 vjeçar shoqërohet jo vetëm me formim të mirë paraklinik në kushte moderne, por edhe me formimin teoriko-praktik direkt në pacient, duke e aftësuar studentin që të zotërojë dhe aplikojë në praktikë, njohuritë e përfituara. Mbështetur mbi sa

më lart, deri më sot nuk janë të paktë studentët që punojnë, ose kanë arritur të përfitojnë të drejtën e një formimi akademik të mtejshëm në shumë shtete të huaja.

Mundësi profesionale

Mundësitë e punësimit të studentëve që përfundojnë këtë program studimi kanë të bëjnë në mënyrë primare me ushtrimin e profesionit si mjek stomatolog. Përtej ushtrimit direkt të këtij profesioni individualisht në klinika dentare, diplomantët e këtij programi mund të punësohen në drejtime si:

- Klinika stomatologjike universitare apo qendra shëndetësore;
- Si specialistë të shëndetit publik në dikastere të ndryshëm;
- Konsulentë në ndërtimin dhe zhvillimin e politikave publike për shëndetin oral;
- Fushën akademike si kërkues shkencorë apo mësimdhënie.

**Kurrikula e Programit të studimit Master i Shkencave në “Stomatologji”**

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	GJUHË E HUAJ 6	
2	GJUHË LATINE 4	
3	BIOFIZMAT	7
4	INFORMATIKË E APLIKUAR MJEKËSORE - MENAXHIM 7	
5	FIZOLOGJI 1	3
6	KIMI E PËRGJITHSHME 8	
7	ANATOMIA E NJERIUT 1	0
8	MORFOLOGJI - NJOHURI MATERIALE - PROFILAKSI	8
9	BIOLOGJI - GJENETIKË 7	
TOTAL		60

VITI II		
NR	LËNDA	ECTS
1	FIZIOLOGJI 2 5	
2	BIOKIMI	7
3	MIKROBIOLOGJI - KONTROLL INFEKSIONI - EPIDEMIOLOGJI	8
4	HISTOLOGJI/EMBRIOLOGJI 1	0
5	ANATOMI PATOLOGJIKE	7
6	FORMIM PARAKLINIK	17
7	MJEKËSI KLINIKE I	6
TOTAL		60



VITI III		
NR	LËNDA	ECTS
1	MJEKËSI KLINIKE II 1	0
2	ETIKË/MJEKËSI LIGJORE - DIAGNOZA ORALE - RADIOLOGJI	9
3	IMUNOLOGJI/ALERGOLOGJI 3	
4	KIRURGJI AMBULATORE	7
5	FARMAKOLOGJI 1	0
6	PATOLOGJI OMF - PERIODONTOLOGJI PARAKLINIKE	12
7	DENTISTRI OPERATIVE KLINIKE	9
TOTAL		60
VITI IV		
NR	LËNDA	ECTS
1	KIRURGJI OMF 1	1
2	URGJENCA 8	
3	DENTISTRI PEDIATRIKE 8	
4	PERIODONTOLOGJI	12
5	ENDODONTI	10
6	PROTETIKË PARAKLINIKE 1	1
TOTAL		60
VITI V		
NR L	ËNDA	ECTS
1	PROTETIKË KLINIKE 6	
2	ORTODONTI KLINIKE	5
3	MJEKËSI ORALE - GERIATRI 1	1
4	PRAKTIKË EKSTERNSHIP 1	0
5	PRAKTIKË PROFESIONALE 1	8
6	DIPLOMA	10
TOTAL		60

TOTAL 5 VITE =300 ECTS



Për vitin akademik 2019-2020, “Albanian University” ka aplikuar pranë MASR për hapjen e dy programeve të reja studimi që do të ofrohen nga Departamenti i Stomatologjisë dhe është në pritje të miratimit të tyre, si më poshtë:

Programi i studimit Bachelor në “Higjienist dentar”

Programi i studimit Bachelor në “Higjienist Dentar” është një program studimi i ciklit të parë me kohëzgjatje 3 vjeçare, dhe një total prej 180 kreditesh. Forma e studimit është me kohë të plotë.

Ky program studimi ofrohet për herë të parë në Albanian University dhe është në fazë licensimi nga MASR.

Objektivat dhe kompetencat që fitohen

Programi i studimit Bachelor “Higjienist Dentar” synon të pajisë studentët me dijet bazë në fushën e higjienistit dentar. Qëllimi kryesor i këtij programi studimi është që aplikantët të zotërojnë njohuritë teoriko-praktike për t’u formuar si profesionist dhe për t’u bërë në të ardhmen higjienistë dentarë me njohuri që ecin paralelisht me hapin e kohës.

Profesioni i higjienistit dentar është profesion i cili ka në fokus të aktivitetit të tij parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dentare. Higjienisti dentar është hallkë e rëndësishme e ekipit dentar. Puna e tij lehtëson në masë të madhe detyrat e stomatologëve, duke u

krijuar mundësinë të thellohen në procedura më të avancuara. Ndër detyrat e higjienistit dentar mund të përmendim:

- aplikimin e materialeve parandaluese në dhëmbë (silante dhe fluorizime),
- pastrimin e gurëzave dhe pllakës dentare,
- këshillimin/edukimin e pacientëve mbi higjienën orale dhe mënyrën e të ushqyerit,
- marrjen e masave për modelet e studimit,
- vlerësimin oral të pacientëve, anamnezën, ekzaminime të qafës dhe kokës, marrjen e shenjave vitale, kryerjen e radiografive.

Mundësi profesionale

Puna e higjienistit dentar është e lidhur ngushtë me atë të stomatologut. Ai kryen me rigorozitet të gjitha detyrat që janë përgjegjësi të tij dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së pacientit. Duke patur parasysh faktin se kariesi dhe sëmundjet periodontale mbeten në majën e sëmundjeve më të përhapura në botë, kjo kërkon dhe do të kërkojë nevojë të vazhdueshme dhe në rritje, për higjienistë dentarë, sidomos në vende si Shqipëria, ku ky profil mungon pothuajse tërësisht. Studentët e diplomuar në këtë program studimi do të kenë mundësi të punojnë si:



- profesionistë të lirë, pranë klinikave stomatologjike, private apo institucionale (universitare),
- pranë institucioneve publike në sektorë prodhues dhe promovues të pajisjeve dentare laboratorike,
- në qendrat kërkimore të profilit të higjienistit dentar.

Kurrikula e Programit të studimit Bachelor në “Higjienist Dentar”

VITI II		
NR	LËNDA	ECTS
1	GJUHË E HUAJ 4	
2	DIXHITALIZIMI I TE DHENAVE - MENAXHIM SHENDETESOR	7
3	ANATOMI-FIZIOLOGJI 1	7
4	FORMIM PARAKLINIK	21
5	PATOLOGJI OMF	6
6	RADIOLOGJI ORALE 5	
TOTAL		60



VITI II		
NR	LËNDA	ECTS
1	ANESTEZI ORALE - KIRURGJI ORALE	12
2	DENTISTRI OPERATIVE KLINIKE	6
3	BIOLOGJI ORALE 5	
4	HIGJIENE DENTARE KLINIKE 1	3
5	MIKROBIOLOGJI - KONTROLL INFEKSIONI	9
6	NUTRICION	5
7	SEMUNDJE INFEKTIVE/ EPIDEMIOLOGJI	4
8	HISTOLOGJI - EMBRIOLOGJI 6	
TOTAL		60

VITI III		
NR	LËNDA	ECTS
1	DENTISTRI PEDIATRIKE 7	
2	ETIKË/MJEKËSI LIGJORE 4	
3	FARMAKOLOGJI 4	
4	MJEKESI ORALE	4
5	PERIODONTOLOGJI	7
6	PRAKTIKE PROFESIONALE	21
7	TRAJTIM I PACIENTEVE E NEVOJA SPECIALE 4	
8	DIPLOME	9
TOTAL		60



Programi i studimit me karakter profesional “Laborant i Lartë Dentar”

Programi i studimit me karakter profesional “Laborant i Lartë Dentar” ka kohëzgjatje 2 vjeçare dhe një total prej 120 kreditesh. Forma e studimit është me kohë të plotë. Ky program studimi ofrohet për herë të parë në Albanian University dhe është në fazë licensimi nga MASR.

Objektivat dhe kompetencat që fitohen

Programi i studimit me karakter profesional “Laborant i Lartë Dentar” synon të pajisë studentët me dijet bazë në fushën e laborantit dentar. Qëllimi kryesor i këtij programi studimi është që aplikantët të zotërojnë njohuritë teoriko-praktike për t’u formuar profesionalisht dhe për t’u bërë në të ardhmen laborantë dentar me njohuri që ecin paralelisht me hapin e kohës.

Bazat praktike në lëndët profesionale që studentët do të përfitojnë, i shërbejnë komunikimit të mirë profesional mjek stomatolog-laborant dentar, për rezultate klinike të suksesshme në pacientë total apo parcial edentulozë, me implante apo me aparate ortodontike. Programi i studimit me kohëzgjatje 2 vjeçare i ofron studentit formimin bazë e karakterizues, me qëllim ndërthurjen e njohurive dhe parapërgatitjen

për të ndërmarrë përsipër modelimin e urave fikse, aparateve ortodontike, protezave totale, parciale të skeletuara, e madje edhe të suprastrukturave mbi implante.

Mundësi profesionale

Sektorët e mundshëm për punësim të studentit, bazuar në vlerësimin e tregut të punës kryer nga Departamenti i Stomatologjisë, janë të gjerë, kjo bazuar në kapacitetin profesional formues të këtij programi studimi me karakter profesional, kohëzgjatje 2 vjeçare. Studentët e diplomuar në këtë program studimi do të kenë mundësi të punojnë si:

- profesionistë të lirë, pranë klinikave stomatologjike, private apo institucionale (universitare),
- pranë institucioneve publike në sektorë prodhues dhe promovues të pajisjeve dentare laboratorike,
- në qendrat kërkimore të profilit të laborantit dentar.

**Kurrikula e Programit të studimit me karakter profesional “Laborant i Lartë Dentar”**

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	ANATOMI	6
2	FIZIOLOGJI 6	
3	MORFOLOGJI 6	
4	PAJISJE LABORATORI 6	
5	PROTEZA PARCIALE E THJESHTE	10
6	SHKENCA MATERIALE	6
7	URA FIKSE 1	10
TOTAL		60

VITI II		
NR	LËNDA	ECTS
1	IMPLANTOLOGJI - SUPRASTRUKTURAT MBI IMPLANTE 1	2
2	ORTODONTI KLINIKE - APARATET E LEVIZHME ORTODONTIKE	12
3	PROTEZA E LEVIZHME (PRAKTIKE) 4	
4	PROTEZA E SKELETUAR	10
5	URA FIKSE 2	8
6	DIPLOMA	14
TOTAL		60





DEPARTAMENTI I FARMACISË

Programi i Studimit Master i Shkencave në “Farmaci” (Program i Integruar i ciklit të dytë)

Programi i Studimit Master i Shkencave në “Farmaci” ka filluar në vitin akademik 2005-2006, me miratim të MASH, Nr. 5663 Prot, datë 01.09.2005 dhe riorganizuar me urdhër të MASH Nr. 226, datë 21.06.2009. Ky program ofrohet me kohë të plotë me një kohëzgjatje prej 5 vitesh akademike dhe 300 ECTS. Programi u akreditua me urdhër të Ministrit të MASH, Nr. 462, datë 14.10.2010. Në kuadër të procedurave për vazhdimin dhe rritjen e cilësisë, programi i studimit është riakredituar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë me Vendim Nr. 18, datë 02.03.2019.

Programi i Studimit Master i Shkencave në “Farmaci” u zhvillua për të mbështetur dhe përmbushur nevojat e tregut shqiptar me figura profesionale të afta për të drejtuar sektorin e Farmaceutikës dhe Sistemin Shëndetësor Shqiptar, në gjendje për t’u përballur me realitetin tonë dhe për ta përmirësuar atë, duke sjellë këtu eksperiencën më të mirë kombëtare.

Ky program studimi është hartuar për t’i ofruar

studentit një përgatitje ekselente, të aftë për të punuar në sektorin shëndetësor publik dhe privat, në institucione kombëtare që operojnë në tregun e prodhimit të barnave, në farmaci spitalore shtetërore dhe private; në industrinë farmaceutike duke përfshirë njohuri në përgatitjen e barnave, kontrollin, magazinimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e tyre; tregtimi në sasi të barnave; dhënia e informacionit dhe këshillave në sektorin e barnave, të produkteve kozmetike dhe bimore.

Departamenti i Farmacisë është i ndarë në grupe mësimore si më poshtë:

- Grupi mësimor i lëndëve të Teknologjisë Farmaceutike;
- Grupi mësimor i lëndëve të Kimisë Farmaceutike;
- Grupi mësimor i lëndëve të Farmakologjisë;
- Grupi mësimor i lëndëve të Kimisë;
- Grupi mësimor i lëndëve të Farmakognozisë;
- Grupi mësimor i lëndëve të Kërkimit Shkencor;
- Grupi mësimor i lëndëve të Shkencave Biomjekësore.





Nënkuptoheq që pranë çdq disipline dhe lënde aktivizohet numri i nevojshëm i pedagogëve, asistent pedagogëve.

Formimi 5 vjeçar shoqërohet me formim të mirë teoriko-praktik, duke i dhënë kështu specifike të admirueshme çdq studenti e njëkohësisht duke e bërë të aftë që të zotërojë dhe aplikojë në praktikën farmaceutike njohuritë e përfituara në auditoret tona.

Pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore janë ngritur laboratorët paraklinikë të anatomisë normale, kimisë inorganike dhe organike, histologjisë, fizikës, botanikës, kimisë farmaceutike, biologjisë, të cilat janë pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme laboratorike dhe audio-vizive, si për zhvillimin normal të praktikave laboratorike, ashtu dhe për kërkime shkencore.

Studentët e diplomuar në “Master i Shkencave në Farmaci” i kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme si dhe të drejtën, të ndjekin ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë”, duke zotëruar baza të qëndrueshme për një përballje të suksesshme të këtij programi.

Kurrikula e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Farmaci”

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	Fizikë dhe Biofizikë 8	
2	Kimi e Përgjithshme e Inorganike (M)	14
3	Informatikë	3
4	Gjuhë e Huaj	5
5	Gjuhë Latine	5
6	Statistikë Matematikë	6
7	Anatomi	9
8	Biologji 1	0
	TOTAL	60

VITI II		
NR	LËNDA	ECTS
1	Kimi Organike I+II (M) 1	4
2	Kimi Analitike I+II (M)	14
3	Fiziologji 1	0
4	Kimi Fizike e Koloidale	7
5	Mikrobiologji	5
6	Botanikë /Praktikë Botanike	10
	TOTAL	60



VITI III		
NR	LËNDA	ECTS
1	Kimi Farmaceutike I dhe Analizë Farmaceutike I (MI)	12
2	Metodat Fiziko-Kimike të Analizës	8
3	Farmakognozi e Analizë e Drogave 1	5
4	Teknologji Farmaceutike I e Përgatitje Galenike I (MI)	10
5	Bikimi 8	
6	Sëmundje të Brendshme	7
TOTAL		60

VITI IV		
NR	LËNDA	ECTS
1	Teknologji Farmaceutike II dhe III Përgatitje Galenike Kozmetike (MI)	13
2	Kimi Farmaceutike II dhe Analizë Farmaceutike II (MI)	11
3	Farmakologji 1	3
4	Kimi Toksikologjike	9
5	Fitoterapi 4	
6	Bikimik Klinike	5
7	Legjislacion Farmaceutike dhe Farmako-Ekonomi	5
TOTAL		60

VITI V		
NR	LËNDA	ECTS
1	Kimi e Teknologji e Ushqimeve / Analiza e Kontroll i Ushqimeve dhe Suplementeve (MI)	7
2	Metodat e Kërkimit / Kujdes Farmaceutik	4
3	Biofarmaci e Farmakokinetikë dhe Farmakologji Klinike (MI)	11
4	Etikë dhe Deontologji / Menaxhim Farmaceutik	3
5	Shëndet Mjedisor	4
6	Bazat e Praktikës Profesionale Mësimore	3
7	Praktikë Profesionale mësimore	16
8	Tezë Diplome 1	2
TOTAL		60

TOTAL 5 VITE =300 ECTS



DEPARTAMENTI I INFERMIERISË DHE FIZIOTERAPISË

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë është pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Albanian University.

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ofron programe studimi:

Bachelor në

- “Infermieri”
- “Fizioterapi”

Master Profesional në

- “Infermieri Kirurgjikale”
- “Terapi Manuale”
- “Infermieristika e Sëmundjeve Kronike dhe Gerodontologjia” *

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë është i ndarë në grupe mësimore si më poshtë:

- Grupi mësimor i lëndëve Vlerësuese dhe Rehabilituese;
- Grupi mësimor i lëndëve të Infermieristikës;
- Grupi mësimor i lëndëve të Infermieristikës Kirurgjikale;
- Grupi mësimor i lëndëve Mjekësore-Formuese;
- Grupi mësimor i lëndëve Urgjencë-Anestezi Reanimacion.

Programi i studimit Bachelor në “Infermieri”

Programi i studimit Bachelor në “Infermieri”, në Albanian University është hapur me Urdhër Nr. 411, datë 25.08.2011 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ky program është akredituar me Urdhër nr.239 datë 09.05.2016 të Ministrisë përgjegjëse dhe riakredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 31, datë 19.05.2017.





Objektiva

Programi i studimit Bachelor në "Infermieri" është një cikël 3-vjeçar studimesh, prej 180 ECTS. Kurrikula ka si objektiv të përgatisë studentë të cilët të kenë përvetësuar njohuritë bazë dhe të nevojshme për të zotëruar kapacitetet dhe aftësitë që duhet të ketë një infermier i përgjithshëm, të aftë për të punuar në çdo specialitet të fushës së mjekësisë, duke garantuar formimin e një infermieri të denjë në përkujdesjen e pacientëve. Diploma Bachelor në "Infermieri" përmban njohuritë akademike dhe praktike më bashkëkohore në fushën e Infermierisë. Studenti përgjatë tre viteve të studimeve zhvillon aktivitet praktik në laboratorët e anatomisë, fiziologjisë, fizikës, kimisë, dhe praktikë në Laboratorin e Infermierisë, duke rritur ndjeshëm cilësinë e të nxënit.

Kompetenca që fitohen

Kurrikula e programit të studimit bachelor në "Infermieri" ka të parashikuar Praktikë Profesionale jashtë auditorit, me një shtrirje të gjerë dhe të konsiderueshme, duke rritur ndjeshëm cilësinë dhe përputhshmërinë e kurrikulës me kurrikulat e programeve jashtë vendit në përputhje me standardet e universiteteve europiane. Këto kompetenca do t'i shërbejnë studentëve që të forcojnë më tepër sensin

praktik të punës. Studentët në fund të programit do të jenë të aftë të ndërmarrin studime të mëtejshme të avancuara në fusha të specializuara, të vlefshme për specifikën shqiptare dhe profesionistët e kësaj fushe në Shqipëri.

Njohuritë akademike që ofron ky program studimi synojnë të përgatisë infermierë të aftë për të punuar në sistemin shëndetësor shqiptar, në spitale shtetërore dhe private si dhe në qendra shëndetësore.

Mundësi Punësimi

Kjo kurrikulë ka si qëllim përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm të aftë për të punuar si brenda dhe jashtë vendit dhe duke ndihmuar dhe lehtësuar të diplomuarit për të aplikuar më tej në Master Shkencor apo Master Profesional për përshpejtimin e procedurave të aplikimit dhe të pranimit në universitete brenda edhe jashtë vendit. Gjithashtu synon të përgatisë jo vetëm infermierë të përgjithshëm por dhe pajisjen e tyre me njohuri specifike në disa fusha të veçanta të shkencave mjekësore, në mënyrë që ky program studimi të mos orientojë studentin vetëm në tregun e punës por dhe t'i krijojë bazat dhe njohuritë për specializime të mëtejshme.



Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në “Infermieri”

VITI I PARË		
Nr.	LËNDA	Kredite
1	Anatomia Makromikroskopike 1	4
2	Infomatikë dhe Gjuhë e Huaj	8
3	Statistikë Mjekësore dhe Epidemiologji	6
4	Kimi dhe Biologji 8	
5	Infermieristikë e Përgjithshme dhe Puerikulturë	10
7	Fiziologji 6	
8	Biokimi Mjekësore	4
9	Praktikë Profesionale 1	4
Total Viti I		60



VITI I DYTË		
1	Anatomi Patologjike, Fizologji Patologjike	12
2	Farmakologji dhe Imunologji	12
3	Mikrobiologji dhe Sëmundje Infektive	10
4	Kirurgji e Përgjithshme, Infermieristika Kirurgjikale	6
5	Anestezi Reaminacioni, Urgjencë, Infermieristika e Anestezi e Reaminacionit	8
6	Praktika Profesionale 2	6
7	Lëndë me zgjedhje	6
Total Viti II		60

VITI I TRETË		
1	Sëmundje të Brendshme, Infermieristika e Sëmundjeve të Brendshme, Geriartri	12
2	Obstetrike, Gjinekologji, Infermieristika e Obstetrikë Gjinekologjisë	11
3	Pediatri, Infermieristika e Peditrisë	8
4	Neurologji, Infermieristika në Neurologji, Psikiatri, Infermieristika në Psikiatri	7
5	ORL, Infermieristika ORL, Okulistikë, Infermieristika e Okulistikës	8
6	Praktika Profesionale 3	8
7	Provimi Përfundimtar/Temë Diplome	6
Total Viti III		60

TOTAL 3 VITE =180 ECTS



Programi i Studimit Bachelor në “Fizioterapi”

Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” është hapur me Urdhër Nr.199, datë 16.05.2012 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ky program është akredituar me Urdhër nr.238 datë 09.05.2016 të Ministrisë përgjegjëse dhe riakredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr.30, datë 19.05.2017.

Objektiva

Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” është një cikël 3-vjeçar studimesh, prej 180 ECTS. Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri profesionale në ushtrimin e profesionit të fizioterapistit, të cilët në përfundim të ciklit 3-vjeçar të studimeve do të jenë të aftë të aplikojnë metodikat profesionale për trajtimin, parandalimin dhe rehabilitimin në dëmtimet trupore, në funksionet më të larta kortikale dhe visherale, të ngjarjeve patologjike për shkaqe të ndryshme, të lindura ose të fituara. Gjithashtu synon të pajisë studentët me aftësi profesionale në lidhje me organizimin e punës në mënyrë individuale dhe në ekipe shumëdisiplinore, përcaktimin e programit të rehabilitimit me qëllim identifikimin dhe trajtimin e nevojave shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara të fituara ose të lindura.





Kompetenca që fitohen

Programi ka si qëllim të aftësojë fizioterapistë në aplikimin e praktikave dhe aktiviteteve autonome terapeutike për rehabilitimin e individëve me aftësi të kufizuara funksionale, psikomotorike dhe aftësitë njohëse duke përdorur terapi fizike, terapi manuale, terapi masazhi, fizioterapi instrumentale dhe punësimin. Kurrikula e programit të studimit në “Fizioterapi” ka të parashikuar praktikë profesionale jashtë auditorit, e cila zhvillohet në institucionet më prestigjioze në vend, shtetërore si dhe klinika private me të cilat Albanian University disponon marrëveshje bashkëpunimi.

Mundësi Punësimi

Qëllimi i kurrikulës është rritja e cilësisë për të ecur në të njëjtin hap me standardet e universiteteve europiane, duke garantuar përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm të aftë për të punuar si brenda dhe jashtë vendit dhe duke ndihmuar dhe lehtësuar të diplomuarit për të aplikuar më tej në Master Shkencor apo Master Profesional, për përshpejtimin e procedurave të aplikimit dhe të pranimit në universitete edhe jashtë vendit.

Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në “Fizioterapi”

VITI I PARË		
Nr.	LËNDA	Kredite
1	Anatomi Normale, Neuroanatomi	12
2	Fizikë, Biofizikë	6
3	Informatikë	3
4	Statistikë	3
5	Anglisht	4
6	Principet e Lëvizjeve, Vlerësimi Neurofizilogjik	12
7	Histologji	5
8	Fiziologji	5
9	Infermieristikë e Përgjithshme, Farmakologji	10
Total Viti I		60



VITI I DYTË		
Nr.	LËNDA	Kredite
1	Neurologji, Rehabilitim Neurologjik	12
2	Ortopedi, Rehabilitim Ortopedik 1	2
3	Imazheri, Urgjencë	7
4	Prostetikë, Rehabilitim Prostetik 1	2
5	Praktikë 2	11
6	Lëndë me zgjedhje	6
Total Viti II		60

VITI I TRETË		
Nr.	L ËNDA	Kredite
1	Masazh Mobilizim Manipulim, Fizioterapi Instrumentale	10
2	Rehabilitim Pediatrik	7
3	Shëndet Sportisti, Rehabilitim në Sport	6
4	Sëmundje të Brendshme, Rehabilitim Kardiopulmonar	12
5	Geriartri dhe Rehabilitim Geriatrik, Rehabilitim Fizik	12
6	Praktika 3	7
7	Provimi Përfundimtar	6
Total Viti III		60

TOTAL 3 VITE =180 ECTS



Programi i Studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”

Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” në Albanian University, wshtw hapur me Urdhër Nr. 479, datë 10.10.2012 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ky program është akredituar me Urdhër nr.242 datë 09.05.2016 të Ministrisë përgjegjëse dhe riakredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 32/2, datë 02.02.2018.

Objektiva

Kurrikula e këtij program studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 2 semestra dhe me një numër në total 60 Kredite. Programi i studimit

Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale ka për qëllim të përgatisë dhe të formojë një figurë specialisti në Infermieri Kirurgjikale dhe në sallën operatore, një profesionist të aftë që të sigurojë mbarëvajtjen e proceseve dhe ecurinë e asistencës në fushën e Kirurgjisë së Përgjithshme dhe Speciale për të rritur dhe për fëmijë.

Në këtë program kanë mundësi të studiojnë infermierë të cilët kanë kryer arsim tre vjeçar (cikli i parë Bachelor) në degën e Infermierisë së Përgjithshme dhe kërkojnë të thellojnë me tej njohuritë e tyre në një specialitet më të ngushtë të Shkencave Infermieristike, në rastin konkret në Infermieristikën Kirurgjikale.

Kompetenca që fitohen

Programi i lëndëve në semestrin e parë të studimit është ideuar që të mundësojë pajisjen e studentëve me kompetenca dhe njohuri më të thelluara në nivelin teorik dhe praktik në lëndë të Shkencave Infermieristike si: Infermieristika e Përgjithshme dhe Klinike, Infermieristika në Kirurgjinë Infantile, Infermieristika në Sallën Operatore. Krahas këtyre lëndëve, studentët kanë mundësinë të përvetësojnë njohuri specifike që lidhen me specialitetin e kirurgjisë si: Infermieristika në Kirurgjinë Obstetrikë-



Gjinekologjike, Infermieristika në Kirurgjinë Abdominal Urologjike, Infermieristika në Kirurgjinë Torakale dhe Kardiovaskulare, Infermieristika në Kirurgjinë Ortopedike-Traumatologjike, etj. Në semestrin e dytë studenti do të marrë njohuri në lëndë ndërdisiplinore integruese siç janë Psikologji e Përgjithshme, Sociologji. Gjatë të dy semestrave janë planifikuar orë praktike në mënyrë që studentët të ushtrojnë praktikë profesionale e cila do të plotësojë formimin profesional të infermierit të specializuar në kirurgji.

Mundësi Punësimi

Qëllimi i kurrikulës së Masterit Profesional është të përgatisë infermierë të aftë dhe të profilizuar në sektorin kirurgjikal, duke përfshirë të gjitha specialitetet, duke i dhënë mundësi punësimi në spitale shtetërore dhe private brenda dhe jashtë vendit. Ky program studimi mbështetet në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane. Ai është ndërkombëtarisht konkurrenues për nga elementet që përmban (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit), duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri.

Kurrikula e Programit të Studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”

VITI I PARË		
Nr.	LËNDA	Kredite
1	Statistikë dhe Promocion Shëndetësor	6
2	Asistencë Infermieristike në sallë	4
3	Infermieristika në Kirurgjinë e Avancuar I	9
4	Infermieristika në Kirurgjinë e Avancuar II	11
5	Infermieristika në Ekzaminimet Endoskopike	2
6	Anestezi-Reanimacion dhe Kujdesi Infermior	6
7	Lëndë me zgjedhje (zgjidhen 2 nga modulet e mëposhtme)	6
8	Praktikë Profesionale	6
9	Provimi Përfundimtar formimi / Punim Diplome	10
Total për të gjithë programin		60

TOTAL 1 VIT = 60 ECTS



Programi i Studimit Master Profesional në “Terapi Manuale”

Programi i Studimit Master Profesional në “Terapi Manuale” është hapur me Urdhër Nr. 671, datë 12.10.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ky program është akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr.59, datë 05.07.2019.

Objektiva

Kurrikula e këtij program studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 2 semestra dhe me një numër në total 60 Kredite. Ky program studimi ofrohet në përputhje me misionin, qëllimet e Institucionit dhe strategjinë për zhvillim të Institucionit. Ai është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit, pa rënë ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare.

Ky program studimi shmang përsëritjen e njohurive formuese të programeve të studimit të ciklit të parë, pasi ofron disiplina të karakterit profilizues profesional, të cilat karakterizohen nga specialiteti sektorial, si dhe nga niveli më i lartë i kompleksitetit teknik me qëllim formimin teorik në nivelin më të avancuar në fushën përkatëse të studimit.

Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij dhe mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike për arsye të karakterit të mirëfilltë profesional të tij dhe njohurive nga fusha e Terapi Manuale, duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin e mëtijshëm të studentëve për punësim duke ndjekur njëkohësisht edhe politika favorizuese për punësimin e të diplomuarve.

Ai ofrohet në lëndë të veçanta dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky Program studimi mbështetet në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane. Ai është ndërkombëtarisht konkurrues për nga elementet që përmban duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri.

Kompetenca që Fitohen

Programi i studimit Master Profesional në “Terapi Manuale” është një ndërthurje teoriko-praktike në të cilën baza e trajnimit është në përputhje me standardet evropiane. Në mënyrë të veçantë masteri ka për qëllim të nxisë një kulturë terapeutike të integruar në kuadër të terapisë manuale, bazuar



në parimet; vizion biopsikosocial i problemit të pacientit, një metodologji klinike e mësimdhënies që kombinon prova kërkimore dhe dëshmi empirike, një metodologji kërkimore e artikuluar në funksion të problemeve të ndryshme dhe bazave epistemologjike të referencave bibliografike, një krahasim pozitiv me shkollat e ndryshme dhe traditat e terapisë manuale. Edhe pse Masteri Profesional në “Terapi Manuale” është në funksion të profesionistëve të rehabilitimit fizik ai ofron gjithashtu mbështetje dhe avancim në dijet profesionale dhe kërkimore; zgjeron fushën e aplikimeve profesionale.

Fizioterapisti që përfundon me sukses studimet e Masterit Profesional në “Terapi Manuale”: do të zotërojë një standard të lartë të aftësive manuale në ekzekutimin e manovrave dhe vlerësimit funksional dhe terapeutik, do të jetë në gjendje të zgjedhë një teknike adapte nga variacionet terapeutike si rezultat i një procesi të integritimit të personelit klinik me provat më të mira shkencore në dispozicion, bazuar në parimet e mjekësisë, bazuar në dëshmi, procedurat më të përshtatshme të vlerësimit terapeutike për pacientë të veçantë, do të jetë në gjendje të ndërhyjë në riaftësimin e pacientit që vuan nga çrregullime muskuloskeletike, do të formulojë një plan-trajtimi të bazuar në prognozën e pacientit, të përgatitur në bazë të Klasifikimit Ndërkombëtar për Funksionimin e tij (ICF).

Mundësi Punësimi

Fizioterapisti i cili ndjek programin e studimit Master Profesional në “Terapi Manuale” do të jetë profesionist me titull i kësaj fushe, pjesë e qendrave të rehabilitimit, si publike dhe private për aftësitë e zhvilluara në menaxhimin e pacientëve me çrregullime muskuloskeletike si në: reumatologji, ortopedi dhe neurologji. Kjo degë e rehabilitimit është në fazën e rritjes së fuqishme profesionale dhe është projektuar për terapistët fizikë të cilët kanë zhvilluar një nivel shkencor dhe profesional më të lartë se ai i parashikuar në kurset profesionale të fizioterapisë. Meqënëse masteri hapet për herë të parë në territorin shqiptar, nevojat e tregut ofrojnë punësim të menjëhershëm për profesionistët e parë në “Terapi Manuale”.

Sektorët e mundshëm të punësimit

- Sistemin shëndetësor ambulatorial
- Sistemin shëndetësor privat
- Qendrat shëndetësore të Rehabilitimit
- Institucionet Shëndetësore publike (QSUT, Spitali i Traumës etj)
- Organizata jo-fitimprurëse
- Fondacione



Kurrikula e Programit të studimit Master Profesional në “Terapi Manuale”

VITI I		
NR.	LËNDA	ECTS
1	Anatomia Topografike dhe Funktionale	4
2	Biomekanika e aplikuar	3
3	Kineziologjia	3
4	Neurologjia	3
5	Neurofiziologjia	3
6	Teoria e Terapisë Manuale	4
7	Metodologjia e Terapisë Manuale	5
8	Praktika Profesionale	6
9	Ortopedia	5
10	Traumatologjia sportive	5
11	Reumatologjia	3
12	Rehabilitimi në Terapinë Manuale 1	5
13	Rehabilitim në Terapinë Manuale 2	5
14	Provimi Përfundimtar	6
TOTAL		60

1 Vit= 60 ETCS



Master Profesional në “Infermieristika e Sëmundjeve Kronike dhe Gerodontologjia”

Duke nisur nga viti akademik 2019-2020, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, synon të aktivizojë programin e ri të studimit Master Profesional “Infermieristika e Sëmundjeve Kronike dhe Gerodontologjia”, në pritje të Urdhërit për hapje të programit të studimit nga Ministria Përgjegjëse.

Programi i studimit Master Profesional në “Infermieristika e Sëmundjeve Kronike dhe Gerodontologjia”, është program studimi i ciklit të dytë, me kohëzgjatje normale 1 vjeçare, të cilave u përkojnë 60 kredite. Forma e studimit është me kohë të plotë.

Veprimtaritë mësimore zhvillohen nëpërmjet leksioneve në auditor, seminareve, dhe praktikës. Praktikrat do të zhvillohen në spitale, qendra shëndetësore dhe rehabilitimi, me të cilat Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi.

Objektivat e Programit Mësimor

Programi i studimit Master Profesional në “Infermieristika e Sëmundjeve Kronike dhe Gerodontologjia” ofrohet në përputhje me misionin,

qëllimet e Institucionit dhe strategjinë për zhvillim të Institucionit. Ai është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit. Ky program studimi mbështetet në përvojën disavjeçare dhe praktikrat e mira të vendeve europiane dhe ka si qëllim formimin e studentëve, në fushën e Infermieristikës së Sëmundjeve Kronike dhe Gerodontologji.

Masteri profesional në “Infermieristika e Sëmundjeve Kronike dhe Gerodontologjia” është një ndërthurje teoriko-praktike në të cilën baza e trajnimit është në përputhje me standardet evropiane. Në mënyrë të veçantë ky master ka për qëllim të nxisë një kulturë të një cilësie të lartë të infermierisë të sëmundjeve kronike të integruar me Geriartrinë dhe çdo aspekt lidhur me moshën e tretë duke filluar me aspektet psikologjike e neuro-psikiatrike të trajtimit të pacientit, njohja dhe trajtimi i sëmundjeve kryesore kronike që prekin kryesisht moshën e tretë, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë dhe shërbimit ambulator në Geriartri si një risi në sistemin tonë shëndetësor. Masteri Profesional “Infermieristika e Sëmundjeve Kronike dhe Gerodontologjia” është në funksion të profesionistëve infermier në fushën e sëmundjeve kronike dhe të geriartrisë duke ofruar mbështetje dhe avancim në dijet profesionale dhe kërkimore si dhe zgjeron fushën e aplikimeve profesionale.



Kompetencat që fitohen

Infermieri i cili do të përfundojë studimet në këtë master profesional, do të zotërojë një standard të lartë të aftësive, në trajtimin e pacientëve të moshës së tretë, me një vëmendje të vecantë tek sëmundjet kronike duke u bazuar në procedurat më të përshtatshme të vlerësimit për secilin pacientë, do të jetë i aftë në riaftësimin e pacientit që vuan nga patologji të ndryshme. Nisur nga kërkesat e shumta për këtë kategori Infermierësh si brenda ashtu dhe jashtë vendit, duke mundësuar punësim të menjëhershëm, ky program studimi është një zgjedhje shumë e mirë studimi për kandidatët student.

Mundësitë për punësim

Infermieri i cili ndjek Masterin Profesional “Infermieristika e Sëmundjeve Kronike dhe Gerodontologjia” do të jetë profesionist me titull i kësaj fushe, pjesë e qendrave të rehabilitimit të specializuara për moshën e tretë, si publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare, për aftësitë e zhvilluara në trajtimin e pacientëve të moshës së tretë. Ky program studimi është në kuadër të rritjes profesionale, kërkesës së tregut të punës jo vetëm vendas por edhe të huaj dhe është projektuar për Infermierë të një niveli profesional më të lartë se ai i parashikuar në kurset profesionale të Infermierisë.

Meqënëse Masteri Profesional hapet për herë të parë në territorin shqiptar, nevojat e tregut ofrojnë punësim të menjëhershëm për profesionistët e parë në “Infermieristika e Sëmundjeve Kronike dhe Gerodontologjia”

Sektorët e mundshëm të punësimit

- Sistemin shëndetësor ambulatorial
- Sistemin shëndetësor privat
- Qendrat shëndetësore të Rehabilitimit për moshën e tretë
- Shtëpi Kujdesi për moshën e tretë, shtetërore/ private
- Institucionet Shëndetësore publike (QSUT, Spitali i Traumës, etj)
- Organizata jo-fitimprurëse
- Fondacione



**Kurrikula e Programit të studimit Master Profesional në
“Infermieristika e Sëmundjeve Kronike dhe Gerodontologjia”**

VITI I		
NR	LENDË	ECTS
1	Fiziopatologji	3
2	Farmakologji Klinike	3
3	Infermieristika në Kirurgjinë e Përgjithëshme Geriartrike dhe Ortogeriartri	5
4	Neuro-Psikiatri	6
5	Infermieristika në shërbimin paliativ	4
6	Geriartri dhe Infermieristika në Geriartri	7
7	Infermieristika në Kardiologji	2
8	Shërbimi Ambulator në Geriartri	4
9	Infermieristika në Terapinë Okupacionale	3
10	Sëmundje të Brëndshme dhe Infermieristika në Speciali tete.	9
11	Menaxhim Shëndetësor	2
12	Praktika Profesionale	6
13	Provim Përfundimtar	6
	Total Viti I	60

TOTAL 1 VIT = 60 ECTS





FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA DHE EKONOMIKE

Ky fakultet është njësi kryesore e Albanian University dhe zhvillon procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në fushat e arkitekturës, inxhinierive dhe shkencave ekonomike. Ai përbëhet nga Departamenti i Arkitekturës, Departamenti i Inxhinierive dhe Departamenti i Shkencave Ekonomike.

DEPARTAMENTI I ARKITEKTURËS

Departamenti i Arkitekturës është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Ky departament e ka filluar aktivitetin me programin e studimit Master i Shkencave në “Arkitekturë” në vitin akademik 2005-2006, ndërsa në vitin akademik 2011-2012 është hapur për herë të parë programi i studimit Bachelor në “Dizajn”. Departamenti i Arkitekturës ka si detyrë parësore të përgatisë specialistë të profilit përkatës me njohuri bashkëkohore, të aftë t’i përgjigjen tregut të punës.

Departamenti i Arkitekturës ofron këto programe studimi:

Bachelor në:

- “Dizajn”;

Master Profesional në:

- “Interior Dizajn”



Programi i Studimit Bachelor në “Dizajn”

Programi i studimit Bachelor në “Dizajn” është hapur në vitin akademik 2011-2012 me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 199, datë 16.05.2012, dhe akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 74, datë 21.09.2017.

Ky program zhvillohet pranë Departamentit të Arkitekturës, me mbështetjen e një stafi akademik të kualifikuar brenda dhe jashtë vendit, artist - dizajner me një karrierë shumë aktive, si në mësimdhënie ashtu edhe në krijimtari artistike.

Diploma Bachelor në “Dizajn” i ofron studentit njohuri akademike dhe praktike bashkëkohore, të cilat do të shërbejnë në sensin praktik dhe krijues të studentit. Studenti në përfundim të programit 3 vjeçar, do të jetë i aftë për të vazhduar dhe avancuar njohuritë dhe për ti profilizuar në drejtimet përkatëse të dizajnit siç janë: Dizajni Grafik, Multimedia, Web dizajn, Dizajn Interieri etj.

Studentët të cilët përfundojnë studimet në programin e studimit Bachelor në “Dizajn” janë të përgatitur të punojnë në: studio dizajni grafik, redaksi të gazetave ditore ose javore, studio televizive në 3D efekte animacion, studio fotografike, studio projektimi si interier dizajner, shtypshkronja, shtëpi botuese, në shkolla 9 vjeçare (mësues i lëndës së artit figurativ), individualisht në sektor privat (art studio), web dizajn, në galeri arti etj.

Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në “Dizajn”

VITI I		
NR.	LËNDA	ECTS
1	Vizatim i Detajuar dhe Bashkekohor 1	6
2	Histori Arti I	10
3	Gjuhë Angleze	8
4	Kaligrafi	8
5	Gjuhë Shqipe dhe Shkrim Akademik	5
6	Anatomi Artistike (Lëndë Me Zgjedhje)	7
	Grafikë (Lëndë Me Zgjedhje)	
7	Art 2d/1	6
TOTAL VITI I		60



Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn”

Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” është hapur me Urdhër Nr. 669, datë 12.10.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ky program është akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 55, datë 05.07.2019.

Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” synon krijimin e specialistit “Interier Dizajner” nëpërmjet përgatitjes teoriko-praktike gjatë periudhës 1-vjeçare, duke mundësuar hyrjen e menjëhershme në tregun e punës si dizenjues i hapësirave të brendshme. I drejtohet studentëve, të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të parë/të dytë në Dizajn, Arkitekturë apo në fusha të tjera të ngjashme, të cilët kërkojnë të thellojnë dhe pasurojnë njohuritë e tyre në sektorin e dizenjimit të interierit.

Në këtë program studimi kombinohet teoria dhe praktika, kreativiteti dhe llogjika, arti dhe teknologjia duke zhvilluar tek studenti aftësitë krijuese dhe analizuese. Gjithashtu, studenti formohet me aftësi prezantuese të projektit në mënyrë që të shprehë sa më mirë vetveten.

Nëpërmjet praktikës profesionale, detyrave të kursit dhe projekteve, studentët njihen me problematikat aktuale të interierit dhe fitojnë kompetencë në teknikat e zgjidhjes së problematikave, të cilat do t’i ndihmojnë ata të konkurrojnë me sukses në tregun e punës. Në përfundim të studimeve 1-vjeçare, figura e specialistit “Interier Dizajner” do të jetë në gjendje t’u jap zgjidhje funksionale dhe estetike ambienteve të brendshme, me funksione të ndryshme, nëpërmjet përdorimit të mobiljeve, ngjyrave, dritës dhe materialeve sipas nevojave të interierit duke përmirësuar mënyrën e jetesës.

Pas përfundimit të studimeve të ciklit të dytë Master Profesional në “Interier Dizajn”, të gjithë studentët e diplomuar hyjnë në botën profesionale si specialist “Interier Dizajner” të pavarur ose mund të punësohen pranë studiove të arkitekturës/dizajnit ku do të përfshihen në projektimin ose rinovimin e hapësirave të brendshme, duke përfshirë ndryshimet funksionale, orëditë, instalimet, pajisjet, ndriçimin dhe skemat e ngjyrave, si edhe në sektorët kreativ të kompanive të ndryshme, shoëroom-eve, por edhe si interier dizajner në organizime të eventeve të ndryshme.

VIZATIMI NË ART, ËSHTË SI FILOZOFIA NË SHKENCË
NË ARKITEKTURË, SI SHKENCA DHE ARTI
9	Sistemet e Informacionit në Menaxhim	3
10	Lëndë me zgjedhje (1 nga 2)	6
A	E Drejtë Tregtare	
B	Vlerësimi i Politikave Publike	
11	Praktika	6
12	Diploma	6
TOTALI		60

1 VIT – 60 ECTS



Programi i Studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Bankar”

Programi i Studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Bankar”, licencuar me VKM Nr. 56, datë 21.01.2009, akredituar me Urdhër Nr. 327, datë 07.08.2012 të Ministrisë Përgjegjëse dhe riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 81, datë 27.10.2018. Ky program ka si qëllim të zhvillojë shprehitë dhe njohuritë e studentëve në nivelin e duhur që kërkon sot tregu bankar dhe ai financiar.

Kohëzgjatja normale e programit është 2 (dy) vite

akademike gjatë të cilëve realizohen 120 kredite ECTS.

Ky program është hartuar për t’iu përgjigjur nevojave në rritje të tregut bankar për profesionistë të aftë, sidomos në nivel menaxherial, i cili synon të pajisë studentët me parimet, njohuritë akademike, metodologjitë dhe shprehitë e nevojshme për të zhvilluar me sukses karrierën e tyre si menaxherë apo konsulentë në tregun bankar apo në sektorë të tjerë që lidhen ngushtë me të.

Ky program studimi ka në bazë kërkimin shkencor dhe krijon baza të qëndrueshme njohurish për të vazhduar më pas me studimet e ciklit të tretë – Doktoratës.

Zhvillimi i aftësive për arsyttime logjike me bazë teorike dhe empirike, kompetenca argumentuese dhe këshilluese për institucionet financiare, sistemin bankar, organizatat joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të gjithë aktorët e interesuar në këto fusha përbën një tjetër element të rëndësishëm në formimin profesional të studentëve të këtij cikli.

Mundësitë për punësim të tyre janë: Bankat e nivelit të dytë, Bankat e Investimeve, Institucione shtetërore puna e të cilave lidhet drejtpërdrejt me sektorin bankar, Kompanitë e sigurimeve, Institucionet e Mikrokredisë, Kompani Auditimi apo Konsulence, si edhe pranë Departamenteve të Analizës së Riskut të Korporatave.



Kurrikula e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Bankar”

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	Mbikëqyrje Bankare dhe Financiare	6
2	Financat e Korporatave	6
3	Menaxhim Risku i Avancuar	6
4	Ekonometri	6
5	Drejtim Financiar Ndërkombëtar	6
6	Sjellja Organizative dhe Etika e Biznesit	8
7	Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit	6
8	Kontabilitet i Avancuar	8
9	Menaxhimi Strategjik	8
TOTALI		60

VITI II		
NR	LËNDA	ECTS
10	Auditim i Institucioneve Financiare	6
11	Teoria dhe Drejtimi i Portofolit	6
12	Lëndë me zgjedhje (1 nga 2): Qeverisje e Korporatave / Metoda Sasiore për Financën	6
13	Menaxhimi Fiskal	6
14	Lëndë me Zgjedhje (1 nga 2): E Drejta Financiare / Menaxhimi i Tregut të Sigurimeve	6
15	Praktika	12
16	Diploma	18
TOTALI		60

2 VITE – 120 ECTS



Programi i Studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”

Programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”, licencuar me VKM Nr. 56, datë 21.01.2009, akredituar me Urdhër Nr. 327, datë 07.08.2012 të Ministrisë Përgjegjëse dhe riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 80, datë 27.10.2018. Ky program synon të pajisë studentët me parimet, njohuritë akademike, metodologjitë dhe shprehitë e nevojshme, për t’iu përgjigjur sa më mirë nevojave të tregut dhe për të kryer me sukses funksione manaxheriale dhe të niveleve strategjike në mjediset e ndryshme ku ata punojnë.

Kohëzgjatja normale e programit është 2 (dy) vite akademike gjatë të cilëve realizohen 120 kredite ECTS.

Kryerja e studimeve Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” është një kualifikim i kërkuar në rang ndërkombëtar, për nivelin e lartë menaxherial apo ekzekutiv, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Me ndryshimin e vazhdueshëm të ekonomisë dhe tregjeve në të cilat kompanitë veprojnë, rëndësia e një strategjie të suksesshme dhe të qënurit konkurrues në treg, bëhet gjithnjë e më e nevojshme. Ndaj, organizatat kërkojnë menaxherë të cilët të jenë të aftë të kontribuojnë në këtë proces.

Synimi themelor i këtij programi në kuadrin e formimit shkencor është strukturimi i një qasjeje të thelluar analitike nëpërmjet njohurive të ofruara dhe pajisjes të të diplomuarve të ciklit të dytë me instrumentet e nevojshëm shkencor në analizën e hollësishme të sistemit ekonomik në tërësi, politikave ekonomike, administrimit të biznesit, zhvillimit të institucioneve dhe komponentëve të qeverisjes, të projektuara në dinamikën e zhvillimit të tyre ekonomik dhe bashkëkohor.

Njohuritë dhe ekspertiza e përfutur gjatë këtyre dy viteve të studimit do të finalizohet me krijimin e një grupi të diplomuarish të aftë për të punuar si menaxher, këshillues biznesi, ekonomistë pranë kompanive vendase dhe të huaja, apo qendrave të ndryshme kërkimore, konsulentë apo ekspertë të treguesve ekonomik pranë organizmave të ndryshëm qeveritare dhe joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare.



Kurrikula e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	Metoda Kërkimi dhe Ekonometri	6
2	Menaxhimi Strategjik i Burimeve Njerëzore	6
3	Menaxhim Marketingu dhe Biznes Ndërkombëtar	6
4	Sjella Organizative dhe Etika e Biznesit	6
5	Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit	6
6	Kontabilitet Menaxherial	8
7	Menaxhim Risku i Avancuar	8
8	Financat e Korporatave	7
9	Lëndë me Zgjedhje (1 nga 2): Menaxhim Projekti i Avancuar/ E Drejtë Tregtare	7
TOTAL		60

VITI II		
NR	LËNDA	ECTS
10	Menaxhimi Strategjik	6
11	Menaxhim i Avancuar i Prodhimit dhe Operacioneve	7
12	Sipërmarrja e Biznesit të Vogël	6
13	Qeverisje e Korporatave	6
14	Lëndë me Zgjedhje (1 nga 2): Tregjet dhe Institucionet Financiare / Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin	5
15	Praktika	12
16	Diploma	18
TOTAL		60

2 VITE – 120 ECTS



**Programi i studimit Master
Profesional në
“Ndërmjetës Financiarë me Profil në
1. Letra me Vlerë,
2. Sigurime,
3. Pasuri të Paluajtshme”**

Programi i studimit Master Profesional në “Ndërmjetës Financiarë” me Profile në 1. Letra me Vlerë, 2. Sigurime, 3. Pasuri të Paluajtshme” ofrohet për herë të parë në Albanian University dhe është në fazë licensimi nga MASR. Ky program studimi i ciklit të dytë është me kohëzgjatje normale 1 (një) vit akademik, gjatë të cilit realizohen 60 kredite.

Programi i studimit Master Profesional në “Ndërmjetës Financiarë” është në fazë licensimi nga MASR.

Objektivat dhe kompetencat që fitohen

Programi i studimit Master Profesional në

“Ndërmjetës Financiarë” synon që të edukojë individë të aftë për t’ju bashkuar jetës profesionale në vend; të përgatisë ekspertë në fushat e ndërmjetësimit financiar, analizave financiare, tregjeve të letrave me vlerë, sigurimeve dhe titujve të pronësisë.

Programi përgatit dhe krijon mundësi të zhvillimit të aftësive si: blerjen dhe shitjen e letrave me vlerë në bursë; këshillimin financiarë për diversifikimin e portofolit të investimeve; analizën financiare; ndërmjetësimin në sigurime; ndërmjetësimin në titujt e pronësisë etj.

Studentët do të jenë të aftë të aplikojnë në praktikë njohuritë për portofolin e biznesit, mënyrën e tregtimit të letrave me vlerë, ndërtimin e kontratave të sigurimeve, përgatitjen e titujve të pronësisë për tregun, marketimin e titujve financiarë dhe do të bëhen profesionistë të spikatur të profilit të zgjedhur.

Mundësi Punësimi

Studentët që përfundojnë studimet në programin Master Profesional në “Ndërmjetës Financiarë” me Profil në 1. Letra me Vlerë, 2. Sigurime, 3. Pasuri të Paluajtshme mund të punojnë si: tregtarë të letrave me vlerë, këshilltarë financiarë personalë, analistë financiarë, menaxherë financiarë, bankierë investimesh, ndërmjetës në sigurime dhe agjentë të pasurive të paluajtshme.



Kurrikula e programit të studimit Master Profesional në “Ndërmjetës Financiarë me Profil në 1. Letra me Vlerë, 2. Sigurime, 3. Pasuri të Paluajtshme”

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	Tregjet dhe Institucionet Financiare	6
2	Metoda Kërkimi të Avancuara & Ekonometri	3
3	Kontabiliteti dhe Auditimi i Institucioneve Financiare	5
4	Menaxhimi i Riskut Financiar	5
5	Marketingu Sipërmarrës në Institucionet Financiare	6
6	Strategji dhe Vendimarrje Financiare	5
7	Sistemet e Informacionit në Institucionet Financiare	3
8	E Drejtë Financiare	3
9	Lëndë me zgjedhje Grupi I (1 nga 2)	6
A	Profili "Letra me Vlerë": Drejtim Portofoli ose Etika në Institucionet Financiare	
B	Profili "Sigurime": Tregu i Sigurimeve ose Komunikimi në Biznes	
C	Profili "Pasuri të Paluajtshme": Metodatat e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme ose Politika Publike	
10	Lëndë me zgjedhje Grupi II (1 nga 2)	6
A	Profili "Letra me Vlerë": Tregjet Ndërkombëtare ose Matematika Financiare	
B	Profili "Sigurime": Matematika Financiare ose Bazat e Aktuaristikës	
C	Profili "Pasuri të Paluajtshme": Teknologjia e Materialeve ose Sjellje Organizative	
11	Praktika	6
12	Diploma	6
TOTALI		60

1 VIT – 60 ECTS

ALBANIAN UNIVERSITY





FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

Ky fakultet është njësi kryesore e Albanian University dhe zhvillon procesin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor në fusha të lidhura me profilet shoqërore të njohura dhe licencuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Fakulteti përbëhet nga Departamenti i Shkencave Juridike, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE JURIDIKE

Departamenti i Shkencave Juridike është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe funksionon si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe punës kërkimore - shkencore, duke përfshirë fusha kërkimi homogjene dhe duke grupuar disiplinat mësimore respektive.

Departamenti i Shkencave Juridike, ndjek misionin dhe objektivat kryesorë të Arsimit të Lartë me qëllim: krijimin, transmetimin dhe mbrojtjen e dijeve me anë të mësimdhënies e kërkimit shkencor; formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkencëtarëve të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të shoqërisë, si dhe kontribuon në rritjen e standardeve të demokracisë në shoqëri. Ai organizohet dhe funksionon në përputhje me Legjislacionin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Statutin dhe Rregulloret e institucionit.



Programi i Studimit Bachelor në “Shkenca Juridike”:

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Juridike” është licencuar me Miratim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 8981, datë 27.12.2005. Ky program studimi, fillimisht është akredituar si sistem 4 vjeçar në Urdhrin e Ministrit Nr. 541, datë 01.12.2010, dhe është riorganizuar nga një program 4 vjeçar studimi në një program 3 vjeçar me Urdhrin Nr. 295, datë 11.09.2009. Në vitin akademik 2017- 2018, ky program u riakreditua me Vendimin Nr. 87/1, datë 20.10.2017 për një ndryshim në VBA Nr. 87, datë 21.09.2017 “Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Shkenca Juridike”, të Universitetit privat “Albanian University”.

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Juridike” ofron formim bazë të përgjithshëm në shkencat juridike. Studentët që do të ndjekin këtë program parashikohet t'i realizojnë këto veprimtari gjatë tre viteve akademike kundrejt një sasive prej 180 kredite ECTS.

Studentët e Departamentit të Shkencave Juridike, zhvillojnë praktikën profesionale në vitin e tretë në programin Bachelor, çka i ndihmon ata të kuptojnë zbatimin praktik të teorisë së përvetësuar në auditor

gjatë programit akademik tre vjeçar, duke bërë të mundur aftësimin praktik të studentit në hartimin e akteve të ndryshme civile e penale, pjesë të një dosjeje gjyqësore. Qëllimi i praktikës është zhvillimi i aftësisë së kuptimit të një çështje gjyqësore, familjarizimi i tyre me “aktorët” e një procesi gjyqësor, dhe mundësia për të mbrojtur çështje gjyqësore civile dhe penale.

Ky program studimi përgatit juristë, të aftë për të punuar:

1. Në shoqëri tregtare private;
2. Në ente publike;
3. Në njësi të ndryshme administrative;
4. Në dhoma, sekretare administrative;
5. Agjentë të sigurimeve;
6. Specialistë të Shërbimeve publike dhe bankare;
7. Nëpunës të policisë së shtetit;
8. Në qendra biznesi apo organizata të ndryshme.



**Kurrikula e Programit të Studimit
Bachelor në “Shkenca Juridike”:**

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	Histori e Institucioneve	6
2	E drejtë Civile(pj. përgjithshme I)	7
3	Gjuhë e Huaj - lëndë vjetore	6
4	E Drejtë Publike (modul i lëndës e drejtë kushtetuese dhe e drejtë publike) - 12 ECTS	6
5	E Drejtë Romake	9
6	E Drejtë Civile(pj. përgjithshme II)	8
7	Hyrje në Ekonomi	6
8	E Drejtë Kushtetuese (modul i lëndës e drejtë kushtetuese dhe e drejtë publike)	6
9	Dy lëndë me zgjedhje prej: - Shkrim Akademik - Teknike Legjislative - Psikologji Gjyqësore - Logjike Formale - Psikologji Sociale - Barazia Gjinore dhe Ligji	3
TOTAL		60



VITI II		
NR	LËNDA	ECTS
1	E Drejtë Penale 9	
2	E Drejtë e Punës dhe e Sigurimeve 9	
3	Filozofi e së Drejtës 6	
4	Anglishte Juridike	3
5	E Drejtë Familjare 9	
6	E Drejtë Administrative	9
7	E Drejtë e Detyrimeve	12
8	Informatikë Juridike	3
TOTAL		60

VITI III		
NR	LËNDA	ECTS
1	Procedurë Civile	9
2	E Drejtë Ndërkombëtare Publike (modul i lëndës e drejtë ndërkombëtare publike dhe e drejtë ndërkombëtare private)	6
3	E drejtë e Bashkimit European 6	
4	Dy lëndë me zgjedhje prej: <ul style="list-style-type: none"> - E Drejtë e Prokurimeve - E Drejtë Bankare - Të Drejtat e Njeriut - E Drejtë Deti - E Drejtë Ndërmjetësimi dhe Arbitrazhi - E Drejtë e Autorit - Profesionet e Lira - E Drejtë Migrimi - Kriminalistikë - Mjekësi Ligjore - Kriminologji - Penologji 	3
5	Procedurë Penale 9	
6 E	Drejtë Tregtare 9	
7	E Drejtë Ndërkombëtare Private (modul i lëndës e drejtë ndërkombëtare publike dhe e drejtë ndërkombëtare private)	6
8	Praktika 4	
9	Teza e Diplomës	5
TOTAL		60



**Projekt - Programi i studimit
i Integruar i Ciklit të Dytë në
Drejtësi:**

Aktualisht, Departamenti i Shkencave Juridike, është në pritje të miratimit të riorganizimit të programit të studimit nga MASR, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	Histori e Institucioneve a. Histori e Institucioneve b. E Drejtë Romake	10
2	Hyrje në Ekonomi 6	
3	E drejte Publike	8
4	Histori e Shtetit dhe të Drejtës në Shqipëri	8
5	E Drejtë Kushtetuese	10
6	Gjuhë e Huaj (juridike)	6
7	Filozofi e së Drejtës 6	
8	Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut	6
TOTAL		60



VITI II		
NR	LËNDA	ECTS
1	E Drejtë Financiare	6
2	E Drejtë Civile	12
3	E Drejtë Penale (pj e përgjithshme)	12
4	E Drejtë Ndërkombëtare Publike	10
5	E Drejtë Administrative a. E Drejtë Administrative b. Procedurë Administrative	12
6	Metodat e Kërkimit Shkencor	4
7	Lëndë me zgjedhje I	4
TOTAL		60

VITI III		
NR	LËNDA	ECTS
1	E Drejtë e Detyrimeve	12
2	E Drejtë Penale (pj e posaçme)	12
3	Procedurë Civile	12
4	E Drejtë e Punës	10
5 E	Drejtë Familjare	8
6	E Drejtë Sociale e Punës	6
TOTAL		60



VITI IV		
NR	LËNDA E	CTS
1	Procedurë Penale 1	2
2	E Drejtë Europiane a. E Drejtë Publike Europiane b. E Drejtë Private Europiane	12
3	E Drejtë e Shoqërive Tregare 1	0
4 E	Drejtë Ndërkombëtare Private	10
5	Kriminalogji-Penalogji a. Kriminalogji-Penalogji b. Ekzekutimi i Vendimeve Penale	10
6	Drejtësia Penale për të Mitur	6
TOTAL		60

VITI V		
NR	LËNDA E	CTS
1	E Drejtë Penale Ndërkombëtare dhe Europiane a. E Drejtë Penale Ndërkombëtare b. E Drejtë Penale Europiane	8
2	E Drejtë Biznesi 6	
3	E Drejtë e Pronësisë Intelektuale	4
4	E Drejtë Penale Ushtarake	4
5	Metoda Praktike të Zbulimit të Veprave Penale a. Kriminalistikë b. E Drejtë Penale Informatike (kibernetike)	6
6	Lëndë me Zgjedhje II	4
7	Lëndë me Zgjedhje III 4	
8	Praktikë/Klinikë e Ligjit	12
9	Diplomë/Provim Përfundimtar	12
TOTAL		60



Programi i Studimit Master Profesional në “Shkenca Penale”:

Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Penale” është licencuar me Vendim Nr. 597, datë 28.05.2009, mbështetur me Urdhrin Nr.308, datë 08.06.2010. Programi është akredituar me Urdhrë Nr. 585, datë 27.11.2012 të Ministrisë Përgjegjëse dhe riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 25, datë 12.04.2019.

Departamenti i Shkencave Juridike ka ofruar për herë të parë mësimdhënien në këtë program studimi në vitin akademik 2010-2011.

Kohëzgjatja e këtij programi studimi është 1 vit akademik dhe përbëhet nga 60 kredite (ECTS) gjithsej.

Ky program studimi përgatit specialistë të aftë për të organizuar, planifikuar dhe drejtuar veprime proceduriale që duhet të kryhen nga subjektet e procedimit penal gjatë veprimtarisë hetimore, gjyqësore dhe në ekzekutimin e vendimeve, lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në luftën kundër krimit, si dhe dhënien e drejtësisë në fushën e së drejtës penale.

Studentët në përfundim të këtij programi studimesh duhet të jenë të aftë:

1. të njihen me teoritë me vendimet e gjykatave në lidhje me veprat penale dhe trajtimin teorik që u bëhet atyre;
2. të njihen me problemet dhe të metat që ekzistojnë në legjislacionin tonë penal;
3. të njihen me të gjithë problematikën procedurale që ka të bëjë me administrimin e provës penale, procedimit penal, ekstradimit, atestimit, etj.;
4. të mund të arsyetojnë, analizojnë, argumentojnë dhe japin mundësi për zgjidhje në lidhje me një sërë faktorësh dhe motivesh të cilat





ndikojnë në lindjen dhe zhvillimin e kriminalitetit në shoqërinë tonë;

5. të mund të njohin nga afër teknikat shkencore që merren me zbulimin marrjen dhe analizimin e provave penale.

Programi, kombinon formimin akademik me përvojën praktike, dhe realizohet në bashkëpunim me gjykata të niveleve të ndryshme të sistemit të drejtësisë dhe me zyra ligjore prestigjioze, vendase dhe të huaja, pranë të cilave mundësohet zhvillimi i praktikës profesionale.

Ky program studimi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe në përputhje me udhëzimet e MASR. Studentët që do të diplomohen në Programin e Studimit Master Profesional në “Shkenca Penale” do të kenë mundësi të punësohen apo të vijojnë karrierën e tyre profesionale në një sërë sektorësh apo organesh që lidhen me aplikimin e së drejtës penale. Ky program është i përshtatshëm për ata që duan të punojnë në fushën e avokatisë, si juristë pranë institucioneve të pavaruara, studiove ligjore apo pedagog në universitet. Studentët mund të punësohen në struktura si shoqatat joqeveritare, që merren me mbrojtjen e grave apo mbrojtjen e të miturve, si dhe ato që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut apo edhe të të burgosurve në veçanti.

Kurrikula e Programit të Studimit Master Profesional në “Shkenca Penale”:

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	E Drejtë Penale e Avancuar I 6	
2	E Drejtë Penale Ndërkombëtare	6
3	Krimi i Organizuar	6
4	Kriminalistikë	6
5	Një lëndë me zgjedhje: - E Drejtë Kibernetike; - E Drejtë Penitenciare; - Drejtësia Penale për të Mitur	6
6	Procedurë Penale	6
7	E Drejtë Penale e Avancuar II	6
8	Kriminologji - Penologji	6
9	Praktikë (profesionale)	6
10	T eza e Diplomës	6
TOTAL		60



Programi i Studimit Master Profesional në “E Drejtë Private”:

Programi i studimit Master Profesional në “E Drejtë Private” është licencuar me Vendim Nr. 597, datë 28.05.2009, mbështetur me Urdhrin Nr. 308, datë 08.06.2010. Programi është akredituar me Urdhër Nr. 585, datë 27.11.2012 të Ministrisë Përgjegjëse dhe riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 24, datë 12.04.2019. Kohëzgjatja e këtij programi studimi është 1 vit akademik, dhe përbëhet nga 60 kredite (ECTS) gjithsej.

Objektivi i këtij programi studimi, është të arsimojë dhe trajtojë profesionalisht studentët dhe të formojë njohuri specifike në kuptimin e integritit të formimit të juristit me profil civil. Ky rezultat arrihet nëpërmjet

studimit të instituteve specifike, sektorëve disiplinorë dhe nëpërmjet zgjerimit të studimit në fusha të cilat karakterizohen nga specialiteti sektorial.

Kompetencat specifike të programit i kushtohen integritit të studentit në fushën e së drejtës civile, e së drejtës kontraktore, në të drejtë të shoqërive tregtare, të drejtës familjare, të drejtës së punës, procedurës civile, mbështetur këto vetëm mbi legjislacionin vendas por edhe në vështrim krahasues.

Në përfundim të këtij programi studimi, synohet formimi i një figure profesionale e cila:

1. zotëron jo vetëm njohuri bazë, që mundëson vlerësimin e instituteve të së drejtës private, edhe sipas perspektivës evolutive historike;
2. ideon dhe harton me efikasitet dhe saktësi, tekste me përmbajtje juridike në përputhje me kontekstet përkatëse, të mirëargumentuara, edhe nëpërmjet përdorimit të mjeteve informatike;
3. të përfitojë aftësi interpretuese, analitike dhe me kualifikim juridik, në trajtimin e problemeve interpretuese dhe zbatuese të së drejtës private;
4. të zotërojë metodologjinë dhe instrumentet e nevojshme për artikullimin me shkrim dhe me



gojë të arsytimeve juridike private, për të cilat kërkohet kompetencë profesionale në studimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë në të gjitha llojet e saj, të mënyrave të fitimit të pronësisë, të mbrojtjes së saj;

5. të zotërojë aftësi në zbatimin e njohurive të fituara në praktikë, në të gjitha çështjet e pronësisë, trashëgimisë, procedurës civile, etj.

Programi, kombinon formimin akademik me përvojën praktike, dhe realizohet në bashkëpunim me gjykata të niveleve të ndryshme të sistemit të drejtësisë dhe me zyra ligjore prestigjioze, vendase dhe të huaja, pranë të cilave mundësohet zhvillimi i stazhit dhe praktikës profesionale.

Ky program studimi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe në përputhje me udhëzimet e MASR. Studentët që do të diplomohen në programin e studimit Master Profesional në “E Drejtë Private” do të kenë mundësi të punësohen apo të vijojnë karrierën e tyre profesionale në një sërë sektorësh apo organesh që lidhen me aplikimin e të drejtës private, si juristë pranë bizneseve, në ndërmarrje, banka, shoqëri sigurimesh dhe konsulentë ligjorë pranë autoriteteve të pavarura si dhe personel drejtues në administratën publike.

Kurrikula e Programit të Studimit Master Profesional në “E Drejtë Private”:

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	E Drejtë Civile e Avancuar	6
2	E Drejtë e Autorit	6
3	E Drejtë e Detyrimeve dhe e Kontratave	6
4	E Drejtë Pune e Avancuar	6
5	Një lëndë me zgjedhje: - E Drejtë Biznesi; - Sistemet e Huaja më të Mëdha të së Drejtës	6
6	Procedurë Civile e Avancuar	6
7	E Drejtë e Shoqërive Tregtare	6
8	E Drejtë Familjare e Avancuar	6
9	Praktikë (profesionale)	6
10	T eza e Diplomës	6
TOTAL		60



Programi i Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike”:

Departamenti i Shkencave Juridike, ofron tashmë prej 7 vitesh programin në ciklin e dytë të studimit Master i Shkencave në fushën e “Shkencave Juridike”, duke filluar mësimdhënien në vitin akademik 2011-2012, i licencuar me Vendim Nr. 408, datë 26.05.2010 dhe akredituar me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 49, datë 19.05.2017 “Për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Shkenca Juridike me drejtime: E Drejtë Publike dhe Administrative; E Drejtë Private; E Drejtë Penale” të Universitetit Privat “Albanian University”.

Programi i Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” ka për qëllim përgatitjen e specialistëve në një prej tre profileve të mëposhtme:

1. E Drejtë Private;
2. E Drejtë Publike dhe Administrative;
3. E Drejtë Penale.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike”, mundëson thellimin e studimeve të

përfitur me studimet e nivelit Bachelor në “Shkenca Juridike”, dhe profilizimin e njohurive mbi një nga fushat specifike të ofruara me këtë program studimi.

Gjithashtu ai ofron:

1. Përgatitje të avancuar për një formim të kompletuar të aftësive që u korrespondojnë niveleve të kualifikuara të punësimit dhe të profesionalizmit;
2. Kërkim të pavarur nëpërmjet instrumentave dhe teknikave të kërkimit.

Programi ka një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike me një total prej 120 kredite (ECTS).

Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” synon një formim të plotë në fushën ligjore të studentëve, e cila paraqitet e domosdoshme për të vepruar me kompetencë në realitetin kompleks aktual juridik.

Programi kombinon formimin akademik me përvojën praktike dhe realizohet në bashkëpunim me gjykata të niveleve të ndryshme të sistemit të drejtësisë dhe me zyra ligjore prestigjioze, vendase dhe të huaja, pranë të cilave mundësohet zhvillimi i stazhit dhe praktikës profesionale.



Kurrikula e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike”:

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	E Drejtë Penale (pj. e posaçme)	9
2	E Drejtë e Shoqërive Tregtare	9
3	E Drejtë Kushtetuese e Avancuar	6
4	E Drejtë Civile e Avancuar	6
5	Procedurë Civile e Avancuar	9
6	Procedurë Penale e Avancuar	9
7	Histori e Shtetit dhe e së Drejtës	6
8	E Drejtë e Detyrimeve e Avancuar	6
TOTAL		60

VITI II		
NR	LËNDA	ECTS
1	E Drejtë Administrative e Përparuar	6
2	Metodat e Kërkimit Shkencor	6
3	E Drejtë Ndërkombëtare dhe Komunitare e Punës	6
4	Tre lëndë me zgjedhje sipas profileve (nga lista bashkëngjitur)	18
5	Praktikë Profesionale	6
6	Teza e Diplomës	18
TOTAL		60



- **Lëndë me zgjedhje (Profili E Drejtë Publike dhe Administrative) – 6 ECTS**

1. Drejtësia Kushtetuese
2. Pushteti Ekzekutiv
3. Organizimi dhe Kontrolli Administrativ
4. Institucione të Administratës Publike
5. Qeverisja dhe Institucione Lokale
6. E Drejtë Mjedisi
7. E Drejtë Administrative e Bashkimit Evropian
8. E Drejtë Publike e Krahasuar
9. E Drejtë Financiare
10. E Drejtë Kushtetuese e Krahasuar
11. Parimet Themelore të Shtetit Laik dhe Neutral
12. E Drejtë Parlamentare

- **Lëndë me zgjedhje (Profili E Drejtë Private) – 6 ECTS**

1. E Drejtë e Falimentimit
2. E Drejtë e Konkurrencës
3. E Drejtë Ndërmjetësimi dhe Arbitrazhi
4. Qeverisja e Korporatave
5. E Drejtë Tregtare Ndërkombëtare
6. E Drejtë e Pronësisë Industriale
7. E Drejtë e Medias
8. E Drejtë e Bashkimit Evropian e Avancuar

9. Tregjet e Kapitaleve
10. E Drejtë e Bankës dhe e Bursës
11. E Drejtë e Sigurimeve Shoqërore
12. E Drejtë Civile e Krahasuar
13. E Drejtë Sindikale
14. E Drejtë PUNE e Krahasuar
15. E Drejtë e Prokurimeve

- **Lëndë me zgjedhje (Profili E Drejtë Penale) – 6 ECTS**

1. Gjykatat Ndërkombëtare
2. E Drejtë Ndërkombëtare Penale
3. E Drejtë Penale e Biznesit
4. E Drejtë Penale e Krahasuar
5. E Drejtë Penitenciare
6. E Drejtë Penale për të Miturit
7. Krimi i Organizuar
8. Politike Penale
9. Psikologji Sociale
10. Mjekësi Ligjore
11. Kriminologji - Penologji
12. Kriminalistikë
13. Siguria Globale dhe Terrorizmi
14. Jurisprudenca e Gj.E.D.Nj.



DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKO-ADMINISTRATIVE

Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, në Albanian University.

Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2005-2006. Programet e studimit që ofron Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, në themel të tyre kanë formimin dhe përgatitjen e politologëve me profil të përgjithshëm dhe ekspertëve në fushën e administratës publike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, duke synuar në radhë të parë përgatitjen e specialistëve të aftë në këto fusha studimore, por edhe krijimin e konsolidimin e një tradite të re në ambientin politik shqiptar. Programet e ofruara nga departamenti i shkencave politiko-administrative gërshetojnë teorinë me praktikën, duke zhvilluar mendimin kritik dhe analitik, një

aftësi thelbësore për pothuajse të gjitha profesionet specifike.

Departamenti ofron programet e studimit:

Bachelor në:

- Shkenca Politiko-Administrative;

Master i Shkencave në:

- Administrim Publik me dy profile:
 - Politika Publike dhe Qeverisje;
 - Politikat Publike dhe Bashkimi European.

Master Profesional në

- Qeverisje dhe Administrim Publik.

Sektorët e mundshëm të punësimit:

- Institucione publike dhe private;
- Organizata ndërkombëtare;
- Parti politike, media, etj.



Programi Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative”

Programi i Studimit Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative” licencuar me urdhër Nr. 8981, datë 27.12.2005; akredituar me urdhër Nr. 532, datë 27.11.2010 dhe riakredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 86, datë 21.09.2017.

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative” është program studimi i ciklit të parë, me kohëzgjatje normale 3 vjeçare të cilave u përkojnë 180 kredite. Forma e studimit është me kohë të plotë.

Ky program studimi ka si qëllim kryesor zhvillimin dhe përcjelljen e dijeve, realizohet nëpërmjet zhvillimit të një sërë disiplinash (formuese të përgjithshme, karakterizuese, integruese), me anë të së cilave synohet asimilimi i njohurive teorike dhe zhvillimi i mendimit kritik. Gjatë vitit të parë akademik ky program studimi ka si synim t’u ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karaktereve sociologjike, historike dhe filozofike si dhe të realizojë gjatë 2 viteve të tjera akademike thellimin e njohurive, konkretisht në disiplinat ekonomiko-politike, juridike, administrative, politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare duke vendosur objektiva specifike për përgatitjen e politologëve dhe ekspertëve në fushën e administratës.

Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative”

VITI I PARË		
NR	LËNDA	ECTS
1	Teoritë Sociologjike	10
2	Filozofi	10
3	Shkenca Politike	10
4	Gjuhë e Huaj	8
5	Histori Botërore	10
6	Lexim Kritik dhe Shkrim Akademik	6
7	Lëndë me zgjedhje: Psikologji Politike/ Antropologji Sociale dhe Politike	6
TOTAL		60



VITI I DYTË		
NR	LËNDA	ECTS
1	Teori dhe Institucione të së Drejtës	10
2	Histori e Ideve Politike 9	
3	Elemente të Qeverisjes dhe Procese Zgjedhore	10
4	Historia e Shtetit Shqiptar dhe Sistemet Politike dhe Administrative	10
5	Historia e Mendimit Ekonomik (teoritë ekonomike)	6
6	Historia dhe Politikat në Ballkan	9
7	Lëndë me zgjedhje: Filozofi e së Drejtës/Sociolinguistikë/ Sjellje politike/ Globalizim dhe Integrim	6
	TOTAL	60

VITI I TRETË		
NR	LËNDA	ECTS
1	Filozofi Politike	5
2	Administrim dhe Politikat Publike	10
3	Histori e Marrëdhënieve Ndërkombëtare	10
4 M	Metodat e Kërkimit Shkencor 9	
5	Origjina dhe Analizë e BE-së	10
6	Lëndë me zgjedhje: Komunikimi Politik/ Qeverisja Lokale/ Financa Publike/ Aftësi Menaxheriale	6
7	Praktika 4	
8	Teza e Diplomës	6
	TOTAL	60

3 VITE – 180 ECTS





**Master i Shkencave në
“Administrim Publik” me profile:
“Politika Publike dhe Qeverisje”
dhe “Politika Publike dhe BE”**

Programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim publik” me profile: “Politika Publike dhe Qeverisje” dhe “Politika Publike dhe BE” është licencuar me VKM Nr. 56, datë 21.01.2009, plotësuar me Urdhrin e MASH Nr. 308, datë 08.06.2010. Ky program është akredituar me urdhër Nr. 499, datë 18.10.2012 dhe riakreditur me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 23, datë 12.04.2019.

Programi Master i Shkencave në “Administrim Publik” është program studimi i ciklit të dytë, me kohëzgjatje normale 2 vjeçare të cilave u përkojnë 120 kredite. Forma e studimit është me kohë të plotë. Ky program synon ofrimin e njohurive teorike të thelluara si dhe krijimin e kompetencave dhe aftësive në administrim publik, politika publike, sisteme qeverisëse, politika dhe menaxhim sektorial, qeverisje vendore, zhvillim institucional, integrim evropian. Ky program studimi zhvillon aftësinë për të drejtuar studime dhe kërkime të avancuara në mënyrë të pavarur, pajis pjesëmarrësit me metodologji shumë të avancuara në fushën e studimeve mbi administratën publike, ofron njohuri mbi metodat matëse sasiore të zhvilluara mbi përmirësimin e administratës publike, njeh me modelet dhe vizionet bashkëkohore mbi pozicionimin e administratës publike në kontekstin e globalizimit dhe integritimit evropian.



Kurrikula e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Administrim publik” me profil “Politika Publike dhe Qeverisje”

VITI I PARË		
NR	LËNDA	ECTS
1	Administrimi Publik në Teori dhe Praktikë	7
2	Institucione dhe E Drejtë Administrative	7
3	Metodologji e Avancuar e Kërkimit në Shkencat Sociale	7
4	Sistemet Shtetërore dhe E Drejtë Kushtetuese	13
5	Politikat Publike	7
6	Etika dhe Deontologjia e Funkionarit Publik	7
7	Komunikim Publik dhe Institucional 6	
8	Me zgjedhje (Ka detyrim të zgjedhë 1 lëndë): A) Politika Sociale të Krahasuara B) E Drejtë e Punës dhe Sigurisë Sociale	6
TOTAL		60

VITI I DYTË		
NR L	ËNDA	ECTS
1	Analizë E Politikave dhe Qeverisjes	13
2	Qeverisja Qëndrore dhe Lokale (Aspekte Krahasuese)	12
3	Institucione Politike	5
4	Praktikë Specialiteti në Institucione	6
5	Me zgjedhje (Ka detyrim të zgjedhë 1 lëndë): A) Politikat e Personelit dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore B) Politikat Ekonomike dhe Rajonale të BE-Ssë C) Struktura, Politika dhe Institucione të BE-së	6
6	Detyrime Përmbyllëse	18
TOTAL		60

TOTALI 120 ECTS



Kurrikula e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Administrim publik” me profil “Politika Publike dhe BE”

VITI PARË		
NR	LËNDA	ECTS
1	Administrimi Publik në Teori dhe Praktikë	7
2	Institucione dhe e Drejtë Administrative	7
3	Metodologji e Avancuar e Kërkimit në Shkencat Sociale	7
4	Sistemet Shtetërore dhe e Drejtë Kushtetuese	13
5	Politikat Publike	7
6	Etika dhe Deontologjia e Funkionarit Publik	7
7	Komunikim Publik dhe Institucional	6
8	Me zgjedhje (ka detyrim të zgjedhë 1 lëndë): a)Politikat Sociale të Krahasuara b)Zhvillimi I Politikave Publike dhe Qeverisjes në Shqipëri dhe Procesi i Integritimit në BE	6
TOTAL		60

VITI DYTË		
NR	LËNDA	ECTS
1	Institucione dhe Integrimi i BE-së 1	3
2	Politikat e BE-së	12
3	Qeverisje Lokale dhe Rajonale	5
4	Praktikë Specialiteti në Institucione	6
5	Me zgjedhje (ka detyrim të zgjedhë 1 lëndë): a) Politikat e Personelit dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore B) Politika Ekonomike dhe Rajonale Të Be-Së C) E Drejtë dhe Siguri Socile Europiane	6
6	Detyrime Përmbyllëse	18
TOTAL		60

TOTALI 120 ECTS



Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik”

Programi i studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” është licencuar me VKM Nr. 597, datë 28.05.2009, plotësuar me Urdhrin e MASH Nr. 308, datë 08.06.2010. Ky program është akredituar me urdhër Nr. 499, datë 18.10.2012 dhe riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 22, datë 12.04.2019.

Programi i studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” është program studimi i ciklit të dytë, me kohëzgjatje normale 1 vit me 60 kredite. Forma e studimit është me kohë të plotë.

Ky program ofrohet në funksion të rritjes së mëtijshme të nivelit të kualifikimit dhe shtimit të shanseve e premisave për një karrierë potenciale të suksesshme në administratën publike. Nëpërmjet këtij masteri, ofrohen njohuri të avancuara bashkëkohore në planin teorik, duke theksuar njëkohësisht aspektet praktike të zbatimit të tyre në realitetin shqiptar, pajisjen e të diplomuarve me njohuri bazë mbi teorinë e shkencave administrative, procedurat, politikat, institucionet lokale dhe qeverisjen e tyre. Një vëmendje e veçantë i kushtohet dimensionit dhe njohjes së strukturave, institucioneve, legjislacionit dhe funksionimit të institucioneve kombëtarë lokale.

Kurrikula e Programit të Studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik”

VITI I		
NR L	ËNDA	ECTS
1	E Drejtë Kushtetuese e Krahasuar dhe Sisteme Administrative të Krahasuara.	6
2	Lëndë me zgjedhje a)Financa Publike b)Analizë e Politikave Publike	4
3	Shkenca Administrative (vlera, koncepte, parime & raste studimore)	5
4	Institucione Politike	5
5	Komunikim Publik dhe Marketing Institucional	5
6	Strategji të Zhvillimit Ekonomik Lokal	5
7	Qeverisje Lokale 5	
8	Politika, Planifikim dhe Zhvillim Urban	5
9	Lëndë me zgjedhje a) E Drejta e Punës dhe Sigurisë Sociale b) E Drejta e Mjedisit	4
10	E Drejtë dhe Procedurë Administrative e Avancuar	4
11	Praktikë Profesionale	6
12	Temë Diploma	6
TOTAL		60

TOTAL 60 ECTS



DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË SË PËRGJITHSHME

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, pjesë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore në Albanian University, i ka fillësat e tij në vitin 2006, kur edhe ka pritur brezin e parë të studentëve.

Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka si mision kryesor përgatitjen e profesionistëve të aftë si nga pikëpamja teorike ashtu edhe praktike në drejtim të çështjeve të psikologjisë dhe lidhjes së tyre me mirëqenien psiko-sociale të individit dhe komunitetit.

Për arritjen e misionit të tij, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme realizon procesin e mësimdhënies, kërkimin shkencor si dhe ofrimin e shërbimeve komunitare në kuadër të përmbushjes së përgjegjesisë sociale.

Veprimtaritë specifike të kërkimit shkencor përfshijnë fusha të ndryshme të psikologjisë si psikologjia klinike, konjitive, e punës, e shëndetit, sociale, e zhvillimit dhe proceseve edukative. Duke u nisur nga kjo perspektivë multidisiplinare, studimi i sjelljes dhe i funksioneve njihëse realizohet përmes perspektivave hulumtuese dhe metodologjive të ndryshme, kjo në varësi të specializimit të stafit akademik dhe kërkuesve shkencorë që janë pjesë e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme.

Departamenti ofron programe studimi të ciklit të



parë si: Bachelor në “Psikologji të Përgjithshme” dhe programe studimi të ciklit të dytë si: Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”, Master Profesional në “Psikologji Shkollore” dhe Master Profesional në “Psikologji Klinike”.

Programet mësimore të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme janë mbështetur në modele të kurrikulave të shkollave amerikane dhe evropiane të psikologjisë dhe janë hartuar duke marrë në konsideratë zhvillimet më të fundit të shkencës së psikologjisë si dhe kërkesa të tregut të punës shqiptar.

Programi i Studimit Bachelor në “Psikologji të Përgjithshme”

Programi Bachelor në “Psikologji të Përgjithshme”, i ofruar nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në Albanian University është licencuar me miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Nr. 8981, datë 27.12.2005, akredituar me Urdhër Nr. 541, datë 01.12.2010 të Ministrisë Përgjegjëse, riakredituar me vendim të Bordit të Akreditimit, Nr. 84, datë 21.09.2017.

Programi i studimit Bachelor në “Psikologji të Përgjithshme” ka mision të tij përgatitjen e një brezi të ri profesionistësh në fushën e psikologjisë, të aftë për të kuptuar dhe trajtuar me profesionalizëm, etikë, dhe në respekt të dinjitetit dhe integritetit njerëzor, problematikat psiko - sociale me të cilat ndeshen individët dhe shoqëria shqiptare.

Programi Bachelor në “Psikologji të Përgjithshme” shtrihet në 3 vite studimi, në të cilat përfshihen lëndë të formimit të përgjithshëm, lëndë plotësuese, lëndë me zgjedhje si dhe lëndë bazë të formimit profesional, që studentët do të dëshirojnë të ndjekin në studime të nivelit të dytë. Praktika mësimore realizohet gjatë semestrit të dytë të vitit të 3^{të}.

Sektorët e mundshëm të punësimit me përfundimin e programit Bachelor janë:

- Spitale dhe klinika publike e private për fëmijë dhe adoleshentë;
- Organizata jofitimprurëse.



**Kurrikula e Programit të
Studimit Bachelor në
“Psikologji të Përgjithshme”**

VITI I		
Nr	LËNDA	ECTS
1	Psikologji e Përgjithshme	9
2	Histori e Mendimit Psikologjik I dhe II	9
3	Psikologji Sociale	6
4	Shkrim Akademik	6
5	Gjuhë e Huaj	9
6 F	ilozofi	4
7	Sociologji	5
8	Biologji Humane	6
9	Psikologji Zhvillimi	6
	Total	60



VITI II		
Nr	LËNDA	ECTS
1	Psikologji Zhvillimi (I)dhe Psikologji për fëmijët me aftësi ndryshe (II)	12
2	Psikologji Konjitive	9
3	Metodat e Kërkimit Cilësore dhe Sasiore	9
4	Psikologji Fiziologjike (I) dhe Psikologji e Gjunit dhe Ëndrrave (II)	9
5	Psikologji Anormale	9
6	Psikologji Personaliteti	6
7	Lëndë me zgjedhje	6
	Total	60

VITI III		
Nr	LËNDA	ECTS
1	Psikoterapi	10
2	Psikologji Këshillimi (I) dhe Teoritë dhe Teknikat e Dinamikave të Grupit (II)	12
3	Psikologji Edukimi (I) dhe Pedagogji (II)	9
4	Psikodiagnostikë (I) dhe Psikologji Shëndeti (II)	9
5	Lëndë me zgjedhje	5
6	Praktikë	9
7	Diploma	6
	Total	60

3 VITE – 180 ECTS



Programi i Studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”

Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” është licencuar me VKM Nr. 597, datë 28.05.2009, plotësuar me urdhrin e MASH Nr. 308, datë 08.06.2010. Ky program është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 327, datë 07.08.2012 dhe riakredituar me VBA Nr. 85, datë 07.12.2018. Ky program studimi synon t’u paraqesë studentëve një vlerësim të thelluar të metodave dhe teknikave për vlerësimin dhe ndërhyrjet klinike. Programi i studimit është mbështetur mbi modelin e sistemeve biopsikologjike të të kuptuarit të sjelljes njerëzore dhe ky program i ofron studentëve një panoramë të detajuar të detyrave dhe aftësive klinike të cilat janë themelet e punës së psikologut klinik. Studentët do të pajisen me informacion të zgjeruar lidhur me metodat e kërkimit, çështje të etikës, diversitetit kulturor, vlerësimit, psikoterapisë, dhe në mënyrë më të specifikuar, me aftësi praktike në secilën nga çështjet e mësipërme. Ky program do t’iu vijë në ndihmë studentëve për të kuptuar me thellë praktikën e punës së psikologut klinik.

Mundësitë e ndryshme të punësimit, metodat bashkëkohore të vlerësimit dhe trajtimit klinik si dhe çështje ligjore dhe etike që rregullojnë profesionin e

psikologut klinik do të përshkojnë në tërësi programin e studimit.

Sektorët e mundshëm të punësimit me përfundimin e këtij masteri janë:

- Institucione të ndryshme kërkimore, të tilla si universitete, agjenci, organizata apo fondacione kërkimi;
- Praktikantë të lirë duke siguruar këshillim, terapi, vlerësim dhe konsultim ndaj individëve, familjeve, grupeve dhe organizatave;
- Mjediset apo qendrat që ofrojnë shërbime në përkujdesje të shëndetit mendor të tilla si spitalet psikiatrike, shtëpitë e mbështetura, qendrat komunitare të shëndetit mendor, institucione dhe organizata jofitimprurëse të ndryshme me fokus ofrimin mbështetjen, dhe rehabilitimin e individëve (fëmijë, adoleshentë, të rritur, të moshuar) me probleme të shëndetit mendor;
- Organizata jofitimprurëse;
- Spitale dhe klinika publike e private për fëmijë dhe adoleshentë.

**Kurrikula e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”**

VITI I		
Nr	LËNDA	ECTS
1	Psikologji Klinike	6
2	Vlerësim Psikologjik (I) dhe Njohuri dhe Aftësi të Psikologut Klinik (II)	13
3	Metodat Cilësore të Kërkimit në Psikologji (I) dhe Metodat Sasiore të Kërkimit në Psikologji (II)	10
4	Neuropsikologjia Klinike (I) dhe Psikoterapi (II)	14
5	Psikologji Zhvillimi e Avancuar	6
6	Etika në Psikologjinë Klinike	6
7	Lëndë me zgjedhje	5
	Total	60

VITI II		
Nr	LËNDA	ECTS
1	Psikofarmakologji	8
2	Psikopatologji e Zhvillimit të fëmijëve (I) dhe Psikopatologji e Adoleshentëve (II)	10
3	Terapia e Grupit	6
4	Intervistim dhe Praktikum	6
5	Lëndë me zgjedhje	6
6	Praktikë	6
7	Teza e Diplomës	18
	Total	60

2 VITE – 120 ECTS



Programi i Studimit Master Profesional në “Psikologji Shkollore”

Programi i studimit Master Profesional në “Psikologji Shkollore” është licencuar me Urdhër Nr. 202, datë 28.05.2013 të MASH, akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 44/2, datë 02.02.2018. Ky program synon të ofrojë arsim dhe trajnim të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirës profesional për aplikimin e teorive, dijeve, aftësive dhe kompetencave psikologjike në sistemin shkollor.

Programi i studimeve Master Profesional në Psikologjinë Shkollore është ndërtuar në mënyrë që të formojë psikologë shkollore të cilët të jenë të aftë të ofrojnë shërbimin më të përshtatshëm për komunitetin e shkollës.

Sektorët e mundshëm të punësimit me përfundimin e këtij masteri janë:

- Sistemi edukativ parauniversitar dhe parashkollor publik e privat;
- Qendra komunitare që ofrojnë shërbime psiko-sociale për fëmijët dhe adoleshentët;
- Institucione publike që hartojnë politika për fëmijët dhe adoleshentët
- Organizata jofitimprurëse;
- Institucione dhe organizata që merren me mbrojtjen e të drejtave të miturve, etj.



**Kurrikula e Programit të
Studimit Master Profesional në
“Psikologji Shkollore”**

VITI I		
Nr	LËNDA	ECTS
1	Hyrje në Psikologji Shkollore	6
2	Dimensioni Konjitiv-Sjellor, Nxitja e Aftësive Akademike dhe Menaxhimi i Sjelljes	6
3	Dimensioni Socio-Emocional dhe Strategji për Integrim dhe Përshtatje	6
4	Zhvillimi Programeve për Fëmijët me Probleme të të Nxënit dhe Zhvillimit	6
5	Lëndë me zgjedhje: ∞ Psikologjia Sociale e Mjedisëve Shkollore ∞ Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adoleshentët	5
6	Metodologjia dhe Instrumentet për Këshillim dhe Orientim në Karrierë	6
7	Etika Profesionale e Psikologut Shkollor	6
8	Vlerësimi dhe Këshillimi me Fëmijët dhe Adoleshentët	5
9	Praktikë Profesionale	6
10	tema e Diplomës	8
	Total	60

1 VIT – 60 ECTS



Programi i Studimit Master Profesional në “Psikologji Klinike”

Programi i Studimit Master Profesional në “Psikologji Klinike” është licencuar me VKM Nr. 89, datë 10.02.2010. Akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 327, datë 07.08.2012, dhe riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.19, 02.03.2019. Ky program studimi është ndërtuar për t’iu përgjigjur nevojës së shumë psikologëve për t’u njohur me metodat më efikase për trajtimin e problematikave të ndryshme psikologjike. Psikologët klinikë synojnë të ofrojnë shërbimin e tyre duke u mbështetur në njohuri dhe aftësi të cilat mbështeten në modele bashkëkohore teorike dhe praktike të fushës së psikologjisë. Synimi i këtij programi studimi është t’iu paraqesë studentëve mënyrat e trajtimit duke përfshirë ato tradicionale sikurse janë ndërhyrjet e ndryshme psikoterapeutike, si terapia konjitivo-biheviorale, terapia familjare, terapia në grup etj. Vëmendja e

studentit do të drejtohet drejt zhvillimeve më të fundit të trajtimit të simptomatikave psikologjike e për rrjedhojë përmirësimin e shëndetit mendor. Ndërhyrje të tilla përfshijnë ushtrime psikoterapeutike, bio dhe neurofeedback-un, hipnozën, meditimin, etj. Klinikistët udhëhiqen drejt ndërtimit dhe përdorimit në vazhdimësi të protokolleve të trajtimit, të cilat parashikojnë edhe trajtimin multidisiplinar të pacientit.

Sektorët e mundshëm të punësimit me përfundimin e këtij masteri janë:

- Institucione të ndryshme kërkimore, të tilla si universitete, agjenci, organizata apo fondacione kërkimi;
- Praktikantë të lirë duke siguruar këshillim, terapi, vlerësim dhe konsultim ndaj individëve, familjeve, grupeve dhe organizatave;
- Mjediset apo qendrat që ofrojnë shërbime në përkujdesje të shëndetit mendor të tilla si spitalet psikiatrike, shtëpitë e mbështetura, qendrat komunitare të shëndetit mendor, institucione dhe organizata jo fitimprurëse të ndryshme me fokus ofrimin mbështetjen, dhe rehabilitimin e individëve (fëmijë, adoleshentë, të rritur, të moshuar) me probleme të shëndetit mendor.



**Kurrikula e Programit të Studimit
Master Profesional në
“Psikologji Klinike”**

VITI I		
Nr	LËNDA	ECTS
1	Konceptimi dhe Analiza e Rasteve Klinike	6
2	Psikopatologjia e Zhvillimit	6
3	Intervista Klinike	6
4	Psikologji Klinike e Avancuar	6
5	Lëndë me zgjedhje: Psikologjia Pozitive Vlerësimi dhe Testimi Psikologjik	5
6	Etika Profesionale në Psikologjinë Klinike	6
7	Psikoterapitë në Praktikën Klinike	6
8	Sistemet Aktuale Diagnostike	5
9	Praktika Profesionale	6
10	Tema e Diplomës	8
	Total	60

1 VIT – 60 ECTS



DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE ANGLISHTES

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Ky departament është ngritur në vitin 2010 dhe ofron programe të licencuara dhe akredituara sipas akteve nënligjore në fuqi për arsimin e lartë.

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ofron programe studimi:

Bachelor në:

- “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”,
- “Mësuesi për Arsimin Fillor”
- “Anglisht”

Master Profesional në:

- “Pedagogji” me dy profile
 - “Didaktikë” dhe
 - “Menaxhim Arsimi”.

Departamenti është në pritje të licensimit nga MASR për disa programe studimi si:

- Master i Shkencave në “Mësuesi në gjuhën

Angleze”;

- Master Profesional në “Gjuhë Angleze” me profile “Anglistikë-Amerikanistikë” dhe “Përkthim”;
- Program 2-vjeçar me karakter profesional “Kujdes profesional ndaj fëmijëve”.

Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”

Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, është licencuar me urdhër Nr.251, datë 02.06.2011, akredituar me Urdhër Nr.241, datë 09.05.2016 të Ministrisë Përgjegjëse, riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 35, datë 19.05.2017.

Programi i studimit bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është program studimi i ciklit të parë, me kohëzgjatje normale 3 vjeçare të cilave u përkojnë 180 kredite.

Ky program studimi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe rajonit si dhe nuk bie ndesh me interesat, vlerat kulturore kombëtare dhe të drejtat universale të njeriut të njohura nga akte dhe traktatet ndërkombëtare.



Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij, gjithashtu ky program synon pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme. Objektivat e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” janë:

- Të përgatisë mësues që do të punojnë me fëmijët e moshës 2-7 vjeç të cilët zhvillojnë procesin mësimor edukativ në institucionet publike dhe private;
- Të pajisë studentët me (kompetencat bazë/themelore) njohuri themelore nga fushat e pedagogjisë së përgjithshme, dhe metodave të mësimdhënies;
- Të pajisë studentët me (kompetencat bazë/themelore) njohuri themelore nga shkencat e edukimit dhe të sjelljes;
- Të pajisë studentët me (kompetencat bazë/themelore) aftësi, zotësi dhe shprehje të edukimit fizik, muzikor dhe artit pamor.

Ky program studimi ofron një kurrikulë të mirëorganizuar dhe bashkëkohore. Departamenti

ofron laboratorë siç është laborator i edukimit figurativ, në të cilin studentët kryejnë punime të ndryshme në lëndët e artit figurativ si dhe laboratorin e Informatikës në të cilin studentët zhvillojnë lëndët e aplikim kompjuterit. Në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes i ofron studentëve mundësinë për të kryer praktikat profesionale në institucionet e arsimit parauniversitar kopshtet dhe shkollat më elitare të Tiranës dhe rretheve.

Studentët që do të diplomohen në programin Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” do të kenë këto mundësi në tregun e punës:

- në institucionet publike të arsimit parashkollor (kopshte) si mësues ose edukatore kopshti;
- në institucionet publike të arsimit parashkollor (kopshte) si drejtues ose menaxherë;
- në institucionet publike të arsimit parashkollor (kopshte) si mësues ose edukatorë;
- në institucionet private të arsimit parashkollor (qendra të kujdesit për fëmijë) si mësues, edukatorë ose kujdestarë;
- në drejtori arsimore rajonale ose zyra arsimore të bashkive si specialistë të edukimit parashkollor.



**Kurrikula e Programit të
Studimit Bachelor në
Mësuesi për Arsimin Parashkollor”**

VITI I		
NR.	LËNDA	ECTS
1	Hyrje në Psikologji & Psikologji me Fokus Edukimi	11
2	Matematika Elementare (konceptet bazë) & Matematika nëpërmjet lojës	11
3	Gjuha Shqipe I & II (të folurit dhe të shkruarit në moshat e vogla)	12
4	Letërsia për Fëmijët e Moshës Parashkollore 5	
5	Gjuha e Huaj I & II(Anglisht)	4
6	Edukim Qytetar dhe Demokratik i Fëmijëve Parashkollorë	6
7	Aplikim Kompjuteri (përdorimi kompjuterit në moshat e vogla)	5
8	Edukim Figurativ (modelimi vizual i hapësirës) 6	
TOTAL		60



VITI II		
NR.	LËNDA	ECTS
1	Gjuha Shqipe për Parashkollorët (bazuar në stand. e arsimit) & Didaktika e Gjuhës Shqipe për Parashkollorët + Drejtshkrim	12
2	Psikologji Zhvillimi me Theks të Veçantë në Moshat 2-7 vjeç & Psikologji për Fëmijët me Nevoja të Veçanta	12
3	Politikat Arsimore dhe Legjislacioni 6	
4	Aritmetika e Numrave & Didaktika e Aritmetikës së Numrave	8
5	Edukim Muzikor dhe Didaktika e Edukimit Muzikor	6
6	Praktikë në Institucionet Parashkollore	12
7	Me zgjedhje: Histori e Pedagogjisë 4	
	Edukim Mjedisor	
	Njohuri Fillestare të Historisë së Shqipërisë	
TOTAL 6		0

VITI III		
NR.	LËNDA	ECTS
1	Njohuri Fillestare të Shkencave të Natyrës & Edukim Shëndetësor	12
2	Menaxhim Klase 4	
3	Edukimi Fizik (loja dhe lëvizjet e fëmijës parashkollor) & Didaktika Edukimi Fizik (për fëmijët parashkollore)	10
4	Media për Parashkollorët (Tregimet dhe përrallat) & Media për Parashkollorët (Kompjuteri)	10
5	Praktikë në Kopsht dhe në Klasën e Parë I & II 1	2
6	Me zgjedhje:	4
	Letërsi Shqipe	
	Teoritë e të Nxënit	
7	Tema e Diplomës	8
TOTAL		60



Programi Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”

Programi Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është licencuar me urdhër Nr. 251, datë 02.06.2011, akredituar me Urdhër Nr.381, datë 08.07.2016 të Ministrisë Përgjegjëse, riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 34, datë 19.05.2017.

Programi i studimit bachelor në “Mësuesi për Arsimin fillor” është program studimi i ciklit të parë, me kohëzgjatje normale 3 vjeçare të cilave u përkojnë 180 kredite.

Ky program studimi përgatit mësues për të dhënë mësim në klasat e ciklit të ulët të arsimit bazë ose klasat I-V. Një objektiv tjetër përcaktues i programit është pajisja e studentëve me njohuritë dhe aftësitë bazë që shërbejnë për studime të nivelit master në “Edukimin e Specializuar të Fëmijëve”.

Ky program studimi ka për qëllim të pajisë studentët me kompetencat bazë nga fushat që kontribuojnë në lëndët teorike që zhvillohen në klasat e ciklit të ulët, të tilla si: gjuhë shqipe, letërsi, gjuhë e huaj, matematikë, njohuri nga shkencat e natyrës, histori, gjeografi, përdorim të kompjuterit dhe edukim mjedisor e shëndetësor. Gjithashtu pajisjen e studentëve me njohuri themelore në fushën e Edukimit për të Drejtat e Njeriut/Edukimit Qytetar Demokratik, shkencat e edukimit si dhe etikës profesionale të mësuesit në arsimin fillor. Të aftësojnë studentët me kompetenca



e zotësi dhe shprehi të edukimit fizik, edukimit muzikor dhe atij pamor.

Struktura metodologjike e procesit të arteve figurative është rrugëtimi i nevojshëm për të nxitur krijimtarinë tek fëmijët. Në kuadër të kësaj, lënda e Edukimit Figurativ është ajo e cila u vjen në ndihmë dhe u mundëson studentëve të programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” dhe “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” përgatitjen e një platforme të gjerë dhe të qartë të kuptimit të fushave që mund të shpjegohen me stile, objekte, materiale të riciklueshme, vizime, dekore etj. Të gjitha punimet me përmbajtje të tillë realizohen në laboratorin e ngritur për këtë qëllim. Laboratori i Edukimit Figurativ është i pajisur me materialet e nevojshme për realizimin e punimeve nga ana e studentëve. Në orët e praktikës të cilat janë në dispozicion për këtë lëndë studentët punojnë në mënyrë të pavarur, nën mbikëqyrjen e pedagogut për realizimin e punimeve sipas programit të lëndës. Gjithashtu, mundësohet edhe kryerjen e praktikave profesionale në institucionet parauniversitare.

Programi Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” synon të formojë personel të aftë që të punojnë në tregun kombëtar të punës:

- Në shkolla të arsimit publik si mësues të ciklit të ulët të arsimit bazë 9-vjeçar;
- Në shkolla të arsimit privat si mësues të ciklit të ulët të arsimit bazë 9-vjeçar;
- Në drejtori arsimore rajonale ose zyra arsimore të bashkive si specialistë të arsimit fillor;
- Në agjenci publike si specialistë të arsimit fillor;
- Në agjenci private si specialistë të arsimit fillor;
- Në OJQ të specializuara për punë edukative si trajnues dhe këshillues për edukimin e fëmijëve të moshës 6-11 vjeç.



**Kurrikula e Programit
të Studimit Bachelor në
“Mësuesi për Arsimin Fillor”**

VITI I		
NR.	LËNDA	ECTS
1	Hyrje në Psikologji & Psikologji me Fokus Edukimi	12
2	Matematika I & II	12
3	Gjuha Shqipe I & II: Të Folurit dhe të Shkruarit në Moshat 6-11 vjeç	12
4	Letërsia për Fëmijët e Moshës së Shkollës Fillore & Drejtshkrim & Studimi dhe Shkrimi Akademik	15
5	Gjuha e Huaj I & II (Anglisht I & II) 4	
6	Modelimi Vizual i Hapësirës: Edukim Figurativ	5
TOTAL		60



Bachelor në "Anglisht"

Bachelor në "Anglisht" është licencuar me urdhër Nr. 199, datë 16.05.2012, akredituar me Urdhër Nr.437, datë 25.08.2016 të Ministrisë Përgjegjëse, riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 50, datë 10.07.2017.

Programi i studimit bachelor në "Anglisht" është program studimi i ciklit të parë, me kohëzgjatje normale 3 vjeçare të cilave u përkojnë 180 kredite.

Ky program studimi synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara të gjuhës dhe kulturës angleze. Gjatë këtij programi studimi studentët do të përvetësojnë dije që kanë si objektiv kryesor në përfundim të programit Bachelor 3–vjeçar, formimin e njohurive teorike mbi gjuhën angleze duke pasur në vëmendje nevojat që ka tregu i punës për njohës profesional të gjuhës angleze. Gjithashtu ky program i ofron studentëve njohuri të cilat mund të zhvillohen më tej në programe të specializuara që orientohen në studimin e profileve të detajuara të gjuhës angleze si master, PhD apo kurse trajnimi specifike. Në dispozicion të programit të studimit "Bachelor në "Anglisht" është ngritur dhe Laboratori i Informatikës. Laboratori është bazuar mbi shembujt e laboratorëve bashkëkohor në formën English Neë Media Centre në universitete jashtë vendit. Ky

laborator përbëhet nga njëzet e pesë kompjutera me kufje, ku studentët realizojnë si punë individuale ashtu edhe të përbashkëta të drejtuara nga kompjuteri qëndror. Ndërtimi i këtij laboratorit është bërë me konsultë nga Profesorë të Universitetit të Strasburgut dhe drejtues të qendrës së gjuhëve dhe laboratorëve. Në këtë laborator janë të instaluar programe të cilat iu vijnë në ndihmë studentëve të programit të studimeve Bachelor në "Anglisht". Laboratori shfrytëzohet për një pjesë të mirë të zhvillimit të lëndëve të këtij programi studimi si *Anglishte e folur*, *Anglishtja nëpërmjet medias* etj.

Në përfundim të studimeve të ciklit bachelor të diplomuarit mund të punësohen:

- Në institucionet qeveritare apo joqeveritare ku kërkohen zotërues të përgatitur të gjuhës angleze në rolin e përkthyesit apo si asistentë në projektet që punojnë kryesisht me gjuhën angleze;
- Në administratën arsimore rajonale;
- Në agjenci të ndryshme shërbimesh;
- Në institucionet mediatike;
- Në organizatat ndërkombëtare.



Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Anglisht"

VITI I		
NR.	LËNDA	ECTS
1	Gramatika: Morfologji Sintakse	8
2	Gjuha Shqipe 8	
3	Frëngjisht-1 & 2 1	4
4 F	onetikë	7
5	Leksikologji 8	
6	Anglisht e folur 8	
7	Lëndë me zgjedhje: Histori e Artit; Histori e Qytetërimeve	7
TOTALI		60



VITI II		
NR.	LËNDA	ECTS
1	Linguistikë 8	
2	Didaktikë e Gjuhëve të Huaja	8
3	Psikologji & Sociologji	13
4	Analizë Teksti	8
5	Shkrim Krijues 8	
6	Pedagogji 8	
7	Lëndë me zgjedhje: Spanjisht, Anglisht e Biznesit, Anglisht nëpërmjet Mediave	7
TOTALI		60

VITI III		
NR.	LËNDA	ECTS
1	Histori e Kulturës Anglo-Amerikane	7
2	Letërsi Angleze-Amerikane 7	
3	Teori dhe Praktikë Përkthimi	8
4	Shprehi Komunikimi 8	
5	Analizë Teksti 8	
6	Praktikë Metodologjike 7	
7	Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci	8
8	Teza e Diplomës	7
TOTALI		60



Master Profesional në “Pedagogji” me dy profile “Didaktikë” dhe “Menaxhim arsimit”

Programi i studimit Master Profesional në “Pedagogji” me dy profile “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimit”, është licencuar me VKM Nr. 89, datë 10.02.2010 dhe akredituar nga MASH me Urdhër Nr. 29, datë 31.01.2013.

Ky program studimi është riorganizuar në 60 kredite që zhvillohet në një vit akademik, bazuar në Ligjin 80/2015, si dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Ky program studimi ofrohet në përputhje me misionin, qëllimet e institucionit dhe strategjinë për zhvillim të institucionit. Programi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Synimi themelor i këtij programi studimi lidhet me kontributin në rritjen e cilësisë profesionale të diplomuarve në nivelin bachelor dhe që duan të vazhdojnë më tej karrierën profesionale duke u specializuar në fushën e mësuesisë.

Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij dhe mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike për arsye të karakterit të mirëfilltë profesional të tij dhe njohurive nga fushat e didaktikës dhe menaxhimit



të arsimit duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin e mëtejshëm të studentëve për punësim duke ndjekur njëkohësisht edhe politika favorizuese për punësimin e të diplomuarve të vet.

Ai ofrohet në module të veçanta dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Ky program studimi mbështetet në përvojën disaveçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane. Ai është ndërkombëtarisht konkurrues për nga elementet që përmban (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit, metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri.

Studentët të cilët diplomohen në programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Didaktikë” mund të punësohen si:

1. Mësues i specializuar në didaktikë;
2. Trajnues metodik në shkolla;
3. Specialist metodist në institucionet parashkollore;
4. Specialist metodist në institucionet e riedukimit;

5. Inspektor për mësimdhënien në drejtoritë rajonale arsimore.

Studentët të cilët diplomohen në programin e studimit Master Profesional në “Pedagogji” me profil “Menaxhim Arsimi” mund të punësohen si:

1. Drejtues arsimit në nivele të ndryshme;
2. Drejtorë dhe nëndrejtorë shkollash;
3. Këshilltarë për arsimin në pushtetin lokal dhe qendror;
4. Punonjës të specializuar në ministritë që mbulojnë arsimin, publikun dhe çështjet sociale;
5. Specialistë në mediane folur dhe të shkruar;
6. Specialistë në programet edukative të bizneseve.



**Kurrikula e Programit të Studimit
Master Profesional në
“Pedagogji” me Profil “Menaxhim
Arsimi”**

VITI I		
NR.	LËNDA	ECTS
1	Psikologji Edukimi	5
2	Pedagogji e Përgjithshme	5
3	Hartimi dhe Zhvillimi i Kurrikulës në Arsimin Parauniversitar	5
4	Legjislacioni dhe Reforma në Sistemin Parauniversitar	5
5	Vlerësimi dhe Standardet në Edukim	5
6	Lëndë me zgjedhje: 1. Shkolla dhe Komuniteti 2. Metodatat e Kërkimit Shkencor	5
7	Inspektimi dhe Supervizimi në Arsim	5
8	Shkrim Akademik	5
9	Bazat e Drejtimit dhe Administrimit të Arsimit	5
10	Lëndë me zgjedhje: 1. Politikat Arsimore 2. Edukimi Parauniversitar në vende të ndryshme të Europës	3
11 P	raktika	6
12	Teza e Diplomës	6
TOTAL		60



**Kurrikula e Programit të Studimit
Master Profesional në
“Pedagogji” me profil “Didaktik”**

VITI I		
NR.	LËNDA	ECTS
1	Psikologji Edukimi	5
2	Pedagogji e Përgjithshme	5
3	Hartimi dhe Zhvillimi i Kurrikulës në Arsimin Parauniversitar	5
4	Legjislacioni dhe Reforma në Sistemin Parauniversitar	5
5	Vlerësimi dhe Standardet në Edukim	5
6	Lëndë me zgjedhje: 1. Teoritë e të Nxënit 2. Metodatat e Kërkimit Shkencor	5
7	Kurrikula e Zbatuar në Arsimin Parauniversitar	5
8	Shkrim Akademik	5
9	Metodologji e Përgjithshme e Mësimdhënies	5
10	Lëndë me zgjedhje: 1. Historia e Arsimit Shqiptar 2. Edukimi Parauniversitar në vende të ndryshme të Europës	3
11	Praktikë	6
12	Teza e Diplomës	6
TOTAL		60



ALBANIAN UNIVERSITY

ALBANIAN
UNIVERSITY
ALBANIAN
UNIVERSITY
ALBANIAN
UNIVERSITY
ALBANIAN
UNIVERSITY

Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Angleze”

Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Angleze” ofrohet për herë të parë në Albanian University dhe është në fazë licensimi nga MASR.

Ky program studimi, i shtrirë në dy vite, dhe i përbërë nga 120 ECTS, ka një profil informues dhe analitik mbi gjuhën, kulturën, dhe konceptet e gjuhës angleze, letërsisë anglo-amerikane dhe kulturës së përgjithshme dhe specifike të vendeve anglofone.

Lëndët janë një thellim njohurish mbi aspektet themeltare të anglishtes, me të gjithë përbërëset e saj, e orientuar për profili i mësuesisë.

Synimi themelor i këtij programi studimi lidhet me kontributin në rritjen e cilësisë profesionale të diplomuarve në nivelin bachelor dhe që duan të vazhdojnë më tej karrierën profesionale duke u specializuar në fushën e mësuesisë së gjuhës angleze.

Programet mësimore janë ndërtuar me shumë kujdes, me synimin që studentët të marrin njohuritë e nevojshme, në përputhje me kërkesat për zhvillimin e arsimit të sotëm dhe të zhvillimeve të së ardhmes.

Studenti i cili do të diplomohet në programin e studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhë Angleze” mund të punësohet si “Mësues i Gjuhës Angleze”.



Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Angleze”

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	Kulturë dhe qyteterim i vendeve anglofone	6
2	Anglishtja si gjuhë ndërkombëtare	6
3	Njohuri të thelluara të gjuhës angleze	6
4	Psikologji e avancuar	6
5	Teoritë e të nxënit	6
6	Dialektet, diversiteti gjuhësor dhe ndërkulturor	6
7	Sintaksë e gjuhës angleze për mësuesit e anglishtes	6
8	Psikologji Edukimi	6
9	Metodologji mësimdhënie	6
10	Lëndë me zgjedhje: 1. Anglishtja përmes filmit dhe dramës 2. Përrallat dhe Legjendat e Botës Anglofone	6
	TOTAL	60

VITI II		
NR	LËNDA	ECTS
1	Menaxhim klase	5
2	Metodat e kërkimit shkencor	5
3	Didaktikë e avancuar e gjuhës angleze	5
4	Letërsia Anglo-Amerikane Për Fëmijë dhe të Rinj	6
5	Mënyrat e Vlerësimit	5
6	Lëndë me zgjedhje: 1. Mësimdhënia përmes teknologjisë 2. Hartimi dhe Zhvillimi i Kurrikulave Në Arsimin Parauniversitar 3. Edukimi Parauniversitar Në Vende të Ndryshme të Botës	4
7	Qasje krahasuese e tekstit Anglisht-Shqip	6
8	Praktikë	12
9	Teza e diplomës	12
	TOTAL	60



Master Profesional në “Gjuhë Angleze” me profile:

1. **“Përkthim”**
2. **“Anglistikë – Amerikanistikë”**

Programi i Studimit Master Profesional në “Gjuhë Angleze” me Profile: 1. “Përkthim” dhe 2. “Anglistikë-Amerikanistikë” ofrohet për herë të parë në Albanian University dhe është në fazë licensimi nga MASR. Ky program organizohet nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore nën përgjegjësinë e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes.

Programi i studimit Master Profesional në “Gjuhë Angleze” me profil “Përkthim”

Ky program studimi, i shtrirë në një vit, dhe i përbërë nga 60 ECTS, përgatit përkthyes letrar dhe profesional dhe ndërdisiplinor; përkthyes për vepra letrare dhe profesionale; përkthyes dhe interpret në institucione publike dhe private, ndërmjetësues shumë gjuhësor dhe shumë kulturor në organizma dhe organizata ndërkombëtare, shoqata të huaja dhe vendase, nëpunës i administratës publike, punonjës në OJF të ndryshme, në strukturat e pushtetit lokal, ndërmjetësues në marrëdhëniet me publikun, shoqërues për grupe turistike brenda dhe jashtë

vendit, përkthyes për mediat e shkruara, vizive dhe elektronike, ndërmjetësues shumë gjuhësore dhe shumë kulturore në fushën e kulturës, historisë, letërsisë, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë, etj.

Në përfundim të programit mësimor Master Profesional në “Gjuhë Angleze” me profil “Përkthim” studentët do marrin njohuri të thelluara mbi përkthimin në gjuhën angleze; ata do jenë specialistë e njohës të thelluar mbi teoritë dhe metodat e përkthimit, të qasjes krahasuese nga anglishtja në shqip, njohurive të thelluara të historisë, kulturës, letërsisë, politikës, institucioneve, gjuhës, dhe marrëdhënieve ndërkombëtare me specialitetin dhe prirjen e përkthimit.

Programi i studimit Master Profesional në “Gjuhë Angleze” me profil “Anglistikë-Amerikanistikë”

Ky program studimi, i shtrirë në një vit, dhe i përbërë nga 60 ECTS, ka një profil të thelluar njohurish mbi fushën e anglistikës dhe amerikanistikës.

Për këtë arsye programi përmban lëndët themeltare të historisë, kulturës, letërsisë, qeverisjes, institucioneve, gjuhës, dhe lidhjeve globaliste me shtetet e tjera. Lëndët shpalosin njohuri të thelluara profesionale për përgatitjen e specialistëve të ardhshëm në anglistikë dhe amerikanistikë.



**Kurrikula e Programit të studimit
Master Profesional në
“Gjuhë Angleze” me profil “Përkthim”**

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	Kulturë dhe Qyteterim i Vendeve Anglofone	5
2	Anglishtja si Gjuhë Ndërkombëtare	6
3	Etikë profesionale	3
4	Njohuri të thelluara të gjuhës angleze	4
5	Përkthim i specializuar 1	4
6	Metodologji Përkthimi dhe Redaktimi	5
7	Lëndë me zgjedhje: 1. Histori e Gjuhes Angleze 2. Metodatat e kërkimit shkencor	3
8	Përkthim A-B, B-A	5
9	Interpretim	5
10	Përkthim i specializuar 2	5
11	Lëndë me zgjedhje: 1. Përkthimi letrar 2. Shteti modern amerikan dhe britanik	3
12	Praktikë Përkthimi	6
13	Teza e diplomës	6
	TOTAL	60

**Kurrikula e Programit të studimit
Master Profesional në
“Gjuhë Angleze” me profil
Anglistikë-Amerikanistikë”**

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	Kulturë dhe qyteterim i vendeve anglofone	5
2	Anglishtja si gjuhë ndërkombëtare	6
3	Etikë profesionale	3
4	Njohuri të thelluara të gjuhës angleze	4
5	Marrëdhëniet e vecanta anglo-amerikane	4
6	Modernizmi dhe post-modernizmi britanik	5
7	Lëndë me zgjedhje: 1. Histori e Gjuhes Angleze 2. Metodatat e kërkimit shkencor	3
8	Dialektet, diversiteti gjuhësor dhe ndërkulturor	5
9	Marrëdhëniet anglo-amerikane me institucionet ndërkombëtare	5
10	Modernizmi dhe post-modernizmi amerikan	5
11	Lëndë me zgjedhje: 1. Përkthimi letrar 2. Shteti modern amerikan dhe britanik	3
12	Praktikë	6
13	Teza e diplomës	6
	TOTAL	60



ALBANIAN UNIVERSITY

ALBANIAN
UNIVERSITY
ALBANIAN
UNIVERSITY
ALBANIAN
UNIVERSITY
ALBANIAN
UNIVERSITY

Program 2-vjeçar me karakter profesional “Kujdes profesional ndaj fëmijëve”

Programi i studimit “Kujdes profesional ndaj fëmijëve” ofrohet për herë të parë në Albanian University dhe është në fazë licensimi nga MASR. Ky program 2-vjeçar me karakter profesional është i organizuar në dy vite akademike, të cilave i korrespondojnë 120 kredite ECTS.

Ky program studimi i pajis studentët me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehi praktike për arritjen e standardeve të larta në shërbimet për fëmijërinë e hershme, duke zbatuar teorinë dhe praktikën e të nxënit dhe të përkujdesjes, në lidhje me karakteristikat e grup moshës, me veçoritë individuale të fëmijëve, me objektivat e arsimit gjithëpërfshirës, me përparësitë e arsimit në vendin tonë dhe rolin si profesionist në një kontekst social në ndryshim.

Diploma profesionale ‘Kujdes profesional ndaj fëmijëve’ mundëson hapin e parë drejt përgatitjes profesionale për të punuar në çerdhe shtetërore dhe private, si dhe në të gjitha strukturat që ofrojnë shërbim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme, duke iu përgjigjur sa më mirë tregut të punës.



Kurrikula e programit të studimit 2-vjeçar me karakter profesional “Kujdes profesional ndaj fëmijëve”

VITI I		
NR	LËNDA	ECTS
1	Psikologji Zhvillimi e fëmijëve	6
2	Loja dhe ndikimi i saj në zhvillim	8
3	Edukim artistik në fushën e vizatimit	6
4	Formim gjuhësor dhe komunikim	5
5	Anglisht	5
6	Psikologji Zhvillimi e fëmijëve me aftësi ndryshe	6
7	Edukim artistik në fushën e muzikës	5
8	Anglisht	5
9	Kujdesi ndaj fëmijës	8
10	Trajnim	6
	TOTAL	60

VITI II		
NR	LËNDA	ECTS
1	Letërsi për fëmijë (tregim dhe interpretim përrallash)	6
2	Kujdesi shëndetësor	8
3	Lëndë me zgjedhje: 1. Njohuri fillestare për edukimin qytetar 2. Prindërimi efektiv	4
4	Etika në sjellje dhe komunikim	4
5	Praktikë	8
6	Lëndë me zgjedhje: 1. Formim trupor 2. TIK fillestar	4
7	Praktikë	10
8	Provim diplome	16
	TOTAL	60



ALBANIAN UNIVERSITY

A
L
B
A
N
I
A
N

U
N
I
V
E
R
S
I
T
Y

A
L
B
A
N
I
A
N

U
N
I
V
E
R
S
I
T
Y

A
L
B
A
N
I
A
N

U
N
I
V
E
R
S
I
T
Y

A
L
B
A
N
I
A
N

U
N
I
V
E
R
S
I
T
Y

PROGRAMET E STUDIMIT TË DOKTORATËS

Programet e Studimit të Doktoratës, të ofruara nga “Albanian University” janë programe studimi të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese. Në përfundim të programeve të studimit të doktoraturës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor i Shkencave” në fushën përkatëse.

Mënyra e organizimit të programeve të studimit të doktoratës në “Albanian University”, është në përputhje me standardet e MASR, bazuar në “Rregulloren mbi funksionimin e programit të studimit të doktoratës”. Studimet e doktoratës përsosin aftësitë studimore e kërkimore shkencore të doktorantëve sipas fushave përkatëse të studimit. Albanian University ofron programe të studimit të doktoratës në profile të ndryshme në fushën e Shkencave Shoqërore, në Shkencat Farmaceutike si dhe në Shkencat Ekonomike dhe të Aplikuara.



REGJISTRIME DHE TRANSFERIME

Procesi i regjistrimeve dhe i transferimeve në Albanian University realizohet në bazë të Ligjit Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të akteve nënligjore në zbatim të tij, të Statutit të AU (neni 61), të Rregullores së Përgjithshme (neni 50) si dhe të Rregullores së Regjistrimeve dhe Transferimeve në “Albanian University”. Rregullorja e Regjistrimeve dhe e Transferimeve ka për qëllim të përcaktojë rregullat kryesore lidhur me procedurat konkrete për regjistrimin, si dhe vlerësimin e transferimit të krediteve të përfituara nga studenti dhe njohjen e tyre.

Regjistrimet në AU

Të gjithë maturantët/kandidatët për studentë, për ndjekjen e studimeve në Albanian University, në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor dhe programet të ciklit të dytë Master i Shkencave dhe Master Profesional, duhet të ndjekin procedurat e përcaktuara të aplikimit dhe regjistrimit.

Kjo procedurë nis me aplikimin online nga ana e maturantit/kandidatit për student në portalin e maturës shtetërore dhe finalizohet për ata kandidat që

plotësojnë kushtet e mëposhtme:

1. Janë pajisur me dokument ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm;
2. Plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me VKM Nr. 295, datë 10.05.2019;
3. Plotësojnë kriteret e Albanian University për programet e studimit në të cilat aplikojnë;
4. Nuk rezultojnë të regjistruar në një tjetër program studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studenteve të shkëlqyer, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Për vitin akademik 2019-2020 procedura e detajuar e aplikimit dhe e regjistrimit do të realizohet në përputhje me Urdhrin e Përbashkët nr.1 datë 07/06/2019, i Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale E Rrjetit Akademik Shqiptar.

Formatin e plotë të aplikimit dhe regjistrimit mund ta gjeni në:

www.albanianuniversity.edu.al



Transferimet në AU

Albanian University ofron mundësi për transferimin e studimeve, në të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion, filial apo institucion tjetër të arsimit të lartë, publik ose privat, vendas ose të huaj, të licencuar dhe të akredituar për programin përkatës të studimit.

Universiteti, në zbatim të nenit 89 të ligjit 80/2015, udhëzimeve të MASR dhe në përputhje të kërkesave të *Rregullores së Regjistrimeve dhe Transferimeve të Albanian University*, ofron mundësinë për:

1. Njohje të diplomave me qëllim vazhdimin e studimeve në një nivel tjetër si dhe regjistrimin e studentëve në të tre ciklet e studimit;
2. Njohje dhe njehsim të periudhave të studimit të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja për vazhdimin e studimeve të njëjta ose të ngjashme pranë AU;
3. Njohje të krediteve (lëndë ose module) të fituara në një program studimi, ose formime të tjera pas shkollës së mesme, që përkohet me formimin e programit të studimit.

Për realizimin e transferimeve të studimeve në Albanian University është ngritur dhe funksionon Zyra e Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve, e cila ka një rol pritës dhe vlerësues të dokumentacionit.

Kjo zyrë ju vjen në ndihmë për çdo informacion mbi procedurën e detajuar të transferimit të studimeve dhe ndodhet në Adresën: Albanian University, Bulevardi Zogu I, Tiranë.

PROGRAMI I EKSELENCËS DHE BURSAT

Promovimi dhe nxitja e studentëve më të mirë është një tjetër politikë e “Albanian University”, duke synuar të jetë lider në fushën e arsimit privat, në përgatitjen e elitave të ardhshme në fushën e mjekësisë, inxhinierive, financës, menaxhimit, drejtësisë, psikologjisë, politikës, arsimit, etj. Qëllimi i këtij programi është tërheqja e studentëve të shkëlqyer, të cilët aplikojnë në “Albanian University”, në të gjitha degët e tij, si dhe stimulimin dhe rritjen e cilësisë së mësimnxënies. Studentët që kanë përfituar nga Programi i Ekselencës dhe i Bursave ndër vite janë:

Në vitin akademik 2008-2009 përfituan:

Bursë ekselence - 17 studentë

Bursë 50% zbritje - 18 studentë

Burse 30% zbritje - 59 studentë

Burse 25% zbritje - 2 studentë



Në vitin akademik 2009-2010 përfituan:

Bursë ekselence - 10 studentë

Bursë 50% zbritje - 14 studentë

Bursë 30% zbritje - 23 studentë

Në vitin akademik 2010-2011 përfituan:

Bursë ekselence - 7 studentë

Bursë 50% zbritje - 22 studentë

Bursë 30% zbritje - 66 studentë

Në vitin akademik 2011-2012 përfituan:

Bursë ekselence - 4 studentë

Bursë 50% zbritje - 10 studentë

Bursë 30% zbritje - 47 studentë

Në vitin akademik 2012-2013 përfituan:

Bursë ekselence - 9 studentë

Bursë 50% zbritje - 22 studentë

Bursë 30% zbritje - 4 studentë

Në vitin akademik 2013-2014 përfituan:

Bursë ekselence - 8 studentë

Bursë 50% zbritje - 24 studentë

Bursë 30% zbritje - 9 studentë

Në vitin akademik 2014-2015 përfituan:

Bursë ekselence - 7 studentë

Bursë 50% zbritje - 24 studentë

Bursë 30% zbritje - 9 studentë



Në vitin akademik 2015-2016 përfituan:

Bursë ekselence - 7 studentë

Bursë 50% zbritje - 24 studentë

Bursë 30% zbritje - 5 studentë

Në vitin akademik 2016-2017 përfituan:

Bursë ekselence - 8 studentë

Bursë 50% zbritje - 6 studentë

Bursë 30% zbritje - 39 studentë

Në vitin akademik 2017-2018 përfituan:

Bursë ekselence - 7 studentë

Bursë 50% zbritje - 3 studentë

Bursë 30% zbritje - 36 studentë

Në vitin akademik 2018-2019 përfituan:

Bursë ekselence – 4 studentë

Bursë 50% zbritje – 3 studentë

Bursë 30% zbritje – 30 studentë

Kriteri bazë për zgjedhjen e studentëve të Programit të Ekselencës është mesatarja e lartë e viteve të studimit. Studentët të cilët ruajnë të njëjtën mesatare gjatë viteve të universitetit, vazhdojnë të jenë me bursë vit pas viti nga Programi i Ekselencës.

Albanian University e ndjek traditën e Programit të Ekselencës edhe në vitet e ndërmjetme për studentët që kanë një mesatare të lartë në përfundim të çdo viti studimi, duke i motivuar ata për të vazhduar të kenë një performancë akoma më të mirë në të ardhmen.

Të tilla programe i shërbejnë jo vetëm eksperiencës së universitetit, por edhe motivojnë studentët në studimin dhe kërkimin shkencor.

Bursat e ndërmjetme: Studentët, që në vitet e para të studimeve universitare arrijnë rezultate të larta përfitojnë 50% dhe 30% zbritje të pagesës vjetore për vitin e ardhshëm akademik. Gjithashtu këtyre



studentëve u jepet mundësia, që të punojnë si asistentë të pedagogëve në praktikat mësimore për vitet e para.

Bursa të tjera: Disa bursa të tjera ofrohen nga “Albanian University”, sipas strategjisë së këtij universiteti, për jetimët dhe për studentët, që u takojnë kategorive të tjera sociale. “Albanian University” gjatë këtyre viteve në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme ka ofruar dhjetëra bursa për fëmijët e policëve të vrarë, për jetimët, për personat me aftësi të kufizuara, komunitetin rom, etj.

STUDENTET DHE MBËSHTETJA E TYRE

Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët ka për mision të orientojë, inkurajojë dhe të mbështesë studentët përgjatë viteve të studimit për zhvillimin e tyre profesional, nëpërmjet aktivizimit në aktivitetet ekstra-kurrikulare me karakter shkencor, profesional, social dhe kulturor në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.

Zyra e Karrierës dhe Alumnit ka për qëllim lehtësimin e lidhjes ndërmjet karrierës akademike dhe mundësive të punësimit të studentëve të diplomuar në “Albanian University” dhe promovimin e tyre në kompanitë, organizatat si dhe shoqatat e ndryshme të

interesuara për punëmarrës. Gjithashtu ajo synon të drejtojë studentin në zhvillimin e karrierës, nëpërmjet vlerësimit të interesave personale të çdo studenti dhe harmonizimin e tyre me pozicione pune, paga dhe kushtet e dëshiruara nga palët e marrëveshjes së punësimit.

KËSHILLI STUDENTOR

Këshilli Studentor i “Albanian University” është një organizim i pavarur i studentëve i cili nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike. Ky këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.

Këshilli Studentor i “Albanian University” shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucionit të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.



SHËRBIME– IT

Laboratorët kompjuterikë dhe aksesit në sistemin e kompjuterëve.

Përveç sallës së studimit, që është e lirë për studentët, Albanian University ka Laboratorin të pajisur me teknologjinë më të fundit multimediale.

Studentëve të të gjitha viteve, në çdo godinë të Universitetit, u është vënë në dispozicion, Laboratori i Informatikës, Arkitekturës, Financë-Bankës, Web Design, Juridikut dhe Psikologjisë ku mund të kërkojnë, marrin, japin informacionet apo materialet që i nevojiten sipas kërkesave të programeve akademike dhe ku mund të kalojnë kohën e lirë. Çdo laborator është i pajisur me 25 kompjuterë secili dhe me versionet më të fundit të programeve përkatëse, që shfrytëzohen për leksione apo seminare. Po ashtu sallat e leksioneve janë të pajisura me videoprojektorë, me anë të cilave lektorët bëjnë shpjegimin vizual të lëndëve në të gjitha degët. Kjo metodë shoqëron punën dhe shpjegimin teorik. Skematizmi teorik, që shoqërohet nga imazhi audioviziv deskriptiv, mundëson një mësimdhënie bashkëkohore dhe mjaft efektive. Rrjeti i kompjuterëve, që përdoren nga studentët, stafi akademik dhe punonjësit e administratës ofron falas shërbimin e internetit në të katër godinat e Albanian University.

Studentëve u ofrohet shërbimi i sekretarisë online, me qëllim informimin e tyre në lidhje me gjeneralitetet dhe historikun personal të tyre, kalendarin akademik, orarin, periudhën e sezonit dhe datat e provimeve, notat e marra gjatë viteve akademike, takimet e konferencat shkencore ku duhet të paraqiten, oraret e kurseve, pedagogët e programit që ata ndjekin, etj. Linku për tu loguar është: <http://on.albanianuniversity.edu.al/login>

Për çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me shërbimet IT, e-mail: admin@albanianuniversity.edu.al

Bibliotekat dhe Sallat e Studimit

Në mjediset e Albanian University janë vendosur tri biblioteka, që shërbejnë edhe si salla studimi për studentët. Në to ruhen skedarë me tituj të librave universitarë dhe botime artistike.

Biblioteka pranë godinës së Albanian University, Bulevardi Zogu I-rë, që shërben dhe si sallë studimi, ka të skeduar 1554 tituj librash, libra mësimorë, artistikë dhe revista të ndryshme. Koleksioni i librave përmban po ashtu, manuale, artikuj simpoziumesh, fjalorë si dhe artikuj të ndryshëm gazetash të universitetit. Përkatësisht 210 tituj janë literaturë në gjuhë të huaj,



ndërsa rreth 1800 tituj të tjerë janë literaturë në degët Stomatologji, Farmaci, Ekonomik, Arkitekturë, Juridik, Shkenca Administrativo-Politike, Psikologji, Gazetari si dhe Donacione të ndryshme. Studentët regjistrohen në kartelat, që u lejon të marrin librat për t'i studiuar në ambientet e sallave të studimit brenda universitetit.

Biblioteka në godinën e Albanian University pranë “Rrugës së Durrësit”, e cila shërben dhe si sallë studimi dhe interneti ku studentët kanë akses dhe mundësi të zgjerimit të dijeve nëpërmjet sistemit të edukimit “online”, ka të skeduar rreth 1210 tituj librash, që ndahen sipas degëve, libra studimore, akademike, artistike, fjalorë, si dhe revista të ndryshme shkencore, literaturë e huaj, kumtesa konferencash dhe artikuj të ndryshëm gazetash të universitetit. Përkatësisht 195 tituj janë literaturë në gjuhë të huaj, ndërsa rreth 1920 janë libra në total. Kështu pjesa dërmuese e titujve janë pjesë e programit akademik të fushës mjekësore, pjesa tjetër i kushtohet programeve të tjera të studimit që ofron Albanian University: Literaturë për Arkitekturën, Ekonominë, Shkencat Juridike, Shkencat Politike, Psikologjinë, Gazetarinë si dhe donacione të ndryshme.

Biblioteka në godinën e Albanian University pranë “Rrugës së Kavajës”, që shërben si sallë studimi dhe interneti ku studentët kanë akses dhe mundësi

të zgjerimit të dijeve nëpërmjet sistemit të edukimit “online”, ka të skeduar rreth 515 tituj librash që janë të regjistruara në inventarin e Bibliotekës kryesisht të degës së Arkitekturës dhe Inxhinierive, si dhe literaturë akademike, artistike, studimore, artikuj në fusha të ndryshme. Në këtë bibliotekë gjenden gjithashtu donacione nga profesorë të shquar shqiptarë, italianë dhe nga OSBE.

Libraria Universitare

Libraria Universitare u krijon studentëve lehtësira në pajisjen me literaturat e nevojshme për gjatë viteve akademike si dhe me materiale të tjera plotësuese. Kjo librari funksionon jo vetëm për studentët e Albanian University, por çdokush mund të ketë akses në të. Në librari gjenden të gjitha librat e botuara nga Shtëpia Botuese AU Press si dhe literatura nga të gjitha fushat të cilat i nevojiten studentëve të Universitetit.

Adresa: Rruga e Durrësit, Ish-Gjykata e rrethit, Tiranë.

E-mail: libraria@albanianuniversity.edu.al



Shërbimi me fotokopje

Albanian University ofron shërbime për fotokopjim tekstesh të ndryshme apo leksionesh, si për studentët ashtu dhe për stafin pedagogjik dhe administrativ. Universiteti ofron teknologjinë fundit, që siguron shpejtësi dhe efikasitet. Shërbimi me fotokopje ofrohet për stafin akademik, zyrat e sekretarive dhe bibliotekat e të gjitha godinave të universitetit.

Orari: 07:30 - 18:00

Bar-kafe

Albanian University krijon lehtësira për të siguruar komoditetin e studentëve duke u mundësuar ambiente shlodhëse të rezervuar vetëm për ta në barin e Albanian University, në të cilin është i ndaluar rreptësisht përdorimi i duhanit. Lokali i rezervuar vetëm për studentët ofron ambiente moderne dhe shërbim të kulturuar.





KONTAKTE

ADRESA:

“Bookstore”, Blv. Zogu I-rë, Tiranë Orari: 07:00 - 23:00

Fakulteti i Mjekësisë

Rr. Durrësit, Tiranë Albanian University Tel./Fax.
+355 42 223562

Rr.Kajo Karafili, Tiranë Albanian University Tel./
Fax. +355 42 266374

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike

Adresa 1 Rr. Kavajës, Tiranë Albanian University Tel./
Fax. +355 42 400530

Adresa 2: Bulevardi Zogu I, Tiranë Albanian
University Tel. +355 4 240 0268

Fakulteti i Shkencave Shoqërore

Bulevardi Zogu I, Tiranë Albanian University Tel.
+355 42 271602

Zyra e Administratorit të

Përgjithshëm Administrator i përgjithshëm i
“Albanian University”

Tel. +355 44504105

e-mail: l.bandilli@albanianuniversity.edu.al

Zyra e Informacionit

e-mail: informacioni@albanianuniversity.edu.al

Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë

email: e.boci@albanianuniversity.edu.al

Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët

email: a.guri@albanianuniversity.edu.al

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

e-mail: d.agaj@albanianuniversity.edu.al

Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave

e-mail: s.troshani@albanianuniversity.edu.al

**Sekretaria e Stomatologjisë**e-mail: stomatologjia@albanianuniversity.edu.al**Sekretaria e Farmacisë**e-mail: farmacia@albanianuniversity.edu.al**Sekretaria e Infermierisë & Fizioterapisë**e-mail: infermiera@albanianuniversity.edu.al**Sekretaria e Arkitekturës**e-mail: arkitektura@albanianuniversity.edu.al**Sekretaria e Inxhinierive**e-mail: inxhinieria@albanianuniversity.edu.al**Sekretaria e Dizajnit**e-mail: design@albanianuniversity.edu.al**Sekretaria e Ekonomisë**e-mail: ekonomik@albanianuniversity.edu.al**Sekretaria e Shkencave Juridike**e-mail: juridik@albanianuniversity.edu.al**Sekretaria e Shkencave Politiko-Administrative**e-mail: shkencapolitike@albanianuniversity.edu.al**Sekretaria e Psikologjisë**e-mail: psikologji@albanianuniversity.edu.al**Sekretaria e Edukimit dhe Anglishtes**e-mail: edukimi@albanianuniversity.edu.al**Albanian University Press**Blv, Zogu I, Tiranë e-mail: albaniauniversitypress@gmail.com**Website të Universitetit**www.albanianuniversity.edu.alwww.utv-news.tv

